

ANALIZA E ZBATIMIT TË PRIORITETEVE TË REFORMAVE NË DREJTËSINË E MAQEDONISË

Мaj 2018



Институт за човекови права



Македонско здружение на млади правници



Институт
за
европска
политика.
Скопје

Për botuesin:

Instituti për të Drejtat e Njeriut

Redaktor:

Mirosllav Draganov

Autorë:

Kosta Petrovski

Mirosllav Draganov

mr. Simonida Kacarska

mr. Iva Conevska

Zharko Aleksov

Angella Shumkoska

Impresumi

CIP – numri i publikimit

PËRMBAJTJA:

HYRJE -----

PJESA 1: PRIORITETET URGJENTE TË REFORMAVE FOKUSI I TË CILËVE ËSHTË PUNA E KËSHILLIT GJYQËSOR DHE TË KËSHILLIT TË PROKURORËVE PUBLIKË (Prioritetet 1 deri 5 -----

Metodologjia ----

Vështrim i shkurtër kronologjik në reformat -----

Pozicionimi kushtetues dhe ligjor i Këshillit Gjyqësor dhe i Këshillit të Prokurorëve Publikë -----

Reformat e korrikut 2017 -----

Raporti i dytë i Priebe i shtatorit 2017 -----

Strategjia e Reformës në Sektorin e Drejtësisë (2017-2022)

Kompetenca e Këshillit Gjyqësor dhe e Këshillit të Prokurorëve Publikë -----

Zgjedhja e gjyqtarëve dhe prokurorëve publikë -----

Kriteret dhe procedura e ndjekjes dhe vlerësimit të punës së gjyqtarëve dhe prokurorëve publikë-----

Përgjegjshmëria e gjyqtarëve dhe prokurorëve publikë -----

Këshilli i Përcaktimit të Fakteve dhe Ngritjes së Procedurës për Përcaktimin e Përgjegjësisë së një Gjyqtari ----

Transparenca në punën e Këshillit Gjyqësor dhe e Këshillit të Prokurorëve Publikë -----

Konkluzionet dhe rekomandimet nga Prioritetet 1 deri 5 -----

PJESA 2: PRIORITETET URGJENTE TË REFORMAVE FOKUSI I TË CILËVE ËSHTË PUNA E AKADEMISË SË GJYQTARËVE DHE PROKURORËVE PUBLIKË DHE SHPALLJA E VENDIMEVE GJYQËSORE -----

Prioriteti 6:

Metodologjia -----

Korniza juridike -----

Buxheti -----

Cilësia e trajnimeve -----

a) Trajnimi fillestar -----

Ekipimi kadrovik dhe teknik dhe kushtet infrastrukturore -----

Inkurajimi i dërgimit të gjyqtarëve kombëtarë për stazh pune në GJEDNJ -----

Konkluzionet dhe rekomandimet e Prioritetit 6 -----

Prioriteti 7:

Metodologjia -----

Statusi i përmbushjes së prioritetit -----

Konkluzionet dhe rekomandimet e Prioritetit 7 -----

**PJESA 3: PRIORITETET URGJENTE TË REFORMAVE FOKUSI I TË CILËVE
ËSHTË ZGJIDHJA E LËNDËVE “TË VJETRA” DHE ZBATIMI I VENDIMEVE TË
GJEDNJ NË RM -----**

Prioriteti 8:

Hyrje -----

Lëndët me kohëzgjatje nga 3 deri 7 vite, nga 7 deri 10 vite, dhe lëndët mbi 10 vite—

Gjykimi në afat të arsyeshëm -----

Konkluzionet dhe rekomandimet e Prioritetit 8 -----

Prioriteti 9:

Hyrje -----

Aktgjykimet efektive të GJEDNJ kundër RM -----

Sistemi i zbatimit të aktgjykimeve të GJEDNJ -----

Studimi i rasteve -----

Perceptimet e avokatëve për zbatimin e aktgjykimeve të GJEDNJ -----

Konkluzionet dhe rekomandimet e Prioritetit 9 -----

HYRJE

Kjo analizë është zhvilluar nga Instituti për të Drejtat e Njeriut (IDNJ) si bartës, dhe organizatat partnere: Instituti për Politikë Evropiane (EPI) dhe Shoqata Maqedonase e Juristëve të Rinj (SHMJR), në kuadër të projektit *”Veprimi i përbashkët për reforma urgjente në gjyqësor”* i cili është mbështetur financiarisht nga Fondacioni Shoqëria e Hapur – Maqedoni (FSHHM) dhe i cili po zbatohet nga 1 korriku 2017 deri më 30 qershor 2018.

Si pikë nisëse e analizës u mori Raporti i parë i publikuar më datë 8 qershor 2015, nga Grupi i Ekspertëve të Nivelit të Lartë, i udhëhequr nga dr. Reinhard Priebe¹ dhe në bazë të tij edhe Prioritetet e sjella Urgjente të Reformave të Komisionit Evropian, poashtu në qershor 2015.² Në fakt, përmbajtja e kësaj analize prijëse janë pikërisht nëntë prioritetet urgjente të reformave, të cilat i përkasin fushës së gjyqësorit e të cilat Komisioni Evropian në qershor 2015 i shtroi si parakusht për RM në vazhden e rrugëtimit euroatlantik të vendit. Këto nëntë Prioritete Urgjente të Reformave (PUR), sigurisht se lexohen pandaras nga Raporti i Parë i Priebe i qershorit 2015 dhe nga Raporti i Dytë i Priebe i shtatorit 2017³; ndërkaq, ato ishin baza nga e cila niseshin tre orgnaizatata qytetare – implementuesit e këtij projekti, për të arritur objektivat e mëposhtëm:

Objektivi i përgjithshëm: Përforcimi i transparencës, llogaridhënies dhe profesionalizmit të organeve të drejtësisë.

Objektivat specifikë: 1. Përforcimi i monitorimit strukturor të realizimit të Prioriteteteve Urgjente të Reformave (PUR) në sektorin e drejtësisë; 2. Avancimi i debatit publik për implementimin e PUR në drejtësi, me anë të përfaqësimit civil.

Me qëllim realizimi më praktik i këtyre objektivave, përgjatë tërë projektit, tre organizatat implementuese, secila veçmas u fokusua më detajisht në një pjesë të prioriteteteve, kështu që në mënyrë të detajuar u përfshinë gjithë nëntë prioritetet urgjente të reformave nga fusha e drejtësisë. Një tregues i posaçëm i suksesit të kësaj qasjeje janë tre raportet e përpiluara dhe të publikuara me sukses të monitorimit në kuadër të këtij projekti, të cilat parimisht fillojnë analizimin e periudhës nga korriku 2015, e përsëri më detajisht i referohen periudhës nga korriku

¹Rekomandimet e Grupit të Ekspertëve të Nivelit të Lartë për çështjet sistematike në lidhje me sundimin e ligjit, në kuptimin e vëzhgimit të komunikimeve, të zbuluar në pranverën e vitit 2015, të qasshme në <https://goo.gl/XNxLkb> (ky raport në opinionin publik të Maqedonisë i bë i njohur si Raporti i Priebe, dhe vijuar nga shpallja e raportit të dytë në vitin 2017, ky raport po bëhet edhe më i njohur si Raporti i Parë i Priebe)

²Të qasshëm në: https://eeas.europa.eu/sites/eeas/files/urgent_reform_priorities_en.pdf

³Raporti i Dytë i Priebe është i qasshëm në: https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/2017.09.14_seg_report_on_systemic_rol_issues_for_publication.pdf

2017 deri në mars 2018.⁴ Të dhënat e këtyre raporteve dhanë përkrahjen më të madhe për zhvillimin e kësaj analize të detajuar, e cila në secilin nga prioritetet nxjerr konkluzione dhe jep rekomandime përkatëse për avancimin e mëtejshëm të gjendjeve në pjesët gjegjëse të drejtësisë. Këto tre pjesë të analizës do ta bëjnë më të lehtë për çdo lexues në njohjen e gjendjeve, për arsye se ato qartë po fokusohen në prioritate të caktuara specifike, ndërsa analiza e përgjithshme si tërësi, ofron pasqyrën e tërë fushës së drejtësisë. Megjithatë, duke patur parasysh të gjitha resurset në dispozicion, edhe kjo pasqyrë e përgjithshme që ofron analiza, ndonëse është fokusuar në segmentet më të rëndësishme që dëftojnë prioritetet. Për të përcaktuar gjendjet në mënyrë të detajuar, të thellë dhe analitike (më tepër edhe nga prioriteti i prezantuar këtu) në gjithësecilin prioritet veçanërisht, kjo analizë do të shërbejë si një bazë e mirë për përmbushjen e një qëllimi të tillë.

Duke ditur periudhën e përgatitjes, kjo analizë, lexuar paralelisht me Raportin e Komisionit Evropian mbi RM, të publikuar më datë 17 prill 2018⁵, gjithësesi lë një shenjë të konsiderueshme në paraqitjen e gjendjeve në drejtësinë e Maqedonisë, pas një krize dy-vjeçare politike dhe insitucionale, e cila, mes tjerash, provoi erozionin e sistemit të drejtësisë, që në praktikë po ndodhte në shtetin tonë (edhe përkundër numrit të lartë të mekanizmave që kryesisht ishin vendosur “në letër”, me reformat gjyqësore, sidomos që nga viti 2004 e këtej, një pjesë e tyre janë përshkruar me këtë analizë, por është evidente se ato ishin shpërdorur në praktikë).

⁴Raporti i parë i Monitorimit është i qasshëm në: <http://ihr.org.mk/p.php?pid=274>, Raporti i dytë i Monitorimit është i qasshëm në: <http://ihr.org.mk/p.php?pid=309> dhe Raporti i tretë i Monitorimit është i qasshëm në: <http://ihr.org.mk/p.php?pid=347>

⁵Raporti i Komisionit Evropian, i publikuar më datë 17 prill 2018, i qasshëm në: <https://www.sobranie.mk/content/republic-of-macedonia-report%2017.4.18.pdf>

PJESA 1:

**PRIORITETET URGJENTE TË REFORMAVE FOKUSI I TË CILËVE
ËSHTË PUNA E KËSHILLIT GJYQËSOR DHE E KËSHILLIT TË
PROKURORËVE PUBLIKË**

Autorë: Kosta Petrovski dhe Miroslav Draganov

Prioriteti 1: Depolitizimi i emërimit dhe avancimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve publikë në praktikë, e jo vetëm në teori, në bazë të kriterëve transparente, objektive dhe të bazuara në merita;

Prioriteti 2: Aplikimi i një sistemi të harmonizuar në bazë të punës së kryer, duke u bazuar në standarde kuantitative, por edhe kualitative, si bazë për avancim në karrierë në gjyqësor dhe në prokurori publike;

Prioriteti 3: Mënjanimi i elementeve nga sistemi i përgjegjësisë disiplinore si dhe për shkarkimin e gjyqtarëve të cilët për momentin po gërmojnë pavarësinë gjyqësore, si në teori, ashtu dhe në praktikë;

Prioriteti 4: Sigurimi i profesionalizmit të Këshillit Gjyqësor në praktikë, e jo vetëm në teori (gjegjësisht, një test i qartë dhe i parashikueshëm për aplikimin e kriterit “jurist i shquar”)

Prioriteti 5: Sigurimi i rolit proaktiv të Këshillit Gjyqësor dhe të gjykatave më të larta për mbrojtjen e pavarësisë dhe për mbrojtjen nga influencat (me një strategji të përmirësuar të komunikimit dhe me veprime vendimmarrëse për reagim ndaj influencave ose presioneve).

Metodologjia

Në Pjesën 1 të kësaj Analize, janë procesuar bashkërisht dhe në mënyrë përmbledhëse, në teori dhe në praktikë, pesë nga nëntë Prioritetet Urgjente të Reformave, të cilat kryesisht kanë të bëjnë me punën e Këshillit Gjyqësor dhe të Këshillit të Prokurorëve Publikë (të numëruara në nëntitull).

Për shkak të pasqyrimin të detajuar të gjendjeve, si bazë janë marrë gjitha të dhënat dhe raportet e përgatitura nga Instituti për të Drejtat e Njeriut në kuadër të këtij aktiviteti të projektit “Veprimi i përbashkët për reforma urgjente në gjyqësor” duke shfrytëzuar metodat më poshtë:

1. Hulumtimi nga zyra: a) Metoda historike – janë analizuar ndryshimet e rregullave pozitive të Maqedonisë, që përfshijnë Prioritetet Urgjente të Reformave të evidentuara në të dy Raportet e Pribes, në korrelacion me raportet vendimtare të institucioneve relevante ndërkombëtare. Edhe pse periudha nisëse e marrë si bazë është korriku i vitit 2015 (koha e publikimit të Prioriteteve Urgjente të Reformave), megjithatë, fokusi është vënë në periudhën e monitorimit në kuadër të këtij projekti: korrik 2017 – prill 2018; b) Metoda krahasuese – në

mënyrë krahasuese janë analizuar dispozitat e rregullave pozitive maqedonase, të cilat rregullojnë pozicionimin dhe funksionimin e dy ose më tepër organeve/institucioneve/organizatave të njëlojshme, e sidomos, para së gjithash, Këshilli Gjyqësor *vis-à-vis* Këshillit të Prokurorëve Publikë (për shembull: krahasimi i pozicionimit ligjor i kriterëve për zgjedhjen e gjyqtarëve dhe i kriterëve për zgjedhjen e prokurorëve publikë, krahasimi i punës së tyre gjatë seancave, krahasimi i transparencës së tyre ndaj publikut dhe profesionalizmit në punë, krahasimi i mjeteve financiare për punën e tyre, si dhe mënyra e financimit, kapacitetet njerëzore dhe hapësinore, e të ngjashme.); c) Metoda kualitative dhe kuantitative – të dhënat janë grumbulluar me kërkesa të parashtruara për qasje në informacione me karakter publik, përmes analizës së raporteve zyrtare të organeve, përmes marrjes së shënimeve gjatë sesioneve të hapura, ndërsa procesimi i të dhënave të grumbulluara thekson lidhshmërinë e ndërsjellë të numrave kuantitativë në korrelacion me cilësinë e reformës së nevojitur, ose me atë që tanimë është bërë; ç) Metoda e sintezës – procesimi i kësaj pjese të parë të Analizës, përveç se paraqet tërësi në vete, ajo paraqet dhe një pjesë e pandashme dhe ndërvartëse me analizën e përgjithshme, e cila përfshin gjithë nëntë prioritetet urgjente të reformave nga Raporti i Parë i Priebe, të sendërtuara me Raportin e Dytë të Priebe të shtatorit 2017; d) Metodat e induksionit dhe deduksionit – këto dy metoda janë përdorur në mënyrë ndërvartëse, kështu që prioriteti konkret, me anë të deduksionit, përpunon më detajisht të dhënat dhe dispozitat që kanë të bëjnë me të, e pastaj, me anë të induksionit, kjo gjë çon drejt mishërimit në konkluzione dhe rekomandime përkatëse për përmirësim të mëtejshëm.

2. Hulumtimi në terren: a) Monitorimi i menjëhershëm i punës – prezenca në seanca, debate, konferenca ku organet e drejtësisë marrin pjesë dhe/ose i janë përkushtuar punës së vet (fokus të posaçëm në Këshillin Gjyqësor dhe Këshillin e Prokurorëve Publikë); b) Takimet zyrtare dhe jozyrtare me përfaqësues të këtyre organeve.

Vështrim i shkurtër kronologjik në reformat

Shteti juridik dhe respektimi i parimit të sundimit të ligjit paraqesin postulatet themelore që karakterizojnë vlerat demokratike të një shoqërie. Nuk ka demokraci pa sundimin e ligjit, e nuk ka sundim të ligjit pa pavarësinë dhe mëvetësinë e bartësve të ligjvënies në çdo shoqëri.

Sistemi i drejtësisë i Maqedonisë, pas pavarësimit të shtetit tonë, është vazhdimisht në proces reformash, duke gjurmuar kështu zgjidhje dhe mekanizma që do të siguronin një shkallë më të

lartë të pavarësisë dhe mëvetësisë së gjyqësorit dhe prokurorive publike, dhe afrim drejt standardeve të larta të BE dhe të Këshillit të Evropës. Në periudhën 2004-2009 u bënë intervenca të vëllimshme reformuese, të cilat rezultuan edhe me ndryshimin e Kushtetutës së RM. Për herë të parë sundimi i ligjit dhe ndarja e pushtetit morën mbështetje kushtetuese dhe mundësi reale për zbatimin e tyre. Në këtë kuptim, pushteti gjyqësor, nëpërmjet të që atëherë, pozicionimit të ri të Këshillit Gjyqësor të RM dhe Këshillit të Prokurorëve Publikë të RM, si dhe të Akademisë së sapoformuar të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë, siguroi garanca të larta për pavarësinë dhe mëvetësinë e tij.

Pozicionimi kushtetues dhe ligjor i Këshillit Gjyqësor të RM dhe i Këshillit të Prokurorëve Publikë të RM

KËSHILLI GJYQËSOR: Sipas Kushtetutës së RM të vitit 1991, Këshilli Gjyqësor Republikan përbëhet nga 7 anëtarë dhe ishte nën kompetencën e tij që Kuvendi t'i propozonte emërimin dhe shkarkimin e gjyqtarëve, të vendoste për përgjegjshmërinë disiplinore të gjyqtarëve dhe ta vlerësonte profesionalizmin dhe ndërgjegjshmërinë e tyre. Me Amandamentin XXVIII të vitit 2005, është hedhur një hap i madh përpara dhe kështu, Këshilli Gjyqësor është avancuar në një organ të mëvetësishëm dhe të pavarur të pushtetit gjyqësor, i cili siguron dhe garanton mëvetësinë dhe pavarësinë e gjykatave. Me këtë amandament është rregulluar plotësisht edhe përbërja e Këshillit Gjyqësor. Këshilli përbëhet nga 15 anëtarë nga të cilët, sipas funksionit, janë Ministri i Drejtësisë dhe Kryetari i Gjykatës Supreme, tetë anëtarë zgjedhin gjyqtarët nga mesi i tyre, tre anëtarë zgjedh Kuvendi i RM, ndërsa dy anëtarë propozon Presidenti i RM, kurse i zgjedh Kuvendi.

Ligji i Këshillit Gjyqësor plotësisht përcakton procedurat për zgjedhjen e gjyqtarëve, procedurat e përcaktimit të joprofesionalizmit dhe pandërgjegjshmërisë së gjyqtarëve, vlerësimin e gjyqtarëve dhe procedurën për mënyrën e punës së tij.

Pozicionimi i këtillë kushtetues dhe ligjor i Këshillit Gjyqësor nënvizon pavarësinë dhe mëvetësinë e tij në raport me pushtetin ligjvënës dhe ekzekutiv, dhe në të njëjtën kohë, sipas përbërjes së tij, siguron dhe aplikimin e parimit të balancit dhe kontrollit të ndërsjellë të bartësve të tre pushteteve në shoqëri.

KËSHILLI I PROKURORËVE PUBLIKË: Për dallim nga Amandamenti XXVIII, i cili i shprehimisht i përket Këshillit Gjyqësor, Amandamenti XXX i vitit 2005 i ndërlidhet nenit 106

të Kushtetutës, duke përcaktuar pozicionimin kushtetues të prokurorisë publike dhe organizimit të saj, ndërkaq duke përcaktuar se prokurorët publikë zgjedh Këshilli i Prokurorëve Publikë, i cili vendos edhe për shkarkimin e tyre. Çështjet e kompetencës, përbërjes dhe strukturës dhe mandatit të anëtarëve të Këshillit, janë lënë të rregullohen me ligj. Sipas Ligjit të Këshillit të Prokurorëve Publikë të vitit 2008, ai është një organ i mëvetësishëm, i cili siguron dhe garanton mëvetësinë e prokurorëve publikë në kryerjen e funksionit të tyre. Këshilli është përbërë nga 11 anëtarë, në mesin e të cilëve Ministri i Drejtësisë dhe Prokurori Publik i RM janë anëtarë sipas funksionit, gjashtë anëtarë zgjedhen nga rendi i prokurorëve publikë dhe tre anëtarë zgjedh Kuvendi i RM nga rendi i profesorëve universitarë, avokatë dhe juristë tjerë të shquar. Me ndryshimet e Ligjit të Këshillit të Prokurorëve Publikë, Ministri i Drejtësisë u zëvendësua me edhe një anëtar, të cilin zgjedh Kuvendi i RM. Mandati i anëtarëve zgjat 4 vjet, me të drejtë për edhe një mandat.

Reformat e korrikut të vitit 2017

Duke cilësuar Prioritetet Urgjente të Reformave si imperativ në procesin e eurointegritimeve, Qeveria e RM, në fillim të korrikut 2017, hartoi Planin 3-6-9, me objektiv të vetëm dhe udhëzim për reformat që duhet të ndërmerren. Ky Plan, në fushën e reformave gjyqësore parasheh 13 masa, nga të cilat për këtë Pjesë 1 të Analizës, të rëndësishme janë këto në vijim:

- pezullimi i Këshillit të Përcaktimit të Fakteve dhe Përgjegjësisë Disiplinore të Gjyqtarëve;
- inkurajohet Këshilli Gjyqësor t'i nxis gjyqtarët që menjëherë ta informojnë në rast të presionit politik ose çfarëdo presioni tjetër, dhe në qoftë se presioni vjen nga prokuroria publike, ta informojnë Këshillin e Prokurorëve Publikë dhe mediat, ndërsa në qoftë se presioni vjen nga një anëtar i Këshillit Gjyqësor, për këtë ta informojnë Këshillin Gjyqësor dhe mediat;
- formimi i grupit për ndryshimin e Ligjit të Gjykatave dhe Ligjit të Këshillit Gjyqësor në lidhje me procedurën e përgjegjësisë disiplinore të gjyqtarëve, masat disiplinore dhe vlerësimin e gjyqtarëve;
- formimi i Grupit të ri të Punës për Rishikimin e skicë-Strategjisë për Reforma në Sektorin e Drejtësisë konform rekomandimeve të Komisionit Evropian, Komisionit të Venedikut dhe GRECO;
- formimi i Këshillit të Zbatimit të Reformave në Drejtësi;

- kryerja e kontrollit dhe inspektimit brenda sistemit të menaxhimit të lëndëve dhe përcaktimi i abuzimit të mundshëm dhe i përgjegjshmërisë.

Nga monitorimi: Këshilli i Përcaktimit të Fakteve si organ u pezullua me ligj, u formua Grupi i ri i Punës për Rishikimin e skicë-Strategjisë së Reformës në Sektorin e Drejtësisë dhe Strategjia, së bashku me Planin e Veprimit u aprovua në nëntor të vitit 2017, u formuan dhe grupe pune që punuan në ndryshimet e Ligjit të Këshillit Gjyqësor dhe Ligjit të Gjykatave, ku dy herë u votuan ndryshimet, ndërsa ndryshimet e dyta, të cilat ishin më thelbësore dhe për të cilat nevojitej shumica e votave me dy të tretat ishin vonuar për më se një muaj nga afati parimisht i caktuar, kur duhej të ishin votuar në Kuvendin e RM. Për sa i përket kontrollit të AKMIS, u formua një Grup i Pavarur Ekspertësh nga Ministria e Drejtësisë në fund të shtatorit të vitit 2017 dhe ai parashtrroi një raport në fillim të dhjetorit 2017 përpara organeve kompetente, në mesin e të cilave edhe përpara Këshillit Gjyqësor dhe Prokurorisë Publike Themelore, të cilat, deri në përgatitjen e kësaj analize (28.05.2018), nuk kanë shpallur rezultate të dukshme nga procedurat që po zhvillohen përpara këtyre organeve në lidhje me shpërdorimet e mundshme, të cilat u zbardhën në publik. Me vëzhgimin e rregullt të punës së Këshillit Gjyqësor, nuk janë paraqitur asçfarë të dhënash në lidhje me presionin e mundshëm që kanë gjyqtarët, dhe për këtë arsye t'i ishin drejtuar këtij organi. Këshilli i Zbatimit të Reformës në Drejtësi, i cili u formua nga Ministri i Drejtësisë gjatë verës së vitit 2017, nuk kishte kompetenca të qarta dhe pas aprovimit të Strategjisë dhe Planit të Veprimit, pushoi së funksionuari, kështu që nga marsi 2018, u formua një Këshill i ri (kësaj radhe pranë Qeverisë së RM) për Vëzhgimin e Implementimit të Strategjisë së Reformës në Sektorin e Drejtësisë (2017-2022). Pritet që ky Këshill të dëftojë të gjitha mangësitë, vonesat dhe pengesat në implementimin e Strategjisë, si dhe t'i konstatojë reformat e mëkohshme, konform kornizës kohore të përmbajtur në Planin e Veprimit. Ky Këshill është përbërë nga shumica e praktikuesve juridikë dhe përfaqësuesve të institucioneve, dhe gjithashtu është anëtar i Grupit Blueprint i organizatave civile për drejtësi, me një përfaqësues të vetin rrotullues.⁶

Raporti i Dytë i Priebe i shtatorit 2017

⁶Informacione më të hollësishme në lidhje me tërë rrjedhën e realizimit të reformave në praktikë mund të vështrohet me analizën e ndërsjellë kronologjike të tre raporteve të monitorimit, të përpiluar në kuadër të këtij projekti.

Gjatë verës së vitit 2017, Grupi i Ekspertëve të Pavarur i Komisionit Evropian bëri një vlerësim të implementimit të rekomandimeve të dhëna në raportin e parë të vitit 2015, ku vlerësimi i përgjithshëm është se nuk ka ndonjë progres të posaçëm, por përkundrazi, kontrolli dhe shpërdorimi i sistemit të drejtësisë nga një grup gjyqtarësh në pozita të larta në mbrojtjen e interesave politikë po vazhdon edhe më tej. Nga ky raport i dytë i Priebe poashtu rrjedh vlerësimi se arsyen për gjendjen në të cilën është drejtësia nuk duhet kërkuar në ligjet ekzistuese, por në implementimin e tyre jo të plotë dhe jo si duhet, i cili, sikurse të ishte i plotë dhe si duhet, do të kishte rezultuar me një gjyqësor të pavarur dhe profesional. Në raport janë dhënë rekomandime konkrete të cilat, para së gjithash, i përkasin Këshillit Gjyqësor. Rekomandohet hapja e çështjes së përbërjes së tij dhe mundësisë për rizgjedhjen e anëtarëve të Këshillit, si dhe pyetja nëse ai duhet të mbetet një organ profesional, nëse akoma do vlejë obligimi i tij në zgjedhjen e çdo kandidati që me sukses ka kryer trajnimin në Akademinë e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë, më tej, Kuvendi i RM, gjatë zgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Gjyqësor nga rendi i “juristëve të shquar”, të mos zgjedh gjyqtarë. Në lidhje me sistemin e shpërndarjes së lëndëve (AKMIS) rekomandohet kryerja e rishikimit të sistemit, me qëllim përcaktimi nëse është bërë shpërdorimi i tij.

Strategjia e Reformës në Sektorin e Drejtësisë (2017-2022)

Konform Planit 3-6-9 të Qeverisë së RM, është hartuar Strategjia e Reformës në Sektorin e Drejtësisë (2017-2022), e cila jep drejtime dhe rekomandime të qarta për avancimin dhe përmirësimin e sistemit të ligjdhënies dhe e cila njëkohësisht do t'i shërbejë Qeverisë si udhërrëfyes për sigurimin e të gjitha parakushteve që janë nën kompetencat e saja për krijimin e një gjyqësori të pavarur, objektiv, cilësor dhe transparent, i cili do të kujdeset, para së gjithash, për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive individuale të qytetarëve. Strategjia si bazë ka të gjitha dokumentet ndërkombëtare, duke filluar nga raportet dhe vlerësimet e Komisionit Evropian për Progresin e RM, rekomandimet e Grupit të Ekspertëve të Pavarur të Nivelit të Lartë (të udhëhequr nga Priebe) nga viti 2015 deri në vitin 2017, raporti i GRECO, mendimet e Komisionit të Venedikut, si dhe skicë-Strategjia e Reformës në Sektorin e Drejtësisë e vitit 2010. Fokusi kryesor i Strategjisë është kthyer drejt tejkalimit të dobësive të identifikuara në sektorin e drejtësisë dhe para së gjithash, futja në përdorim të parimit të sundimit të ligjit si parim bazë dhe epror politik në rregullimin e marrëdhënieve midis bartësve të pushtetit me respektim të plotë të pavarësisë, mëvetësisë dhe integritetit të pushtetit gjyqësor.

Strategjia, përveç gjyqësorit dhe prokurorisë publike, përfshin edhe: avokaturën, noterinë, përmbaruesit, ndërmjetësimin, ndihmën juridike falas, ndërsa rekomandimet orienton drejt pavarësisë, paanshmërisë, cilësisë, përgjegjësisë, efikasitetit dhe transparencës së bartësve të funksioneve jurisprudente. Në kuptimin e **pavarësisë dhe paanshmërisë** rekomandohet:

- përcaktimi i kriterëve ligjore për zgjedhjen e kandidatëve - të diplomuarve në Akademinë së Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë nga Këshilli Gjyqësor dhe nga Këshilli i Prokurorëve Publikë, me arsyetim të detyrueshëm dhe shpallje publike të aktvendimit për zgjedhjen;

- anëtarët e Këshillit Gjyqësor dhe të Këshillit të Prokurorëve Publikë të zgjedhen nga rendi i gjyqtarëve më me përvojë, apo prokurorëve publikë të tillë, të cilët përmbushin të paktën kushtin për gjyqtar dhe prokuror publik në një gjykatë apo prokurori publike më të lartë, ashtu siç është përkatëse;

- buxheti i mëvetësishëm dhe i qëndrueshëm që është konzistent ndaj përcaktimit ligjor nga të ardhurat kombëtare bruto;

- përmirësimi i kushteve hapësinore dhe teknike të punës së gjyqtarëve dhe prokurorëve publikë.

Për sa i përket **cilësisë** rekomandohet rishikimi i kriterëve të vlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve publik, që ato të themelohen mbi kriterë objektive kuantitative e sidomos kualitative, me fokus në shkathhtësitë profesionale, integritetin, profesionalizmin, aftësinë personale dhe shkathhtësitë sociale.

Në kuptimin e **përgjegjshmërisë** Strategjia posaçërisht i përkushtohet aplikimit të kriterëve ligjore për përcaktimin e përgjegjësisë së anëtarëve të Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit të Prokurorëve Publikë, si dhe të mekanizmave funksionale dhe transparente për përgjegjësinë e gjyqtarëve dhe prokurorëve publikë, pluralizimin e sanksioneve dhe shkarkimin vetëm për shkelje më të rënda dhe të vazhdueshme disiplinore.

Efikasiteti i gjyqësorit duhet të vëzhgohet me ndihmën e treguesve të përcaktuar në Bashkimin Evropian dhe me standarde tjera ndërkombëtare, duhet bërë planin e zgjidhjes së lëndëve të vjetra, duke u dhënë përparësi lëndëve që mund të çojnë drejt shkeljeve të parimit të gjykimit në afat të arsyeshëm.

Në kuptimin e **transparencës** rekomandohet përforcimi i saj si për Këshillin Gjyqësor, ashtu dhe posaçërisht për Këshillin e Prokurorëve Publikë, me fuqizimin e kapaciteteve për marrëdhënie me publikun, grumbullim, procesim dhe analizë të të dhënave statistikore mbi punën e gjyqësorit dhe prokurorisë publike, dhe njësimin e formës së raporteve vjetore. Posaçërisht rekomandohet

rritja e transparencës së Këshillit të Prokurorëve Publikë me rregullimin e procedurave të qarta të punës dhe argumentimin e të gjitha vendimeve që sjell Këshilli, sidomos ato që kanë të bëjnë me zgjedhjen, ngritjen në detyrë, vlerësimin, përgjegjësinë disiplinore dhe shkarkimin e prokurorit publik.

Nga monitorimi: Një pjesë e vogël e rekomandimeve në Strategji (duke ditur se ajo është pesëvjeçare) janë realizuar me sigurimin e parakushteve konkrete ligjore për realizimin e tyre në praktikë, një pjesë kanë filluar të zbatohen, ndërsa në pajtim me Planin e Veprimit, pjesa më e madhe e këtyre rekomandimeve duhet të filtrohet në ndryshime ligjore deri në shtator 2018.

Kompetenca e Këshillit Gjyqësor dhe e Këshillit të Prokurorëve Publikë

Kompetenca elementare e Këshillit Gjyqësor është emërimi dhe shkarkimi i gjyqtarëve, kryetarëve të gjykatave dhe gjyqtarëve porotë. Këshilli Gjyqësor përcakton ndërprerjen e funksionit të gjyqtarit, vendos për përgjegjësinë disiplinore të gjyqtarëve, vëzhgon dhe vlerëson punën e gjyqtarëve, joprofesionalitetin e tyre dhe jondërgjegjshmërinë e tyre në kryerjen e funksionit, përcakton numrin e vendeve të funksionit gjyqtar nëpër gjykatat, përkujdeset për reputacionin e gjyqtarëve dhe për mirëbesimin e qytetarëve në gjyqësor, si dhe kompetenca tjera të përcaktuara me Ligjin⁷.

Këshilli i Prokurorëve Publikë është kompetent për t'i dhënë mendime Qeverisë së RM për propozimin e emërimit dhe shkarkimit të Prokurorit Publik të RM, zgjedh dhe shkarkon prokurorë publikë, sjell vendim mbi numrin e tyre, vendos për ndërprerjen e funksionit të një prokurori publik dhe vendos në shkallë të dytë gjatë procedurës së përcaktimit të përgjegjësisë disiplinore, vendos për kryerjen e pandërgjegjshme dhe joprofesionale të funksionit, ndjek punën e prokurorëve publikë, si dhe kompetenca tjera të përcaktuara me Ligjin.⁸

⁷Ligji i Këshillit Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 60/2006, 69/2006, 150/2010, 100/2011, 20/2015, 61/2015, 197/2017 dhe 83/2018)

⁸Ligji i Këshillit të Prokurorëve Publikë i Republikës së Maqedonisë (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë”, nr. 150/2007 dhe 100/2011)

Zgjedhja e gjyqtarëve dhe prokurorëve publikë

GJYQTARËT: Konform Ligjit të Gjykatave⁹ ku janë parashikuar kushtet e përgjithshme për zgjedhjen e gjyqtarëve dhe kryetarëve të gjykatave, kandidati për gjyqtar në Gjykatën Themelore patjetër duhet qenë shtetas i RM, ta zotërojë gjuhën maqedonase në mënyrë aktive, të ketë aftësi juridike pune, me gjendje të mirë të përgjithshme shëndetësore, të jetë jurist i diplomuar me provim të dhënë të jurisprudencës, të njohë në mënyrë aktive një nga gjuhët zyrtare të BE (anglisht, frengjisht ose gjermanisht), të zotërojë punë praktike me kompjuterë, të gëzojë reputacion, të posedojë integritet për kryerjen e funksionit të gjyqtarit, të ketë kryer trajnimin fillestar në Akademinë e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë. Për gjyqtarët në gjykatat më të larta janë parashikuar edhe kushte të posaçme, ndërkaq që për Gjykatën e Apelit nevojitet që kandidati të ketë të paktën përvojë katërvjeçare si gjyqtar i Gjykatës Themelore, ndërsa për gjyqtar në Gjykatën Supreme, kandidati duhet të ketë kaluar të paktën gjashtë vjet përvojë në Gjykatën e Apelit. Ligji përcakton një kusht të posaçëm edhe për gjykatat administrative, andaj për në Gjykatën Administrative, kandidati nevojitet të ketë përvojë katërvjeçare si gjyqtar themelor, ose pesë vjetë përvojë pune në një organ shtetëror. Për Gjykatën e Lartë Administrative, kandidati duhet patur përvojë trevjeçare në Gjykatën Administrative ose gjashtë vjet përvojë në një organ shtetëror.

PROKURORËT PUBLIKË: Konform Ligjit të Prokurorisë Publike¹⁰ kandidati për prokuror publik, përveç kushteve të përgjithshme, duhet të ketë kryer fakultetin juridik, të ketë dhënë provimin e jurisprudencës, si dhe të ketë kryer trajnimin fillestar në Akademinë e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë. Për prokuror publik në Prokurorinë e Lartë Publike, kandidati duhet patur edhe të paktën tetë vjetë përvojë si prokuror publik në Prokurorinë Themelore Publike, me rezultate të dëshmuara, ose dhjetë vjet përvojë pune në punë juridike pas dhënies së provimit të jurisprudencës. Për prokuror publik në Prokurorinë Publike të RM, kandidati duhet patur të paktën dhjetë vjetë përvojë si prokuror publik, me rezultate të dëshmuara, ose dymbëdhjetë vjet përvojë pune me rezultate të dëshmuara për punë juridike pas dhënies së provimit të jurisprudencës.

⁹Ligji i Gjykatave (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 58/2006, 62/2006, 35/2008, 150/2010, si dhe merren parasysh ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit të Gjykatave, të shpallura në Gazetën Zyrtare nr. 83/2018 të datës 8.5.2018)

¹⁰Ligji i Prokurorisë Publike (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr.150/2007 dhe 111/2008)

Duke konstatuar në mënyrë komparative vitet e përvojës si kusht i posaçëm për avancim në karrierë, është evidente se pragu i viteve të kërkuara të përvojës është më i lartë tek prokurorët publikë. Ndonëse për avancim në Gjykatën e Apelit për gjyqtarët nevojiten katër vjet përvojë, ndërsa për në Prokurorinë e Lartë, ai prag është dyfish më i lartë – tetë vjet.

Në dispozitën e nenit 41 të Ligjit të Këshillit Gjyqësor dhe nenit 45 të Ligjit të Prokurorisë Publike janë përcaktuar kushte plotësuese pothuajse identike – kritere të cilat këshillet janë të detyruar t'i respektojnë dhe të përzgjedhin kandidatin (për gjyqtar apo për prokuror publik) me performanca më të larta teknike dhe profesioniste, i cili gëzon reputacionin dhe integritetin për kryerjen e këtij funksioni.

*Kandidatët për gjyqtarë dhe prokurorë publikë patjetër duhet qenë të pajisur me njohuri teknike, ku do të merren parasysh lloji i specializimit, studimet pasdiplomike dhe edukimi i vazhdueshëm, të kenë qasje profesioniste ndaj punës, ku kërkohet përpikëria në kryerjen e punës, respektimi i afateve ligjore, hartimi i vendimeve dhe akteve gjyqësore apo të prokurorisë së lartë në kuadër të afateve të përcaktuara me ligj, transparenca dhe shpallja e vendimeve, cilësia e vendimeve të përgatitura nga aspekti i argumentimit dhe qëndrueshmërisë së tyre, e cila cilësi është vështruar nëpërmjet të vendimeve të organeve më të larta.

*Kandidatët patjetër duhet poseduar aftësi për zgjidhjen profesioniste të çështjeve më të ndërlikuara juridike.

*Gjyqtari dhe prokurori publik patjetër të kujdesen për reputacionin e funksionit të gjyqtarit, gjegjësisht, të prokurorit publik, që para së gjithash, manifestohet përmes mënyrës në të cilën shtjellohet procedura, komunikimi me palët dhe organet tjera, ruajtja e pavarësisë, mëvetësisë, paanshmërisë dhe besueshmërisë në kryerjen e funksionit, marrja e punës plotësuese në kryerjen e funksionit, nëpërmjet të pjesëmarrjes në projekte për hartim të ligjeve dhe normave tjera, mentorimit, edukimit e ngjashëm.

*Gjyqtari dhe prokurori publik patjetër duhet patur qasje profesioniste ndaj shërbimit administrativ.

Veç këtyre kritereve, gjatë zgjedhjes së gjyqtarit, Këshilli Gjyqësor është i obliguar të merr mendim, i cili do të jetë rezultat i anketës së zbatuar në mesin e punonjësve në gjykatën në të cilën kandidati po kryen funksionin.

Kriteret dhe procedura e vlerësimit dhe vëzhgimit të punës së gjyqtarëve dhe prokurorëve publikë

VLERËSIMI I GJYQTARËVE: Konform dispozitave të Ligjit të Këshillit Gjyqësor, vlerësimi i gjyqtarëve është rezultat i ndjekjes dyvjeçare të vazhdueshme të punës së tyre dhe i kontributit të tyre për zhvillimin e të menduarit juridik. Me këtë, me ligjin janë përcaktuar kritere kuantitative dhe kualitative që paraqesin përmbajtjen e formularit i cili mbushet për çdo gjyqtar veçanërisht¹¹. Kriteret kuantitative janë në fakt, të dhënat dhe informacionet që merren përmes sistemit informatik të administrimit të lëndëve (AKMIS), ndërsa ato kanë të bëjnë me numrin, llojin e vendimeve dhe lëndëve të zgjidhura, në raport me numrin orientues të lëndëve të zgjidhura për muaj. Kriteret kualitative përcaktohen nëpërmjet qasjes së gjyqtarit ndaj punës, duke marrë parasysh respektimin e afateve ligjore për marrjen e veprimeve procedurale, për sjelljen dhe shpalljen e vendimeve gjyqësore, përmes numrit të aktgjykimeve të konfirmuara, të ndryshuara dhe të pezulluara, në raport me numrin e përgjithshëm të lëndëve të zgjidhura. Këto kritere paraqesin bazën e përlllogaritjes së notave për punën e gjyqtarit, duke marrë parasysh edhe kohën efektive të punës. Me ligjin është përcaktuar metodologjia e përlllogaritjes së pikëve për çdo kriter veçanërisht dhe bëhet përcaktimi i notës përfundimtare, e cila, në bazë të totalit të pikëve të marra nga të gjitha kriteret, mund të jetë pozitive ose negative. Në fund, Këshilli Gjyqësor sjell aktvendim mbi vlerësimin e punës së gjyqtarit, i cili ngërthen në vete arsyetimin e arsyeve për vlerësimet.

VLERËSIMI I PROKURORËVE PUBLIKË: Për dallim nga Ligji i Këshillit Gjyqësor, i cili plotësisht rregullon çështjen e kriterëve dhe vlerësimit të punës së gjyqtarëve, Ligji i Prokurorëve Publikë përcakton se vlerësimin e punës së prokurorit publik jep prokurori publik i menjëherëshëm më i lartë, për një periudhë dyvjeçare, ndërsa procedurën dhe mënyrën e vlerësimit përcakton Këshilli i Prokurorëve Publikë, me një Rregullore të posaçme. Vlerësimi i punës së prokurorëve publikë themelohet mbi kriteret e përcaktuara që kanë të bëjnë me:

- teknikën dhe profesionalizmin e kryerjes së funksionit, që parapëlqen aplikimin e duhur të Kushtetutës dhe ligjeve;
- paanshmërinë dhe ndërgjegjshmërinë, apo joselektivitetit në aplikimin e rregullave dhe posedimi i integritetit që nuk është i nënshtrueshëm ndaj asçfarë influence;

¹¹Veç kushteve – kriterëve nga neni 41 të Ligjit të Këshillit Gjyqësor, me ndryshimet e vitit 2010, për herë të parë janë futur në përdorim këto kritere kuantitative (në masën më të madhe) dhe kualitative, që bëjnë pjesë të vëzhgimit dhe vlerësimit të punës së gjyqtarit, dhe ato janë shndërruar në pikë.

- përpikërinë dhe efikasitetin në procedimin në bazë të kallëzimeve penale dhe lëndëve dhe pjesëmarrjen aktive në veprimet procedurale;
- reputacionin dhe etikën që janë të denja për funksionimin dhe posedimin e autoritetit në mesin ku prokurori vepron dhe jeton;
- aftësinë e komunikimit dhe bashkëpunimit me sjellje profesionale ndaj pjesëmarrësve në procedurë;
- aftësitë organizatore si kusht për kryerjen efikase të punës së përgjithshme në prokurorinë publike;
- edukimin e vazhdueshëm dhe avancimin personal, profesional dhe shkencor nëpërmjet të Akademisë së Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë, avancimin e kapacitetit vetjak profesionist dhe intelektual, shpalljen e punimeve shkencore, e të ngjashme.

Vlerësimi bëhet me një metodë ekzekutive – inspektim i mesëm, me të cilin përcaktohet sasia dhe cilësia në procedimin e lëndëve dhe kallëzimeve penale, vendimet e prokurorit publik dhe bazueshmëria e tyre. Rezultatet e procedurës për vlerësimin e prokurorëve publikë shënohen në një formular të posaçëm, të përcaktuar nga Këshilli i Prokurorëve Publikë. Nota mund të jetë pozitive ose negative.

Nga monitorimi: Konstatimi kryesor është se nëse shikohet me krahasim, ndjekja dhe vlerësimi i punës së gjyqtarëve, nga njëra anë, dhe puna e prokurorëve publikë, nga ana tjetër, dallon në faktin se që nga viti 2010 kriteret (në pjesën më të madhe kuantitative) e ndjekjes dhe vlerësimit të punës së gjyqtarëve, me ligj të shndërruara në pika me metodologji të detajuar (me ndryshimet e fundit të Ligjit të Këshillit Gjyqësor, të shpallura më datë 8.5.2018, këto kriteret në pjesën më të madhe janë kualitative, ku është avancuar edhe metodologjia e përlllogaritjes së pikave¹²), ndërsa kriteret e ndjekjes dhe vlerësimit të punës së prokurorëve publikë, ligjërisht nuk janë shndërruar në pikë.

Përgjegjësia e gjyqtarëve dhe prokurorëve publikë

¹²Shih më detajisht të dhënat e përmbajtura në Raportin e Dytë të Monitorimit, i qasshëm në: <http://ihr.org.mk/p.php?pid=309> nga të cilat mund të shihet se si këto pikë në praktikë, gjatë zgjedhjes së gjyqtarëve nga Këshilli Gjyqësor i RM krijuan një konfuzion në aplikimin e tyre, sidomos në korrelacion me kriteret e nenit 41 të Ligjit të Këshillit Gjyqësor, të cilat kryesisht nuk janë shndërruar në pikë, dhe poashtu, zgjedhja varet nga fundi i shumicës së nevojshme të votave në Këshillin Gjyqësor, që në njëfarë mënyre, bën irelevante kriteret dhe metodologjinë e pikësimit të tyre.

Në pajtim me Ligjin e Këshillit Gjyqësor, funksioni i gjyqtarit pushon në qoftë se gjyqtari dënohet me vendim të prerë gjyqësor për denim me burg pa kusht nga të paktën gjashtë muaj, dhe sipas Ligjit të Prokurorisë Publike, funksioni i prokurorit publik pushon në qoftë se prokurori publik dënohet me denim me burg nga të paktën gjashtë muaj ose dënim më të shkurtër për një vepër penale e cila bën atë të padenjë për kryerjen e funksionit. Gjyqtari dhe prokurori publik shkarkohen nga funksioni edhe për shkak të një veprimi më të rëndë disiplinor, i cili e bën atë të padenjë për kryerjen e funksionit të gjyqtarit apo prokurorit publik, si dhe për shkak të kryerjes së funksionit në mënyrë joprofesionale dhe jo të ndërgjegjshme, në kushte të përcaktuara me ligj, gjegjësisht, për shkak të joprofessionalizmit të shfaqur që ndikon cilësinë e punës, mosnjohjes së ligjeve dhe hartimit jocilësor të vendimeve. Puna e pandërgjegjshme paraqet shkelje të rëndë të normave etike të përcaktuara me kodet e gjyqtarëve dhe prokurorëve publikë, si dhe kryerja e jashtëligjshme, jo e mëkoshshme ose e pakujdeshme e funksionit, dhe qasja e anshme ndaj punës. Procedura e përcaktimit të punës joprofesionale dhe të pandërgjegjshme të prokurorit publik zbatohet me propozim të Prokurorit Publik të RM, apo Prokurorit të Lartë Publik, ndërsa vendimin për shkarkim sjell Këshilli i Prokurorëve Publikë. Procedura e përcaktimit të punës joprofesionale dhe të pandërgjegjshme të gjyqtarit deri në janar 2018 ngritej me kërkesë të Këshillit të Përcaktimit të Fakteve dhe Ngritjes së Procedurës për Përcaktimin e Përgjegjësisë së Gjyqtarit, ndërsa pas pezullimit të këtij organi dhe ndryshimeve të Ligjit të Këshillit Gjyqësor (sidomos me ndryshimet e fundit të majit 2018), procedura e përcaktimit të përgjegjësisë së gjyqtarit nisët me kërkesë nga kushdo (faktikisht, do të thotë se mund të paraqitet nga cilido person fizik ose juridik ose nga cilido gjyqtar, kryetar gjykate, ose anëtar i Këshillit Gjyqësor, e të ngjashme.¹³⁾

Këshilli për Përcaktimin e Fakteve dhe Ngritjen e Procedurës për Përcaktimin e Përgjegjësisë së Gjyqtarit

Këshilli i Përcaktimit të Fakteve¹⁴ formimi i të cilit ishte arsyetuar me nevojën e dyshkallshmërisë në procedurën disiplinore kundër një gjyqtari, ishte organ i mëvetësishëm dhe i pavarur për ngritjen e procedurës për përcaktimin e përgjegjësisë dhe punës së tij të pandërgjegjshme ose joprofesionale. Veç kësaj, Këshilli i Përcaktimit të Fakteve ishte kompetent

¹³Shihni më detajisht Ligji mbi ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit të Këshillit Gjyqësor, Gazeta Zyrtare nr. 83/2018 e datës 8.5.2018

¹⁴Është ky titulli i shkurtuar që më së shpeshi përdorej për ta evidentuar këtë organ

të procedojë edhe me ankesa dhe parashtrës të paraqitura nga qytetarë, të grumbullojë të dhëna dhe prova në lidhje me dokumentet e paraqitura, të bëjë vështrimin e menjëhershëm në dokumentet e gjykatës, të përfaqësojë kërkesën për ngritjen e procedurës përpara Këshillit Gjyqësor. Këshilli i Përcaktimit të Fakteve, në bazë të provave dhe të dhënave të mbledhura, në qoftë se përcakton bazueshmërinë e tyre, parashtron një kërkesë për nisje të procedurës përpara Këshillit Gjyqësor, apo më saktësisht, iniciativën do ta hedh poshtë si të pabazë.

Nga monitorimi: Këshilli i Përcaktimit të Fakteve në muajin janar të vitit 2018, u pezullua me ligj, dhe kështu u realizua një nga prioritetet e reformave të Qeverisë së RM. Përpara pezullimit të tij, ky organ paraqiti 6 kërkesa për ngritje të procedurave për përcaktimin e përgjegjësisë kundër 14 gjyqtarëve, të cilat tani po procedohen nga Këshilli Gjyqësor¹⁵.

Transparenca në punën e Këshillit Gjyqësor dhe e Këshillit të Prokurorëve Publikë

Transparenca si parim në një shoqëri demokratike siguron që praktikimi i pushtetit të jetë sa më afër qytetarëve, në mënyrë që ata të binden se organet e pushtetit kryejnë funksionet e veta, secili në mënyrën e vet. Transparenca paraqet një instrument i publikut, i cili kërkon përgjegjësi dhe llogaridhënie, sepse publiku ka të drejtë të jetë i informuar. Kur bëhet fjalë për transparencën në punën e Këshillit Gjyqësor dhe e Këshillit të Prokurorëve Publikë, patjetër duhet të theksohet se ajo nuk trajtohet menjëherë në ligjet në fjalë dhe aktet e tyre nënligjore, ndërsa del nga normat që nuk janë me karakter procedural. Ekzistojnë dispozita nga të cilat del se puna në seancat e këtyre organeve është publike, si dhe dispozita që referojnë drejt obligimit për furnizimin e mundësisë për qasje në informacione – hapja e ueb faqeve, komunikatat dhe informacionet për mjetet e informimit publik. Nga ky aspekt, vërehet se Këshilli Gjyqësor është mjaftë i angazhuar në komunikimin me mediat¹⁶ që fatkeqësisht, nuk mund të thuhet edhe për Këshillin e Prokurorëve Publikë.¹⁷

Megjithatë, informimi i publikut në vete nuk do të thotë transparencë të plotë, informimi për seancat dhe vendimet e sjella nuk mjafton që publiku ta shikojë përmbajtjen dhe bazat mbi të cilat janë sjellë këto vendime. Transparenca nënkupton njohjen e motiveve dhe arsyeve që kanë

¹⁵Shiko më detajisht në Raportin e Tretë të Monitorimit: <http://ihr.org.mk/p.php?pid=347>

¹⁶Më detajisht për transparencën, llogaridhënien dhe efektshmërinë e Këshillit Gjyqësor, shiko në analizën vijuese të detajuar: [http://ihr.org.mk/uploads/IHR%20-%20Analiza-Transparentnost%252c%20otcetnost%252c%20efektivnost_SSRM%20\(web\).pdf](http://ihr.org.mk/uploads/IHR%20-%20Analiza-Transparentnost%252c%20otcetnost%252c%20efektivnost_SSRM%20(web).pdf)

¹⁷Për transparencën e Këshillit të Prokurorëve Publikë, shiko më detajisht në Raportin e Parë, të Dytë dhe të Tretë të Monitorimit, në kuadër të këtij projekti në: <http://ihr.org.mk/project.php?pid=236>

çuar drejt sjelljes së vendimeve të tilla. Në këtë kuptim, sigurimi i publicitetit në seancat për zgjedhjen e gjyqtarëve dhe prokurorëve publikë nuk do të thotë sigurim të transparencës në qoftë se në seancë mungon mundësia e njohjes së arsyeve për sjelljen e vendimit për zgjedhje sidomos në rastet kur ka më shumë kandidatë. Anëtarët e këtyre dy këshilleve gëzojnë të drejtën të deklarohen për kandidatët përpara se të bëhet votimi. Për arsye se kjo e drejtë e tyre ishte shfrytëzuar shumë rrallë, me ndryshimet e Ligjit të Këshillit Gjyqësor të dhjetorit 2017, deklarimi i kandidatëve kaloi në një obligim ligjor për anëtarët e Këshillit Gjyqësor. Në fakt, transparenca thelbësore është në atë që pas çdo vendimi të qëndrojë një arsyetim i mirë dhe një debat i argumentuar. Anëtarët e Këshillit të Prokurorëve Publikë në masë të madhe shfrytëzuan këtë të drejtë të tyre të deklarimit gjatë seancave të mbajtura nga fundi i vitit 2017 dhe në fillim të vitit 2018.¹⁸

Konform dispozitave të rregullave të punës së Këshillit Gjyqësor dhe të Këshillit të Prokurorëve Publikë gjatë zgjedhjes së kandidatëve për gjyqtarë, apo për prokurorë publikë, votohet me renditjen e rang-listës, të përbërë sipas pikësimit të bërë paraprakisht, ku është e mundur zgjedhja e kandidatit që nuk ka numrin më të lartë të pikëve, e as notën më të lartë pozitive. Mënyra e votimit mundëson që zgjedhja thjeshtë të reduktohet në numërimin e votave, në vend se në mënyrë transparente të jepen arsyet thelbësore për vendimin e zgjedhjes. Publiku ka të drejtën e pritjes që zgjedhja të mos jetë vetëm me ngritje të dorës, por ajo të jetë rezultat i vendimeve të arsyetuara dhe të argumentuara, të cilat do të bindnin atë në zgjedhjen më të mirë cilësore.

Nga monitorimi: Në periudhën e analizuar, Këshilli Gjyqësor më së shpeshi, në vendimet për zgjedhjen e kandidatit, në ueb faqen e vet po shpall të dhëna të shkurtëra biografike për kandidatin, pa shpallur argumentet që kishin qenë vendimmarrëse për shumicën e anëtarëve, për ta zgjedhur atë kandidatë, përkundër kandidatëve e pazgjedhur. Për dallim nga Këshilli Gjyqësor, Këshilli i Prokurorëve Publikë është me kapacitet larg më të kufizuar dhe ueb faqja e tij varfërisht po azhurnohet.¹⁹

¹⁸Shih më detajisht në Raportin e Dytë dhe të Tretë të Monitorimit, të qasshëm në: <http://ihr.org.mk/project.php?pid=236>, por kini parasysh se përpara këtij projekti, Këshilli i Prokurorëve Publikë fatkeqësisht, nuk ishte lëndë e monitorimit tonë (që ishte rasti me Këshillin Gjyqësor të RM).

¹⁹Në lidhje me kapacitetet e kufizuara, para së gjithash, kapacitetet njerëzore në Këshillin e Prokurorëve Publikë, përqindje të madhe për këtë gjendje ka pozicionimi i ndarjes së buxhetit nga i cili ky organ financiohet, dhe kjo bëhet nga buxheti i Prokurorisë Publike, e cila në esencë, në mënyrë hierarkike dhe funksionale, bie nën Këshillin e Prokurorëve Publikë. Ky pozicionim i palogjikshëm dhe jopraktik duhet të mënjanohet.

Transparenca në zgjedhjen e gjyqtarëve dhe prokurorëve publikë është thelbësore edhe nga aspekti i të drejtave të kandidatëve që nuk janë zgjedhur. Ata gëzojnë të drejtën legjitime që të presin në një procedurë transparente, sipas kritereve të përcaktuara, një vendim të elaboruar dhe të argumentuar mirë, nga i cili shihet se kandidatura e tyre ishte trajtuar me seriozitet. Me ndryshimet e Ligjit të Këshillit Gjyqësor të dhjetorit 2017, kandidati që nuk është zgjedhur gëzon të drejtën e ankesës përpara Gjykatës Supreme të RM.

Në drejtim të procedurave për punë të pandërgjegjshme dhe joprofesionale dhe përgjegjshmërisë disiplinore, dhe duke patur parasysh ndjeshmërinë e tyre, në mënyrë që të mbahet llogari për reputacionin, dinjitetin dhe integritetin e gjyqtarit dhe prokurorit publik, dispozitat ekzistuese të ligjeve sigurojnë transparencë të mjaftueshme.

Nga këndvështrimi i parimit të transparencës, meriton vëmendje edhe përmbajtja e kriterit “jurist i shquar”, i cili aplikohet gjatë zgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit të Prokurorëve Publikë. Sipas Ligjit të Këshillit Gjyqësor, Kuvendi i RM zgjedh pesë anëtarë të Këshillit Gjyqësor nga rendi i profesorëve universitarë të drejtësisë, avokatëve dhe juristëve tjerë të dalluar, ndërsa konform Ligjit të Këshillit të Prokurorëve Publikë, Kuvendi zgjedh katër anëtarë të Këshillit të Prokurorëve Publikë nga rendi i juristëve të dalluar. Kritere plotësuese për atë që nënkupton nocioni “jurist i shquar”, nuk ishin identifikuar deri në vitin 2015, kështu që në praktikë ishte mundësuar zgjedhja jotransparente, e paarsyetuar e kandidatëve, të cilët thjeshtë dekoroheshin me atributin “jurist i shquar”. Me insistimin e vazhdueshëm të Institutit për të Drejtat e Njeriut, i cili këtë gjë prezantoi në shumë analiza që i përkisnin fushës së drejtësisë, në ndryshimet ligjore të vitit 2015, u përkufizua me kritere më të hollësishme se kush do të konsiderohej si jurist i dalluar gjatë bërjes së zgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Gjyqësor nga Kuvendi i RM.²⁰ Precizimi plotësues i kësaj norme kauçuk akoma nuk është futur në Ligjin e Këshillit të Prokurorëve Publikë, ndryshimet e fundit të të cilit janë bërë në vitin 2011.

Nga monitorimi: Nga tre raportet e monitorimit të përpiluar në kuadër të këtij projekti, mund të konstatojmë se kjo normë kauçuk “jurist i shquar”, pjesërisht po respektohej nga Kuvendi i RM gjatë zgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit të Prokurorëve Publikë, ku mund të vërehet një tendencë e vogël e respektimit të shtuar të domethënies së saj thelbësore gjatë disa muajve të fundit.

²⁰Të gjitha analizat relevante janë të qasshme në linkun vijues: <http://ihr.org.mk/publikacii.php>

KONKLUZIONET DHE REKOMANDIMET E PRIORITETEVE 1 DERI 5:

3.1. Duke patur parasysh periudhën nga viti 2015, madje edhe gjatë monitorimit përfundimisht me majin e vitit 2018, avancimi i gjyqtarëve nga Këshilli Gjyqësor po bëhet në mënyrë jokonkzistente (nganjëherë po zgjedheshin gjyqtarë me numrin më të lartë të pikëve, e nganjëherë jo), për të cilën, një pjesë e caktuar e arsyeve u gjetën brenda dispozitave ligjore pamjaftueshëm të qarta. Kurse, në avancimin e prokurorëve publikë nga Këshilli i Prokurorëve Publikë, u shfaqën reagime nga shumë anë në mediat (disa të bazuara, e disa jo), që flet për transparencën dhe llogaridhënien pamjaftueshëm thelbësore të këtij organi.

R.1. Çfarëdo që të jenë dispozitat ligjore në një çast të dhënë, Këshilli Gjyqësor dhe Këshilli i Prokurorëve Publikë gjatë zgjedhjes dhe avancimit të gjyqtarëve, apo të prokurorëve publikë, duhet çdoherë maksimalisht, me gjithë mjetet e mundshme dhe në të gjitha mënyrat e disponueshme, ta bindin publikun se po e përzgjedhin më cilësorin nga mesi i kandidatëve të paraqitur për funksionin publik konkret.

R.2. Politikëbërësit (Ministria e Drejtësisë, Qeveria dhe Kuvendi, para së gjithash) duhet të marrën një qëndrim të unifikuar në lidhje me kriteret në bazë të të cilave bëhet ndjekja dhe vlerësimi i punës së gjyqtarëve dhe prokurorëve publikë, dhe me këtë edhe avancimin e tyre, që do të thotë se në qoftë se kriteret që lidhen me punën e gjyqtarëve janë pikësuar ligjërisht, e kjo do të thotë se e njëjta duhet të parashikohet edhe për prokurorët publikë.

R.3. Përqindja më e lartë e kriterëve kualitativë përkundër atyre kuantitativë të ndjekjes dhe vlerësimit të punës së gjyqtarëve (që u vendos me ndryshimet e fundit ligjore të majit 2018) është për ta përsëndetur, por megjithatë, nevojitet mbushja e të gjitha boshllëqeve juridike brenda ligjeve, të cilat mund të çojnë drejt shpërdorimit të këtyre kriterëve në praktikë gjatë zgjedhjeve dhe avancimeve të ardhshme.

K.2. Domethënia thelbësore e normës “jurist i dalluar” pjesërisht po respektohet nga Kuvendi i RM gjatë zgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Gjyqësor dhe të Këshillit të Prokurorëve Publikë.

R.4. Të vazhdojë mbarëvajtja e tendencës së ulët të respektimit të shtuar të domethënies thelbësore të normës “jurist i dalluar” përgjatë disa muajve të fundit. Me shembullin e dispozitave të Ligjit të Këshillit Gjyqësor, definimi plotësues i saj duhet të parashikohet edhe me Ligjin e Këshillit të Prokurorëve Publikë.

K.3. Kapacitetet njerëzore në Këshillin e Prokurorëve Publikë janë në nivel shumë më të ulur në raport me ato të Këshillit Gjyqësor. Këshilli Gjyqësor nuk ka një strategji mjaftueshëm të

zhvilluar, e as kapacitete të brendshme për komunikim me gjykatat, me të gjitha palët e interesit e sidomos me mediat. Gjendja e njëjtë vërehet edhe në Këshillin e Prokurorëve Publikë.

R.5. Të fuqizohen kapacitetet e Këshillit të Prokurorëve Publikë, sidomos në pjesën e kapaciteteve njerëzore dhe të mënjanoen pengesat që ekzistojnë në financimin e këtij organi nga buxheti gjyqësor.

R.6. Të rritet roli proaktiv i Këshillit Gjyqësor dhe i Këshillit të Prokurorëve Publikë në sigurimin e transparencës, llogaridhënies, por edhe të efektshmërisë thelbësore, duke u nisur nga postulati se mjetet buxhetore (“paratë e qytetarëve”) duhet t’i shfrytëzojnë në mënyrën më efikase të mundur (për qytetarët), sepse anëtarët e këtyre organeve janë bartës të funksioneve publike.

R.7. Nevojitet edhe përcaktimi ligjor i përgjegjësisë konkrete për anëtarët e Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit të Prokurorëve Publikë, sepse ndryshimet e deritanishme nuk kanë arritur këtë prioritet, i cili është hartuar edhe në Strategjinë e Reformave në Sektorin e Jurisprudencës.

PJESA 2:

PRIORITETET URGJENTE REFORMATORE FOKUSI I TË CILAVE ËSHTË PUNA E AKADEMISË SË GJYQTARËVE DHE PROKURORËVE PUBLIKË DHE SHPALLJA E VENDIMEVE GJYQËSORE

Autorë: m-r Simonida Kacarska dhe m-r Iva Conevska

Prioriteti 6: Avancimi i cilësisë së trajnimit, buxheti dhe autonomia e Akademisë së Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë (si dhe të inkurajohet dërgimi i gjyqtarëve kombëtarë për stazh pune në GJEDNJ)

Metodologjia

Për analizimin e statusit të përmbushjes së këtij prioriteti, u aplikuan metoda kuantitative dhe kualitative të hulumtimit. Për grumbullimin e të dhënave u përdor analiza në zyrë, u zabua një intervistë dhe sondazh. U përdor dhe analiza normative për Ligjin e Akademisë së Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë, ndryshimet e Ligjit të nëntorit dhe dhjetorit 2015, si dhe aktet nënligjore të sjella konform Ligjit, me qëllim identifikimi i zgjidhjeve të paqëndrueshme dhe problemeve në implementim. Veç kësaj, u shqyrtuan edhe zgjidhjet e propozuara të cilat kanë të bëjnë me AGJPP, të përcaktuara me Strategjinë e Reformave në Sektorin e Jurisprudencës për periudhën 2017 – 2022 dhe me Planin e Veprimit. U analizuan edhe raportet e Komisionit

Evropian, rekomandimet e dhëna në raportet e grupit ekspert të udhëheqir nga Priebe, buxhetet që i janë ndarë AGJPP, si dhe raportet e AGJPP, programet dhe katalogjet e AGJPP. U zbatua edhe një intervistë me një përfaqësues të AGJPP²¹ për të konstatuar kapacitetet kadrovike, teknike dhe infrastrukturore të Akademisë, buxhetin e ndarë, organizimin e trajnimeve dhe përcaktimi i nevojave për organizimin e tyre. Ekipi hulumtues zbatoi një sondazh me dëgjuesit e trajnimit fillestar në Akademi, pjesëmarrësit e trajnimit të vazhdueshëm dhe me ligjeruesit.²² Sondazhi i zbatuar gjatë muajit mars 2018, në bashkëpunim me Akademinë e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë dhe kishte për qëllim të kontribuonte për avancimin e cilësisë së trajnimeve dhe përkufizimin e nevojave të trajnimeve, identifikimin e mangësive në vendimet ligjore, si dhe për avancimin e punës së përgjithshme të AGJPP.²³ Sondazhi iu dërgua dëgjuesve të trajnimit fillestar, të vazhdueshëm dhe ligjeruesve të Akademisë.²⁴

Analiza e prezantuar më poshtë po fokusohet në ndryshimet e kornizës juridike, përfshirë këtu edhe Ligjin e Akademisë dhe aktet nënligjore, buxhetin, si dhe cilësinë e trajnimeve fillestare dhe atyre të vazhdueshme, konform prioritetit të analizuar.

Korniza juridike

Në raportin e grupit ekspert të vitit 2015, si një nga rekomandimet kryesore që kanë të bëjnë me Akademinë ishte rekrutimi i kuadrove për gjyqtarë dhe prokurorë publikë shprehimisht vetëm nga të diplomuarit e AGJPP, u përmend se përzgjedhja e dëgjuesve në Akademinë e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë po bazohet në sistem të meritave.²⁵ Rekrutimi i kuadrove për gjyqtarë dhe prokurorë publik shprehimisht vetëm nga Akademia ishte rekomandimi i vetëm i përmbushur nga pjesa e jurisprudencës, nga raporti i parë i Grupit ekspert të udhëhequr nga Priebe. Në raportin e dytë të grupit ekspert theksohet respektimi i denjë i këtij rekomandimi.²⁶ Një pjesë e publikut profesionist dhe organizatat civile konsideronin se mënyra e këtillë e

²¹ Intervista u zbatua më datë 11.01.2018.

²² Sondazhi u zbatua në mars 2018.

²³ Ekipi i Projektit, e sidomos Instituti i Politikave Evropiane, i cili monitoroi këtë prioritet, falënderon Akademinë për Trajnimin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë për bashkëpunimin e tyre në zbatimin e projektit.

²⁴ Sondazhit iu përgjigjën 19 dëgjues të trajnimit fillestar, 82 pjesëmarrës në trajnime të vazhdueshme dhe 28 ligjerues.

²⁵ Grup i Ekspertëve të Nivelit të Lartë për çështje sistematike në lidhje me sundimin e ligjit, *Rekomandimi i Grupit të Ekspertëve të Nivelit të Lartë për çështje sistematike në lidhje me sundimin e ligjit në përkundër ndjekjes së komunikimeve, të zbuluar në pranverën e vitit 2015*, i qasshëm në: <https://goo.gl/XNxLkb>

²⁶ Grupi i Ekspertëve të Nivelit të Lartë për çështje sistematike në lidhje me sundimin e ligjit, *Vlerësimi dhe rekomandimet e Grupit të Ekspertëve të Nivelit të Lartë për çështje sistematike në lidhje me sundimin e ligjit, viti 2017*, i qasshëm në: <https://goo.gl/3MH4vm>

emërimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve publikë është kufizues për një pjesë të juristëve që kanë përvojë shumëvjeçare në jurisprudencë.²⁷

Në shkurt 2015 u soll një *ligj i ri me procedurë të shkurtuar mbi Akademinë e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë*.²⁸ Gjatë sjelljes së Ligjit, nuk u mundësua një debat përkatës profesionist, një debat publik, ose çfarëdo përfshirje të ekspertëve ose të grupeve të interesit. Për qasjen e këtillë, Ligji hasi në kritika, e ato kryesisht ishin drejtuar kah kriteret e regjistrimit në Akademi, ku ligjdhënësi i jep rëndësi të madhe notës mesatare universitare të kandidatëve. Kriteri i këtillë ka lënë hapësirë për hyrje retroaktive në provimet për përmirësimin e mesatares, duke shmangur në një mënyrë kushtin e vendosur me ligj. Veç kësaj, kritika po vinin nga publiku profesionist se me këtë kriter nuk u jepet rëndësia praktikuesve shumëvjeçarë, gjegjësisht përvojës së grumbulluar përgjatë punës së tyre.²⁹ Veç kriterëve të nevojitura që duhet t'i përmbushin kandidatët për hyrje në Akademi,³⁰ nevojitet hyrja edhe në provimin pranues, i cili është përbërë nga testi kualifikues, testi i integritetit, testi psikologjik dhe provimi që është përbërë nga pjesa praktike dhe pjesa me gojë. Poashtu, për shkak të mbushjes së kuadrove deficitare të prokurorëve publikë, u bënë ndryshime në Ligjin e Akademisë së Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë³¹ për pranimin e dëgjuesve për prokurorë publikë, e të cilët janë përjashtim nga kriteret tanimë të vendosura, që bazohen mbi një sistemi të aplikuar të meritave.³² Përjashtimi i këtillë u kritikua nga Komisioni Evropian, me një dozë shqetësimi në lidhje me

²⁷Pikëpamjet e këtilla u nënvizuan edhe gjatë prezantimit të vendimeve në skicë-Strategjinë e Reformës në Sektorin e Drejtësisë për periudhën 2017 – 2022 në Ministrinë e Drejtësisë, shtator, 2018. Gjithashtu, Dhoma e Avokatëve bëri po të njëjtën vërejtje gjatë sesionit të njëzet e nëntë të Komisionit për Sistem Politik dhe Marrëdhënie midis Komuniteteve pranë Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, 11.04.2018.

²⁸Me ligjin e ri u ndryshuan kriteret për pranim në AGJPP. Kriteri për pranimin e kandidatëve me arsim të kryer të lartë katërvjeçar ishte hedhur poshtë, me të cilën në Ligjin e ri të AGJPP përzgjedhen kandidatë që kanë arsim të kryer të lartë të shkallës VII/I në studime juridike, me notë mesatare nga të paktën 8,0 dhe me studime pasdiplomike me notë mesatare nga të paktën 8,0 ose jurist i diplomuar me 300 kredi të fituara sipas Sistemit Evropian të për Transfer të Kredive (ECTS), me notë mesatare nga të paktën 8,0 në secilin nga 2 ciklet e studimeve universitare.

²⁹Pikëpamjet e këtilla u nënvizuan edhe gjatë prezantimit të vendimeve në skicë-Strategjinë e Reformës në Sektorin e Drejtësisë për periudhën 2017 – 2022 në Ministrinë e Drejtësisë, shtator, 2018. Gjithashtu, Dhoma e Avokatëve bëri po të njëjtën vërejtje gjatë sesionit të njëzet e nëntë të Komisionit për Sistem Politik dhe Marrëdhënie midis Komuniteteve pranë Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, 11.04.2018

³⁰Kriteret janë përkufizuar me nenin 57 të Ligjit të Akademisë së Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë.

³¹Ligji i ndryshimit dhe plotësimit të Ligjit të Akademisë së Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë, Gazeta Zyrtare e RM, nr. 231 e datës 31.12.2015.

³²Mundësia e zgjedhjes së kandidatëve me arsim të kryer të lartë katërvjeçar të shkallës VII/I në studime juridike me mesatare nga të paktën 7,0 ose jurist i diplomuar me 300 kredi të fituara sipas Sistemit Evropian për Transfer të Kredive (ECTS) me mesatare nga të paktën 7,0 në studimet universitare. Njëjtë ka ndryshime edhe në kohëzgjatjen e trajnimit tek këta kandidatë, në 9 muaj, për dallim nga trajnimi fillestar standard i Akademisë, i cili arrin 24 muaj.

reduktimin e kriterëve për emërimin e prokurorëve publikë dhe motivet politike si prapavijë e këtij vendimi.³³

Probleme plotësuese në zbatimin e Ligjit dhe funksionimin efikas të Akademisë paraqisnin edhe *kriteret ligjore për zgjedhjen e organeve drejtuese dhe administrative të Akademisë*. Me Ligjin e ri të vitit 2015, janë parashikuar dispozita ligjore me kushte të reja dhe me mënyrë të re të zgjedhjes së drejtorit, anëtarëve të Bordit Drejtues dhe Këshillit Programik të Akademisë, gjegjësisht, u futën në përdorim provimi elektronik për drejtor, si dhe kriterë më të rreptë në kuptimin e njohjes së gjuhës, testi psikologjik dhe testi i integritetit, që u përkasin edhe anëtarëve të Bordit Drejtues dhe Këshillit Programik. KGJRM, KPPRM dhe MD nuk kanë emëruar anëtarë të Bordit Drejtues sipas Ligjit të ri të vitit 2015. Veç kësaj, në pajtim me vendimin, është parashikuar me Ligjin e ri, që anëtarët e Bordit Drejtues t'i nënshtrohen testit psikologjik dhe testit të integritetit, nevojitet të kenë certifikata për njohjen e gjuhës angleze, si dhe të hyjnë në provim teknik të cilin e zbaton Akademia.³⁴ Nga dispozitat ligjore nuk është e qartë nëse anëtari dhe zëvendës anëtari i emëruar nga Ministri i Drejtësisë duhet t'i nënshtrohet provimit profesional, të posedojë certifikatë për njohje të gjuhës angleze dhe nëse do t'i nënshtrohet testit psikologjik dhe testit të integritetit, që në një mënyrë po bën dallimin midis anëtarëve të BD. Edhe pse në dispozitat kalimtare dhe përfundimtare, në nenin 120 të Ligjit parashikohet se organet e emëruara më herët të drejtimit të Akademisë do t'i kryejnë kompetencat e veta deri në zgjedhjen e organeve të Akademisë, konform Ligjit të miratuar të vitit 2015, *de facto*, për shkak të pamundësisë së kryerjes së zgjedhjes së organeve, Akademia tanimë 3 vjet po funksionon me drejtor dhe me Bord Drejtues me mandat të skaduar.³⁵ Organet e parashikuara të Akademisë akoma nuk mund të formohen dhe të funksionojnë konform ligjit ekzistues, edhe përkundër dërgimit të korrespondencave nga AGJPP për emërim të anëtarëve të Bordit Drejtues. Në këtë gjendje, edhe pse kanë kaluar më shumë vite, akoma vendimet sillen nga organet e Akademisë, të formuara konform ligjit të mëhershëm, ndërsa ligji aktual nuk po aplikohet.³⁶

³³Komisioni Evropian, *Raporti i Komisionit Evropian për Republikën e Maqedonisë i vitit 2016*, fq. 14

³⁴Nenet 11–13, *Ligji i Akademisë së Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë*, (Gazeta Zyrtare e RM, nr. 20 e datës 12.02.2015)

³⁵Propozimi për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit të Akademisë së Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë, i shpallur në ENER në janar 2018, i qasshëm në: <https://goo.gl/Nscu8D>

³⁶Ibid.

Në *Strategjinë e Reformës në Sektorin e Drejtësisë*, identifikohen paqëndrueshmëritë në zbatimin e vendimeve ligjore, si në nevojat kadrovike, teknike dhe infrastrukturore të AGJPP, ashtu dhe në nevojat për organizimin e një lloji të posaçëm të trajnimeve. Strategjia parashikon analizën e nevojave për organizimin e një lloji përkatës të trajnimeve. Strategjia parashikon analizën e krijimit të mundshëm të një programi të ri për trajnim të posaçëm fillestar për praktikues me përvojë afatgjatë, si dhe për trajnimet e vazhdueshme, me anë të ridefinimit të programeve dhe metodave për zbatimin e trajnimeve. Në të është parashikuar edhe aplikimi i kriterëve të reja ligjore për përbërjen e organeve të drejtimit dhe administrimit të AGJPP, si dhe ekipimi plotësues kadrovik dhe teknik, dhe furnizimi i kushteve përkatëse hapësinore.³⁷

Në pajtim me Strategjinë, Ministria e Drejtësisë hartoi një skicë-Ligj për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit të Akademisë së Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë, i cili u shpall në ENER në janar të vitit 2018. Me propozim-ndryshimet u pezullua hyrja në testin psikologjik dhe testin e integritetit, u pezullua njohja e gjuhës angleze për anëtarët e BD, Këshillin Programik dhe ligjeruesit, pezullohet nënshtrimi në provim për drejtorin, që ishte parashikuar që t'i nënshtroheshin drejtori, anëtarët e Bordit Drejtues dhe anëtarët e Këshillit Programik të Akademisë së Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë. Si pengesa në funksionimin e AGJPP në tekst janë numëruar procedura e ndërlikuar e hyrjes në provimin elektronik për drejtorin, anëtarët e Bordit Drejtues dhe të Këshillit Programik, për gjyqtarët dhe prokurorët publikë, shpenzimet për marrjen e certifikatës në gjuhën angleze, dhe e cila ka kohëzgjatje të kufizuar, si dhe shpenzimet e larta financiare të buxhetit gjatë zbatimit të provimit elektronik.³⁸ Konfirm Planit të Veprimit, këto ndryshime duheshin të votoheshin në Kuvendin e RM në janar 2018.³⁹ Ndryshimet e propozuara ligjore akoma nuk gjenden në procedurë parlamentare. Me qëllim harmonizimi i propozim-ndryshimeve të Ligjit të Akademisë së Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë me ndryshimet e propozuara në skicë-tekstin e Ligjit të Gjykatave, u propozua që testi për njohjen e një gjuhe të huaj të jetë në kuadër të dhënies së provimit pranues në AGJPP. Nevojiten ndryshime plotësuese të Ligjit të Akademisë së Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë, para së gjithash në kuptimin e kriterëve të pranimit të dëgjuesve për trajnim fillestar, rritjes së

³⁷ Ministria e Drejtësisë, *Strategjia e Reformës në Sektorin e Drejtësisë për periudhën 2017 -2022*, e qasshme në: <http://www.pravda.gov.mk/documents/29.11.2017AkciskiPlannovo%20za%20veb.pdf>

³⁸ Në pajtim me propozimin e shpallur për ndryshim dhe plotësim të Ligjit të Akademisë së Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë në ENER, janar, 2018

³⁹ Përfundimisht me përpilimin e kësaj analize, me datë 28.05.2018, këto ndryshime akoma nuk kishin hyrë në procedurë parlamentare.

honorareve të anëtarëve të Këshillit Programik⁴⁰, duke ditur vëllimin dhe përgjegjësinë e punës së tyre, si dhe dhënia e provimit elektronik për pjesët praktike të provimeve.

Në pajtim me Ligjin e Akademisë së Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë të vitit 2015, u sollën edhe aktet nënligjore të Akademisë, u sollën edhe ndryshime dhe plotësime të disa akteve nënligjore. **Rregullorja për zbatimin e provimit të gjyqtarëve porotë** u soll me vonesë, ndërkaq, në shkurt 2017. Gjatë zbatimit të pjesës teorike të trajnimit fillestar, në dy raste të posaçme, në korrik 2017⁴¹ dhe në janar 2018⁴², u bënë ndryshime në **Rregulloren e trajnimit fillestar i cili u soll në shkurt 2017**.⁴³ Ndryshimet kanë të bëjnë me testin e verifikimit të njohurive dhe vlerësimin e detyrave me shkrim dhe detyrave të shtëpisë. Këto ndryshime lehtësojnë mënyrën e nënshtrimit ndaj testit, me publikimin e një baze të të dhënave dhe studimeve praktike për përgatitjen e testit, në ueb faqen e AGJPP, më së voni 60 ditë përpara hyrjes në provim. Pyetjet dhe studimet e rastit janë shpallur në ueb faqen e AGJPP. U shpallën edhe studime rasti me pyetje të ofruara. Një lehtësim plotësues për hyrjen në provim janë edhe përgjigjet e ofruara, e që janë përcaktuar me Rregulloren, të cilat, për dallim nga vendimi i mëhershëm, parashikohet të ketë një përgjigje të saktë dhe dy të pasakta. Ndryshime janë bërë edhe në mënyrën e pikësimit, kështu që pikët negative janë mënjtuar, andaj pra, tani për një përgjigje të gabuar, nuk merren pikë negative.

Buxheti

Mjetet e parashikuara për financimin e pushtetit gjyqësor, të përcaktuara me Ligjin e Buxhetit Gjyqësor,⁴⁴ ku hy edhe financimi i Akademisë së Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë akoma nuk arrin **nivelin e përcaktuar me ligj nga 0,8% të PBB**.⁴⁵ AGJPP, për vitet 2016 dhe 2017 ka një buxhet të shtuar, por megjithatë vazhdon me praktikën që përmes ribalancimit të

⁴⁰ Në të njëjtën pozitë gjendet edhe AGJPP, Intervista e zbatuar me një përfaqësues të AGJPP, 11.01.2018

⁴¹ Akademia e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë, *Rregullorja për ndryshimin e Rregullores për Trajnimin Fillestar*, Gazeta Zyrtare nr. 88/17, e qasshme në <https://goo.gl/tBmuZY>

⁴² Akademia e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë, *Rregullorja për ndryshimin e Rregullores për Trajnimin Fillestar*, 15.01.2018, e qasshme në <https://goo.gl/yi4AGQ>

⁴³ Akademia e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë, *Rregullorja për Trajnimin Fillestar*, Gazeta Zyrtare e RM, nr. 19 e datës 16.2.2017

⁴⁴ Neni 2, *Ligji i Buxhetit Gjyqësor*, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë numër 37 e datës 28.03.2006 dhe me numër 103/08 e datës 19.08.2008 (e cila po aplikohet që nga 1 janari 2009), numër 145/2010.

⁴⁵ Analiza e Shoqatës së Punonjësve Financiarë e përpiluar në kuadër të projektit Rrjeti 23+ dëshmon se analizat e fundit dëftojnë për faktin se mund të vërehet se mjetet financiare të menduara për pushtetin gjyqësor si përqindje e PBB, duke filluar nga viti 2010, e përfundimisht me vitin 2017 po shënojnë një rënie të vazhdueshme edhe përkundër asaj se, në shumica absolute, mjetet e veçuara shënojnë një rritje të vazhdueshme.

buxhetit, buxheti i këtillë të shkurtohet.⁴⁶ Buxheti i Akademisë së Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë për vitin 2016 arrin 41.403.000,00 denarë⁴⁷ – që paraqet një rritje nga 15% në raport me buxhetin e planifikuar për Akademinë për vitin 2015. Në vitin 2017 ai arrinte 41.125.000,00 denarë, dhe pas ribalancimit të kryer, ai është reduktuar dhe arrinte 38.415.000,00 denarë. Rritja e buxhetit të AGJPP për vitet 2016 dhe 2017 qëndron në rreshtin e rrogave, apo rrogave të parashikuara për dëgjuesit e trajnimit fillestar.⁴⁸ Megjithatë, mbetet përshtypja se është kjo një shumë akoma e vogël në raport me nevojat për trajnim, të cilat në procesin e aderimit në BE, vetëm plotësueshëm do të shtohen. Përderisa zbatimi i një numri të madh të seminareve dhe trajnimeve me ndihmën e donatorëve të huaj është për ta përshëndetur në kuptimin e bashkëpunimit të cilin Akademia realizon, hap edhe pyetjen për qëndrueshmërinë e saj afatgjate dhe ngritjen e cilësisë së trajnimeve. Veç kësaj, rritja e buxhetit të AGJPP nevojitet edhe për shkak të implikimeve financiare të cilat ofrojnë vendime ligjore që nga 2015 e këtej, si dhe rritje të cilësisë së trajnimeve dhe përmirësim të mundësive teknike dhe infrastrukturore. AGJPP çdo vit buxhetor hy në borxhe.⁴⁹

Cilësia e trajnimeve

AGJPP vazhdimisht punon në drejtim të avancimit të cilësisë së trajnimeve dhe futjes së temave të nevojitura për trajnim, në bazë të vlerësimeve të zbatuara të trajnimeve dhe propozim temave të dërguara nga Këshilli Gjyqësor, Këshilli i Prokurorëve Publikë, nga ekspertë dhe nga organizata joqeveritare. Në vitin 2015, Akademia filloi së implementuari një vendim të ri ligjor për vlerësimin e efikasitetit të trajnimeve. Gjatë vitit 2017, për nevojat e trajnimit të vazhdueshëm, Akademia hartoi një pyetësor të ri, me të cilin më gjerësisht vlerësohen: përmbajtja dhe qëllimi i trajnimit, ligjeruesit, materialet e trajnimit, suksesi i programit, ndërsa është lënë një pjesë edhe për propozime dhe komente. Hartimi i pyetësorit vijoi si rezultat përfundimtar i projektit për zhvillim të një metodologjie të re për vlerësimin e trajnimeve. U përpilua edhe një Raport me rekomandime për zhvillimin e mekanizmave për vlerësim kualitativ të trajnimeve. Një nga ato ishte hartimi i një pyetësori gjithëpërfshirës, i cili edhe më tej mbetet

⁴⁶Veprimi i përbashkët për reforma urgjente në gjyqësor, *Brifingu i dytë Monitorues për Implementimin e Prioriteteve Urgjente të Reformave*, shkurt 2018, i qasshëm në: [http://ihr.org.mk/uploads/IHR%20-%20vtor%20monitoring%20\(fev%202018\)%20\(1\).pdf](http://ihr.org.mk/uploads/IHR%20-%20vtor%20monitoring%20(fev%202018)%20(1).pdf)

⁴⁷ Akademia e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë, *Raporti mbi Punën e AGJPP për vitin 2017*, i qasshëm në: <https://goo.gl/D4cq3U>

⁴⁸Intervista me një përfaqësues të AGJPP, 11.01.2018

⁴⁹Intervista me një përfaqësues të AGJPP, 11.01.2018

të jetë pjesë e materialit të punës për çdo trajnim.⁵⁰ Akademia po ndjek nevojat për organizimin e trajnimeve, të përcaktuara me Strategjinë e Reformës në Sektorin e Drejtësisë.⁵¹ Sipas përfaqësuesve të AGJPP, Akademia vazhdimisht punon edhe për adresimin e rekomandimeve të dhëna në raportet e grupit të ekspertëve të udhëhequr nga Priebe.⁵² Veç kësaj, AGJPP bashkëpunon edhe me institucione të brendshme dhe të huaja, me organizata qytetare, edhe për zbatimin dhe organizimin e trajnimeve dhe këshillimeve.⁵³

Në kuadër të projektit “Fuqizimi i kapaciteteve të gjyqësorit për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe luftimin e sjelljes çnjerëzore dhe poshtëruese dhe luftimin e mosndëshkueshmërisë”⁵⁴ ku AGJPP paraqitet si shfrytëzues dhe partner i projektit, u fuqizuan kapacitetet e AGJPP dhe materialet, me ndihmën e krijimit të tre manualeve mbi të drejtat dhe liritë e njeriut. U fut në përdorim një metodologji e re interaktive, e kombinuar me praktikën e GJEDNJ, si dhe materiale për simulimin e gjyqësor në çdo fushë tematike.

a) Trajnimi fillestar

Në provimin pranues për vitin akademik 2013/2015 në **gjeneratën e pestë** të dëgjuesve, u pranuan gjithsej 13 dëgjues. Numri parimisht i përcaktuar për pranimin e dëgjuesve të trajnimit fillestar ishte 29 dëgjues, i përcaktuar në bazë të vendimeve të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë dhe të Këshillit të Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë.⁵⁵ Në pajtim me rang listën e provimit përfundimtar të gjeneratës së pestë të dëgjuesve, gjithë 13 dëgjuesit kanë kryer trajnimin me sukses. Gjatë vitit 2016, u përfundua procedura për zbatimin e provimit përfundimtar. Pas shpalljes së rang-listës preliminare nga nënshtrimi në provimin përfundimtar, më datë 25 dhjetor 2015, si dhe pas përfundimit të procedurës, pas negociatave dhe ankesave të dëgjuesve, Komisioni i Provimit Përfundimtar, më datë 10 shkurt 2016, shpalli rang-listën përfundimtare të kandidatëve për gjyqtarë dhe prokurorë publikë. Pas shpalljes dhe dërgimit të kësaj liste përpara Këshillit Gjyqësor të RM dhe Këshillit të Prokurorëve Publikë të RM, filloi

⁵⁰ Akademia e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë, *Raporti mbi Punën e Akademisë së Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë për vitin 2015*, fq., 39

⁵¹ Veprimi i Përbashkët për Reforma Urgjente në Gjyqësor, *Raporti i Tretë i Monitorimit për Zbatim të Funksioneve Urgjente të Reformave në Gjyqësor*, i qasshëm në <https://goo.gl/dLcGtA>

⁵² Intervista me një përfaqësues të AGJPP, 11.01.2018

⁵³ Konform raporteve dhe komunikatave të AGJPP

⁵⁴ Projekti u implementua gjatë periudhës shkurt 2016 deri në maj 2018. Në kuadër të projektit u trajnuan 20 ligjerues në lidhje me nenet 3, 5 dhe 6 të GJEDNJ. U trajnuan 118 gjyqtarë, 74 prokurorë publikë dhe 37 dëgjues për trajnimin fillestar në lidhje me standardet dhe praktikën e GJEDNJ.

⁵⁵ Akademia e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë, *Raporti i Punës së Akademisë së Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë për vitin 2015*, fq. 18

praktikimi i funksionit të gjyqtarit, gjegjësisht, të prokurorit publik, për dëgjuesit e trajnimit fillestar – kandidatët për gjyqtarë dhe prokurorë publikë. Praktikimi po shtjellohej në pajtim me “Programin e praktikimit të funksionit të gjyqtarit/prokurorit publik” dhe me “Rregulloren e praktikimit të funksionit të gjyqtarit/prokurorit publik”, të miratuara nga Bordi Drejtues i Akademisë. Praktikimi i kandidatëve zgjati deri në emërimin e tyre si gjyqtarë apo prokurorë publikë.

Më 18 mars 2016, pas shpalljes së Këshillit të Prokurorëve Publikë të RM, të publikuar më datë 18 shkurt 2016, 7 kandidatë për prokurorë publikë të gjeneratës V u zgjodhën si prokurorë publikë, si vijon: 5 në PTHP – Shkup, 1 në PTHP – Gostivar dhe 1 në PTHP – Manastir, ndërsa në prill 2016, vetëm 1 kandidat i mbetur për prokuror publik u zgjodh në PTHP - Shkup. Përzgjedhja e kandidatëve për gjyqtarë u krye në shtator dhe tetor 2016, ku 3 kandidatë u zgjodhën në GJTH Shkup 2, 1 kandidat në GJTH Shkup 1 dhe 1 kandidat në GJTH Veles, si dhe 2 kandidatë nga gjeneratat e mëhershme, kështu që, nga gjithsej 93 kandidatë që kanë kryer trajnimin fillestar në Akademi, *janë përzgjedhur të gjithë* si vijon: 45 janë caktuar për funksionin e gjyqtarit, ndërsa 48 kandidatë janë përzgjedhur si prokurorë publikë.⁵⁶

Më 9 nëntor 2015, Akademia shpalli thirrjen për *gjeneratën e gjashtë* të dëgjueshve. Në konkurs janë paraqitur 84 kandidatë, 64 nga ata përmbushnin kriteret e nevojitura, nga të cilët 62 kaluan provimin pranues me sukses. Pjesa e provimit me shkrim përbëhej nga zgjidhja e dy studimeve të rastit, pastaj kandidatët iu nënshtruan pjesës së provimit me gojë. Pas përfundimit të pjesës së provimit me gojë, Komisioni i Provimit Pranues konstatoi listën e notave të kandidatëve nga pjesa e provimit e mbajtur me shkrim dhe me gojë, dhe shpalli atë më datë 5 prill 2016. Kandidatët parashtruan 44 kundërshtime ndaj notave të shpallura e kundër aktvendimeve të Komisionit të Provimit Pranues, me të cilat ishin hedhur poshtë kundërshtimet, pastaj kandidatët parashtruan 29 ankesa deri tek Bordi Drejtues i Akademisë, 9 kandidatë ngritën padi përpara Gjykatës Kushtetuese.⁵⁷ Rang-lista përfundimtare u shpall më 10 shkurt 2016, me përfundimin e procedurës për kundërshtime dhe ankesa.⁵⁸ Dallimi në pikë midis kandidatit të ranguar i pari dhe i fundit është 7,13. Trajnimi fillestar i 37 dëgjuesve të gjeneratës së gjashtë filloi me vonesë më datë 1 mars 2017. Konform Programit të Trajnimit Fillestar – mësimdhënia

⁵⁶Akademia e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë, *Raporti mbi Punën e Akademisë së Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë i vitit 2016*, fq. 11

⁵⁷ Ibid. fq. 11.

⁵⁸ Akademia e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë, *Raporti mbi Punën e Akademisë së Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë i vitit 2015*, fq. 11

teorike, u realizuan gjithsej 1220 orë, të ndara në tre module.⁵⁹ Për realizimin e numrit të parashikuar të orëve konform Programit të Trajnimit Fillestar – mësimdhënia teorike, u angazhuan gjithsej 77 ligjerues.⁶⁰ Përveç numrit të parashikuar të orëve konform Programit të Trajnimit Fillestar – mësimdhënia teorike, u realizuan 140 orë plotësuese nga 8 ligjerues të huaj dhe 17 të vendit, si dhe u realizua vizita e institucioneve relevante.⁶¹

Përgjatë zbatimit të pjesës teorike të trajnimit fillestar, në dy raste, në korrik 2017 dhe në janar 2018, u bënë ndryshime të Rregullores së Trajnimit Fillestar në pjesën e testit për verifikimin e njohurive dhe vlerësimin e detyrave me shkrim dhe detyrave të shtëpisë. Këto ndryshime po lehtësojnë mënyrën e nënshtrimit të testit për verifikim të njohurive. Dëgjuesit e trajnimit fillestar më 9 shkurt iu nënshtruan testit për verifikimin e njohurive pas përfundimit të pjesës teorike të mësimdhënies. Dallimi midis të ranguarit të parë dhe të fundit në lidhje me rezultatet e përgjithshme të mësimdhënies teorike është 4.66 pikë.⁶² Dëgjuesit e trajnimit fillestar filluan me pjesën praktike të mësimdhënies në muajin shkurt.

Më 30 gusht 2016, Akademia shpalli konkurs – thirrje për pranimin e 60 dëgjuesve, kandidatë për prokurorë publikë, në përputhje me ndryshimet ligjore të vitit 2015.⁶³ Në shpallje u paraqiten 121 kandidatë.⁶⁴ Ajo që hasi në kundërshtime në publik ishte se në konkurs ishin paraqitur rreth 30 kandidatë për dëgjues, për të cilët ekziston dyshimi i bazuar se kishin parashtruar diploma të falsifikuara për njohjen e gjuhëve të huaja. Bordi Drejtues i Akademisë më datë 11 dhjetor 2017 solli Aktvendimin⁶⁵ për shfuqizimin e Thirrjes Publike për pranimin e 60 dëgjuesve të trajnimit fillestar – kandidatëve për prokurorë publikë.

Në përputhje me të dhënat e *sondazhit të zbatuar me dëgjuesit e trajnimit fillestar* për nevojat e këtij hulumtimi,⁶⁶ dëgjuesit në masë të madhe janë të kënaqur me të. Megjithatë, pothuajse gjysma e të anketuarve tanë (47.4%) konsiderojnë se kohëzgjatja e trajnimit fillestar është e gjatë (47.4%), ndërsa 42.1% konsiderojnë se koha është e përshtatshme. Kohëzgjatjen e

⁵⁹ Akademia e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë, *Raporti mbi Punën e Akademisë së Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë i vitit 2017*, fq. 10.

⁶⁰ Ibid. fq. 12

⁶¹ Ibid. fq. 12

⁶² Numri maksimal i pikëve të fituara për mësimdhënien teorike është 30 pikë.

⁶³ Gazeta Zyrtare e RM, nr. 163 e datës 30.08.2016

⁶⁴ Këshilli Buxhetor Gjyqësor, *Raporti i Punës së Këshillit Buxhetor Gjyqësor dhe realizimi i buxhetit gjyqësor për vitin 2016*, 19.05.2017, fq. 60

⁶⁵ Komunikata është e qasshme në <http://www.jpacademy.gov.mk/novosti/10444>

⁶⁶ Në sondazh u përgjigjën 19 nga gjithsej 39 dëgjues të trajnimit fillestar. Rezultatet e përgjithshme të sondazhit janë të qasshme në këtë [link](#).

mësimdhënies praktike, pjesa më e madhe e dëgjuesve e vlerëson si të mjaftueshme për fitimin e shkathtësive praktike të punës si gjyqtar/prokuror publik. Mësimdhënia teorike pjesërisht dhe në masë të madhe kishte përmbushur pritshmëritë e 77% të të anketuarve. Pjesa më e madhe e të anketuarve janë pjesërisht të kënaqur me cilësinë e ligjeratave (63.2%), plotësisht dhe në masë të madhe janë të kënaqur 22% të tyre. Poashtu, pjesa më e madhe e të anketuarve janë pjesërisht të kënaqur me cilësinë e ligjeruesve.

Rekomandimet nga dëgjuesit:

Të anketuarit tanë dhanë disa rekomandime për përmirësimin e cilësisë së trajnimeve, si dhe rekomandime për ndryshimin e ligjeratave ose lëndëve nga mësimdhënia teorike. Nga shumica e rekomandimeve, do kishim veçuar rekomandimet e mëposhtme, për nevojat e kësaj analize:

Duke patur parasysh se gjysma e të anketuarve konsiderojnë se duhet patur ndryshim në mënyrën e hyrjes në provimet në AGJPP, ne këtu po përfshijmë opinionet e tyre: së pari, të anketuarit rekomandojnë provimin me gojë në vend të provimit elektronik, e dyta, ata nënvizojnë se mungon e drejta e verifikimit, kundërshtimit ose ankesës gjatë hyrjes në provim. Në lidhje me ekipimin e Akademisë, dëgjuesit shprehen se për lëndën e teknologjve informatike, nevojitet që çdo dëgjues të ketë një kompjuter para vete. Në lidhje me përmbajtjen e mësimdhënies, mbizotëron një konsensus i përgjithshëm në mesin e të anketuarve se nevojitet rritja e fondit të orëve të kushtuar shtjellimin praktik të rasteve dhe hartimit të akteve, aktgjykimeve, aktvendimeve dhe letrave dhe kërkesave rrjedhëse, ndërsa për prokurorët – aktakuya, propozime dhe fletëurdhëra. Rekomandohet fokusi i shtuar i bashkëpunimit në materjen penale dhe civile, njohja e aktvendimeve të huaja, ekstradicioni – si fusha që kanë vlerë praktike.

b) Trajnimi i vazhdueshëm

Trajnimi i vazhdueshëm është segmenti më i vëllimshëm i punës së Akademisë dhe përfshin grupe qëllimore në tre programet kryesore të trajnimit, si vijon: programi i përgjithshëm për trajnim të vazhdueshëm detyrimor, programi i specializuar për trajnim të vazhdueshëm detyrimor dhe programi i specializuar për trajnim të vazhdueshëm vullnetar. Tabelat e mëposhtme janë përpiluar në bazë të raporteve vjetore të Akademisë, dhe në to mund të vërehet një rënie e butë në numrin e trajnimeve, dhe si pasojë, dhe në numrin e pjesëmarrësve nga viti 2015 deri në vitin 2017.

Tabela: Pasqyra e numrit të trajnimeve, profilit të pjesëmarrësve nga raportet e AGJPP:⁶⁷

Numri i trajnimeve dhe pjesëmarrësve						
Viti	Numri i trajnimeve	Numri i përgjithshëm i pjesëmarrësve	Gjyqtarë	Prokurorë publikë	Bashkëpunëtorë teknikë	Pjesëmarrës tjerë
2015	267	5888	2814	1014	1468	592
2016	209	4921	2086	738	1252	845
2017	201	4564	1933	615	1280	736

Tabela: Pasqyra e trajnimeve të AGJPP sipas fushave ⁶⁸

Fushat e trajnimeve					
Viti	E drejta civile	E drejta penale	E drejta administrative	E drejta tregtare	Temat e përgjithshme
2015	72	109	12	9	52
2016	44	83	12	8	62
2017	52	81	3	16	39

Në lidhje me përmbajtjen e trajnimeve, po ndiqen ndryshimet e legjislacionit të brendshëm, legjislacionit ndërkombëtar dhe legjislacionit të Bashkimit Evropian, si dhe praktika gjyqësore. Fushat dhe temat që janë parashikuar në Programin Kombëtar për Adoptimin e së Drejtës së Bashkimit Evropian (NPAA) imponojnë detyrimin për procesimin e tyre, andaj pra janë mbajtur trajnime mbi Ligjin e Procedurës Kontestimore, Kodin Penal dhe mbi Ligjin e ri të Procedurës Penale, trajnime mbi luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit dhe mbi krimin financiar, etikën dhe konfliktin e interesave, aplikimi i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, sidomos mbi nenin 10 të saj, fusha të veçura nga e drejta e BE, trajnime në fushën e së

⁶⁷ Akademia e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë, *Raportet mbi Punën e Akademisë së Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë për vitet 2015, 2016 dhe 2017, të qasshme në <https://goo.gl/GCvg1T>, <https://goo.gl/xWKRJR>, <https://goo.gl/Ch5Yp6>*

⁶⁸ Akademia e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë, *Raportet mbi Punën e Akademisë së Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë për vitet 2015, 2016 dhe 2017, të qasshme në <https://goo.gl/GCvg1T>, <https://goo.gl/xWKRJR>, <https://goo.gl/Ch5Yp6>*

drejtës së pronësisë intelektuale, etj. Risi paraqesin trajnimet intensive për agumentim juridik të vendimeve për paraburgim, si dhe për argumentim juridik dhe arsyetim të vendimeve në materjen penale dhe civile.⁶⁹ Megjithë numrin e pjesëmarrësve në trajnime dhe profiling e tyre, me rëndësi të stërdmadhe është inkuadrimi i përfaqësuesve të institucioneve tjera relevante dhe organizatave joqeveritare, që kontriboun për thellimin e bashkëpunimit midis sektorit të drejtësisë, institucioneve dhe organizatave joqeveritare.

AGJPP, në bashkëpunim me Fondacionin Gjerman për Bashkëpunim Ndërkombëtar Juridik dhe me fondet e Ministrisë Federale të Gjermanisë për Punë të Jashtme, organizoi një Program për mbështetjen e rinisë juridike maqedonase. Në kuadër të Programit është parashikuar dhe një qëndrim studimor njëjavor në Gjermani, gjatë të cilit, juristët e rinj maqedonas do të njihen me sistemin juridik gjerman, si shembull i sistemit juridik tradicional kontinental-evropian, i cili është harmonizuar me të drejtën e BE.⁷⁰ Trajnimin vizituan 5 gjyqtarë dhe 10 prokurorë publikë. Ata hynë në testim me shkrim dhe me gojë, pas së cilës do të vijojë dhe një vizitë studimore gjatë muajit maj 2018 në Gjermani, ku pjesëmarrësit për së afërmi do të njihen me këtë sistem juridik, si dhe me punën e institucioneve relevante.⁷¹

Në vitin 2018, AGJPP organizoi disa trajnime dhe këshillime, në mesin e të cilave edhe këshillime për aplikimin e praktikës së GJEDNJ, trajnime këto të menduara për fuqizimin e pavarësisë së gjyqësorit, si dhe këshillim për komunikimin e gjykatave dhe prokurorive publike me publikun. Veç kësaj, duke përcaktuar nevojatë për trajnime, AGJPP filloi zbatimin e një projekti pilot për vlerësim pas trajnimit për shkrimin e aktgjykimeve dhe aktakuzave, për gjyqtarë dhe prokurorë publikë me stazh trevjeçar pune.⁷²

Akademia po organizon trajnime të vazhdueshme detyrimore dhe vullnetare. Akademia po organizon dhe një modul të specializuar të trajnimit, të menduar për nevojat e gjyqtarëve dhe shërbimit teknik të Gjykatës së Lartë Administrative dhe të Gjykatës Administrative. Në kuadër të këtij programi, në vitin 2017, 7 gjyqtarë të Gjykatës së Lartë Administrative dhe të Gjykatës

⁶⁹ Akademia e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë, *Raporti mbi Punën e Akademisë së Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë për vitin 2015*, fq. 17.

⁷⁰ Veprimi i Përbashkët për Reforma Urgjente në Gjyqësor, *Brifingu i dytë Monitorues mbi implementimin e Prioriteteve Urgjente të Reformave*, shkurt 2018, i qasshëm në <https://goo.gl/MH25iW>

⁷¹ Akademia e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë, *Raporti mbi Punën e Akademisë së Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë për vitin 2017*, fq. 26

⁷² Intervista me një përfaqësues të AGJPP, 11.01.2018

Administrative vizituan një seminar rajonal në Mal të Zi, gjegjësisht, 9 gjyqtarë ishin pjesëmarrës në vizitën studimore në Varshavë - Poloni.⁷³

Akademia vazhdimisht po zbaton edhe trajnime të specializuara për gjyqtarët **porotë**. Në vitin 2017, Bordi Drejtues përcaktoi një “Program të Specializuar për Trajnimin e Gjyqtarëve Porotë”.⁷⁴ Në tetor, AGJPP zbatoi një test për gjyqtarët porotë sipas territoreve të apelit, konform Rregullores së Zbatimit të Provimit për Gjyqtarët Porotë. Përpara zbatimit të trajnimit, u organizuan trajnime të specializuara për gjyqtarët-porotë të sapo zgjedhur nga Këshilli Gjyqësor. Më 17 tetor, AGJPP, në ueb faqen e vet shpalli pyetjet e provimit për gjyqtarët porotë, së bashku me përgjigjet e ofruara. Në pajtim me nenin 5 të Rregullores, në ueb faqen e Akademisë po shpallet vetëm programi i specializuar për gjyqtarët porotë, që përfshinë temat dhe bibliografinë, nga të cilat përcaktohen pyetjet e provimit. Testi u zbatua në periudhën nga 24 deri më 27 tetor. Sipas rezultateve që AGJPP shpalli në ueb faqen e vet, pjesa më e madhe e gjyqtarëve porotë nga të gjitha territoret e apelit kishin fituar 25 pikë – numrin maksimal të pikëve, ndërsa rezultati më i dobët kishte qenë 21 pikë.⁷⁵ 182 kandidatë kaluan testin dhe fituan statusin e gjyqtarit porotë.⁷⁶

Në pajtim me *sondazhin e zbatuar me pjesëmarrësit e trajnimeve të vazhdueshme*⁷⁷ pjesa më e madhe e pjesëmarrësve në trajnimet e vazhdueshme janë të njohur me Programin e Trajnimit të Vazhdueshëm (92%), 65% nga të anketuarit ishin konsultuar gjatë hartimit të Programit të Përgjithshëm për Trajnim të Vazhdueshëm. Numri më i lartë i të anketuarve konsideron se pjesërisht po ndiqet Programi i Trajnimit të Vazhdueshëm, me futjen e trajnimeve plotësuese. Pjesa më e madhe e pjesëmarrësve konsideron se plotësisht dhe në masë të madhe ndiqen ndryshimet ligjore gjatë realizimit të trajnimeve. 91% të të anketuarve janë plotësisht dhe në masë të madhe të kënaqur me cilësinë e ligjeruesve, 89% janë plotësisht dhe në masë të madhe të kënaqur me cilësinë e ligjeratave. Është evidente se dëgjuesit e trajnimit të vazhdueshëm shprehin një shkallë më të lartë të kënaqësisë me cilësinë e ligjeratave. Pjesa më e madhe e përgjigjeve referojnë drejt asaj se trajnimet mbi etikën, integritetin, shkathtësitë e komunikimit ose mbi tema tjera për grumbullimin e shkathtësive dhe praktikave në punën janë

⁷³ Akademia e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë, *Raporti mbi Punën e Akademisë së Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë për vitin 2017*, fq. 17

⁷⁴ Akademia e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë, *Raporti mbi Punën e Akademisë së Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë për vitin 2017*, fq. 5

⁷⁵ Rezultatet janë të qasshme në linkun vijues: <http://www.jpacademy.gov.mk/novosti/-a-ea---->

⁷⁶ Akademia e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë, *Raporti mbi Punën e Akademisë së Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë për vitin 2017*, fq. 21

⁷⁷ Për informacione më të detajuara, shih rezultatet e plota të sondazhit, të qasshme në këtë [link](#).

të nevojshme. 54% të të anketuarve kishin marrë pjesë në trajnime mbi judikaturën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe parimet e GJEDNJ, ndërsa 44% të të anketuarve kanë vizituar trajnime në lidhje me të drejtën e BE. 65% nga të anketuarit nuk kanë njohuri mbi Krerët 23 dhe 24, që janë më relevantet për jurisprudencën dhe për negociatat paraaderuese me Bashkimin Evropian, duke treguar kështu për nevojën urgjente në të punuarit në këtë fushë. Sidomos në këtë lëmë po shohim një potencial për bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile.⁷⁸ Vetëm dy nga gjithë të anketuarit po përdorin sistemin e mësimit elektronik (mësimi me distancë).

Ajo që mund të ceket si pozitive, janë pjesëmarrjet e realizuara në konferencat dhe trajnimet e shumënumërta, me qëllim shqyrtimi i praktikave më të mira dhe mundësitë e implementimit të tyre, e gjitha kjo në drejtim të funksionimit dhe avancimit më të mirë të sistemit të drejtësisë. Akademia organizoi 21 vizita studimore në vitet 2015 dhe 2016 veçmas dhe 20 vizita studimore në vitin 2017.⁷⁹

Ligjeruesit në AGJPP

Tabela: Pasqyra e strukturës së ligjeruesve të AGJPP ⁸⁰

Viti	Struktura e ligjeruesve			Struktura e ligjeruesve të brendshëm		
	Gjithsej ligjeruesit e angazhuar	Ekspertë të brendshëm	Ekspertë të huaj	Gjyqtarë	Prokurorë publikë	Ekspertë tjerë
2015	234	138	96	40	17	81
2016	188	126	62	32	19	75
2017	195	130	65	31	17	82

Akademia vazhdimisht po organizon trajnime të menduara për ligjeruesit, me qëllim që ata të grumbullojnë njohuri dhe shkathtësi përkatëse. Për përmirësimin e cilësisë së trajnimeve, sipas AGJPP nevojitet që Akademia të disponojë me ligjerues të përhershëm, të cilët do të punojnë në kuadër të përbërjes së saj dhe do të përgatisin materiale për ligjeratat dhe për

⁷⁸ Gjatë muajit qershor 2017, u mbajt një punëtori ekspertësh me dëgjuesit e trajnimit fillestar dhe me përfaqësues të Rrjetit 23 në temën e monitorimit të rasteve gjyqësore. Gjatë punëtorisë së ekspertëve, dëgjuesit e trajnimit fillestar të gjeneratës së gjashtë dhanë rekomandime mbi avancimin e trajnimeve në Akademi, me të shtuarit të mësimdhënies praktike, dhe si nevojë u impnua njohja më e mirë e kërërve në procesin e aderimit në BE, sidomos Kreu 23 dhe Kreu 24.

⁷⁹ Shih më tepër në raportet e Akademisë së Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë të viteve 2015, 2016 dhe 2017.

⁸⁰ Akademia e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë, *Raportet mbi Punën e Akademisë së Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë, për vitet 2015, 2016 dhe 2017, të qasshme në* <https://goo.gl/GCvg1T>, <https://goo.gl/xWKRJR>, <https://goo.gl/Ch5Yp6>

studimet e rasteve. Sipas Akademisë, ndryshimet e Ligjit të AGJPP duhet të bëhen paralelisht me ndryshimet e Ligjit të Gjykatave. Në këtë mënyrë do të ishte rregulluar angazhimi i punës së praktikuesve (gjiqtarëve), të cilët do të punojnë për AGJPP për një periudhë të caktuar si ligjerues, ndërkaq, duke mos patur problem për avancim në karrierë. Problemi me angazhimin e ligjeruesve që do të punonin në kuadër të AGJPP u referohet kryesisht praktikuesve, ndërsa jo profesorëve.⁸¹

Nga anketa e zbatuar me ligjeruesit e AGJPP⁸² del se pjesëmarrësit janë aktivë në ligjeratat e tyre. Vetëm dy nga gjithsej 28 të anketuar kanë marrë pjesë në seancat e Këshillit Programik të AGJPP. Pjesa më e madhe e të anketuarve konsiderojnë se plotësisht po ndiqen programet e trajnimit të vazhdueshëm, mësimdhënia teorike dhe praktike, gjegjësisht, pjesërisht për trajnimet plotësuese. 74% nga ligjeruesit janë të kënaqur me trajnimet për ligjeruesit që organizon AGJPP. Një pjesë e ligjeruesve konsiderojnë se duhet patur ndryshime në kushtet ligjore për përzgjedhjen e ligjeruesve. Pjesa më e madhe e komenteve lidhen me përjashtimin e kriterit të njohjes së një gjuhe të huaj, si dhe marrja parasysht e stazhit të punës të ligjeruesve dhe specializimi i tyre për fushën përkatëse. Pjesa më e madhe e të anketuarve vlerësojnë si të shkëlqyer bashkëpunimin me Akademinë.

Ekipimi kadrovik dhe teknik dhe kushtet infrastrukturore

Në lidhje me ekipimin e plotësueshëm kadrovik, edhe pse në vitin 2016 është zgjeruar sistematizimi në 47 vende pune, në AGJPP janë gjithsej 18 punonjës, nga të cilët 16 nëpunës administrativë dhe 2 punonjës konform Ligjit të Marrëdhënieve të Punës. Në 9 vitet e fundit janë zbrazur 15 vende pune, të cilat asnjëherë nuk janë plotësuar me të reja. Veç kësaj, siç është rasti me shumë institucione në RM, punonjësit nuk ngriten në detyrë, gjendje kjo që ka ndikim negativ në motivimin e tyre. AGJPP ka pajisje teknike, por ajo është e vjetëruar dhe kërkon kosto të larta për riparim dhe amortizim. Nevojitet një godinë e re, sepse salla e trajnimit fillestar nuk u përgjigjet nevojave të dëgjuesve të trajnimit fillestar, si dhe prokurimi i literaturës plotësuese dhe hapësirës për leximore.⁸³

⁸¹ Intervista me një përfaqësues të AGJPP, 11.01.2018

⁸² Për informacione më të hollësishme, shiko rezultatet e plota të sondazhit, që janë të qasshme në këtë [link](#).

⁸³ Intervista me një përfaqësues të AGJPP, 11.01.2018

Inkurajimi i dërgimit të gjyqtarëve kombëtarë për stazh pune në GJEDNJ

Deri më tani, AGJPP ka dërguar vetëm një gjyqtar të vetëm për qëndrim 2-mujor në GJEDNJ, nën mbështetje projektit me Ambasadën Franceze.⁸⁴ Në drejtim të zbatimit të prioriteteve urgjente reformatore, Bordi Drejtues solli vendimin për formimin e një Komisioni për Përzgjedhjen e Kandidatëve për qëndrim dhe punë 6-mujore në GJEDNJ dhe “Udhëzuesin për mënyrën e përzgjedhjes së gjyqtarëve dhe prokurorëve publikë që dërgohen për qëndrim dhe punë në GJEDNJ”, në bazë të së cilës Komisioni bëri përzgjedhjen e kandidatëve që janë paraqitur në thirrjen publike.⁸⁵ Bordi Drejtues i Akademisë pranoi propozim-listën e kandidatëve për qëndrim dhe punë 6-mujore në GJEDNJ, nga të cilët gjashtë ishin nga rendi i gjyqtarëve, dhe tre nga rendi i prokurorëve publikë dhe kështu, në muajin nëntor dërgoi listën në GJEDNJ, e cila po realizon përzgjedhjen përfundimtare.⁸⁶ Nuk u dërgua as edhe një nga kandidatët për stazh pune në GJEDNJ. Problemi është se, sipas GJEDNJ, qëndrimi gjashtë-mujor është një periudhë e shkurtër për gjyqtarët të grumbullojnë përvojën të cilën do të mund ta transmetojnë më tej. Sipas Gjykatës, qëndrimi i këtillë duhet vazhduar për një ose dy vjet.⁸⁷

Në drejtim të adresimit të kësaj pjese të prioritetit, Qeveria e RM, në seancën e saj të 57-të, të mbajtur në mars 2018, solli një Konkluzion në lidhje me Informacionin për mundësinë e stazhit të punës së gjyqtarëve/juristëve kombëtarë në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Me këtë Konkluzion, Qeveria konstatoi nevojën për sigurimin e fondeve për dërgimin e gjyqtarëve për stazh pune në GJEDNJ.⁸⁸ Këshilli Gjyqësor në fillim të prillit shpalli Thirrjen për dërgimin e 1 gjyqtari për stazh pune njëvjeçar në GJEDNJ.⁸⁹

KONKLUZIONET DHE REKOMANDIMET E PRIORITETIT 6:

K.1. Me sjelljen e Ligjit të Akademisë së Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë në vitin 2015 dhe ndryshimet dhe plotësimet e tij nuk u bë i mundur një shqyrtim përkatës profesionist, një debat publik, ose çfarëdo përfshirje të ekspertëve ose grupeve të interesuara.

⁸⁴ Intervista me një përfaqësues të AGJPP, 11.01.2018

⁸⁵ Akademia e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë, *Raporti mbi Punën e Akademisë së Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë për vitin 2016*, fq. 5

⁸⁶ Akademia e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë, *Raporti mbi Punën e Akademisë së Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë për vitin 2016*, fq. 3

⁸⁷ Intervista me një përfaqësues të AGJPP, 11.01.2018

⁸⁸ Qeveria e RM, seanca 55 e Qeverisë së RM, mars 2017, Rendi i Ditës i qasshëm në <http://vlada.mk/node/14117>

⁸⁹ Këshilli Gjyqësor i RM, Shpallja për GJEDNJ 2018, 11 prill 2018, e qasshme në <https://goo.gl/DZhNp3>

R.1. Ndryshimet e Ligjit të Akademisë së Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë nevojitet të shoqërohen me një shqyrtim përkatës profesionist, debat publik ose përfshirje tjetër të ekspertëve dhe grupeve të interesuara përgjatë tërë procedurës së sjelljes së tij.

R.2. Nevojiten ndryshime në Ligjin e Akademisë së Gjyqtarëve dhe Prokurorëve Publikë në lidhje me kriteret e hyrjes së kandidatëve në trajnimin fillestar të AGJPP. Para së gjithash, kjo i referohet kushtit të njohjes së një gjuhe të huaj. Provimi për njohjen e një gjuhe të huaj duhet të zbatohet së bashku me provimin pranues në AGJPP.

R.3. Është i domosdoshëm respektimi i Strategjisë, ku është parashikuar analiza e krijimit të një programi të ri për trajnim të posaçëm fillestar për praktikuesit me përvojë shumëvjeçare, si dhe për trajnimet e vazhdueshme, me ridefinimin e programeve dhe metodave për zbatimin e tyre. Kështu do të ishin përfshirë edhe bashkëpunëtorët profesionist me përvojë si dhe praktikuesit tjerë shumëvjeçarë.

K.2. Provimi elektronik lë hapësirë për dilema në lidhje me atë nëse arrin qëllimin për notimin e shkathtësive praktike të dëgjuesve.

R.4. Në pjesën e trajnimit fillestar, nevojitet pezullimi i provimit elektronik për pjesët praktike të provimeve. Veç kësaj, nevojitet dhe futja në përdorim e më shumë ushtrimeve praktike dhe simulimit të seancave gjyqësore.

R.5. AGJPP vazhdimisht punon në avancimin e cilësisë së trajnimeve. Në lidhje me trajnimin e vazhdueshëm, janë për t'i përshëndetur trajnimet e organizuara mbi etikën, parandalimin e konfliktit të interesave dhe masat anti-korrupsion, të organizuara për kryetarët e gjykatave, prokurorët publikë, gjyqtarët, bashkëpunëtorët gjyqësorë dhe të prokurorisë publike. Në drejtim të avancimit të transparencës në judikaturë, AGJPP po zbaton edhe trajnime për komunikimin e gjykatave dhe prokurorive publike me publikun dhe mediat, si dhe për aplikimin e praktikës së GJEDNJ. Veç kësaj, konform analizës së katalogjeve, programeve kornizë, sondazhit të zbatuar si dhe Strategjisë së Reformave në Sektorin e Judikaturës, është e pakontestueshme se nevojitet vënia e theksit mbi trajnimet për zgjidhje alternative të kontesteve, me theks në ndërmjetësimin (para së gjithash në kuptimin e ndërmjetësimit vullnetar, e jo vetëm në kuptimin e ndërmjetësimit kur ai është parashikuar si përpjekje e detyrueshme). Trajnimet të organizohen duke marrë parasysh ndryshimet ligjore të cilat i përkasin kësaj fushe. Pastaj, nevojiten trajnime

në fushat e Kreut 23 dhe Kreut 24, sidomos në lidhje me standardet në këto fusha. Nevojitet organizimi i disa trajnimeve edhe mbi aplikimin e KEDNJ dhe mbi praktikën gjyqësore të GJEDNJ, rolin e gjykatave në zbatimin e aktgjykimeve të GJEDNJ, trajnimeve mbi njësimin e vendimeve gjyqësore, trajnimeve mbi luftimin e krimit të organizuar dhe luftimin e korrupsionit, çrrenjosjen e krimit ekonomik, investigimet financiare, si dhe trajnimeve mbi konfiskimin e pronave dhe përfitimet pronësore të fituara në mënyrë të paligjshme.

R.6. Nga sondazhi i zbatuar me ligjeruesit e AGJPP del se në lidhje me kriteret e përzgjedhjes së ligjeruesve të AGJPP, duhet të merren parasysh dhe stazhi i punës dhe specializimi në fushën përkatëse të ligjeruesve.

K.3. Buxheti që i është caktuar AGJPP nuk mjafton për shlyerjen e shpenzimeve të AGJPP dhe organizimin e llojit të nevojitur të trajnimeve.

R.7. Nevojitet rritja e buxhetit të AGJPP, për shkak të implikimeve financiare që ofrojnë vendimet ligjore të vitit 2015, përmirësimi i cilësisë së trajnimeve, si dhe për shkak të faktit se AGJPP çdo vit buxhetor hy në borxhe.

R.8. Nevojitet ekipimi plotësues kadrovik, teknik dhe infrastrukturor i AGJPP dhe zbatimi konzistent i masave të përcaktuara në këtë drejtim me Strategjinë për Reformë në Sektorin e Jurisprudencës për periudhën 2017 -2022, shoqëruar me Planin e Veprimit.

R.9. Qeveria e RM në mars të vitit 2018 solli konkluzion mbi Informacionin për dërgimin e gjyqtarëve kombëtarë për stazh pune në GJEDNJ. Në prill 2018, Këshilli Gjyqësor publikoi shpalljen për dërgimin e një gjyqtari për stazh pune njëvjeçar në këtë Gjykatë. Sipas GJEDNJ, kohëzgjatja e stazhit të punës në GJEDNJ e gjyqtarëve kombëtarë duhet të shtohet në të paktën një vjet, me qëllim grumbullimi i përvojave praktike, të cilat ata do të mund t'i transmetojnë. Për përmbushjen e kësaj pjese të prioritetit, nevojitet që një dispozitë e këtillë të përcaktohet me Ligjin e Gjykatave, apo më saktësisht neni 71 i Ligjit të Gjykatave.

Prioriteti 7: Të sigurohet shpallja e të gjitha aktgjykimeve në kuadër të afateve të qarta të përcaktuara me ligj (dhe të sigurohen mundësi të plota për kërkim dhe një qasje e lehtësuar)

Metodologjia

Për analizën e statusit të përmbushjes së këtij prioriteti, u aplikuan metoda kuantitative dhe kualitative të hulumtimit. Për grumbullimin e të dhënave u përdor një analizë nga zyra, u zbatua edhe një sondazh me avokatë (shih më poshtë). Është analizuar Ligji i Administrimit të Lëvizjes së Lëndëve brenda Gjykatave, Rregullat e Punës Gjyqësore për Reforma në Sektorin e Jurisprudencës për periudhën 2017 - 2022. U ndoq dhe portali gjyqësor sud.mk në periudhën korrik 2017 – maj 201. U shqyrtuan raportet e Grupit të Lartë të Ekspertëve, të udhëhequr nga Priebe, si dhe raporte dhe analiza tjera relevante. Sondazhi online iu dërgua 1700 avokatëve nga lista e Dhomës së Avokatëve, dhe atij iu përgjigjën 224 të anketuar, nga të cilët 150 të anketuarit kanë selinë e zyrës në kuadër të Gjykatës së Apelit në Shkup, 36 në kuadër të Gjykatës së Apelit në Manastir, 20 në kuadër të Gjykatës së Apelit në Gostivar dhe 18 në kuadër të Gjykatës së Apelit në Shtip.

Statusi në përmbushjen e prioritetit

Në raportin e parë të Grupit të Ekspertëve është theksuar se transparenca është kryesore dhe e domosdoshme për bërjen ballë krizës politike, si dhe për krijimin e kulturës së llogaridhënies juridike dhe përgjegjshmërisë politike.⁹⁰

Të gjitha informacionet mbi gjykatat në RM, si dhe mbi Këshillin Gjyqësor tanimë po publikohen në një portal të vetëm www.sud.mk, i cili është kompetencë e Gjykatës Supreme të RM.

Në Strategjinë e Reformës në Sektorin e Jurisprudencës shënohet se me vënien në funksion të portalit të centralizuar www.sud.mk, filloi të tejkalohet praktika e mospublikimit të aktgjykimeve.⁹¹ Portali është një bazë e kërkueshme e të dhënave, në të cilën janë përfshirë Këshilli Gjyqësor i RM dhe të gjitha 34 gjykatat në territorin e Republikës së Maqedonisë. Edhe pse portali është në funksion e sipër, në monitorimin tonë të vitit të kaluar kemi vërejtur se

⁹⁰ Rekomandimet e Grupit të Lartë të Ekspertëve për çështjet sistematike në lidhje me sundimin e ligjit në lidhje me ndjekjen e komunikimeve të zbuluar në pranverën e vitit 2015, të qasshme në <https://goo.gl/XNxLkb>

⁹¹ Ministria e Drejtësisë, *Strategjia e Reformës në Sektorin e Drejtësisë për periudhën 2017 - 2022*, <https://goo.gl/Fi1nPK>

shumë linqe nuk janë procesuar deri në fund dhe me klikimin e tyre kalohet në fusha të cilat duhet të mbushen plotësueshëm, gjë kjo me të cilën nuk është përmbushur udhëzimi strategjik për funksionalitet të plotë të bazës gjyqësore. Portali gjyqësor përmban një listë të informacioneve me karakter publik për çdo gjykatë në veçanti, si dhe për zëdhënësit kompetentë dhe kontaktet për informacione për publikun. Megjithatë, akoma duhet punuar në përmirësimin e funksionalitetit të portalit.

Në Rregullat e Punës së Gjykatave, parashikohet që, pasi nëpunësi i autorizuar gjyqësor të merr lajmërimin nëpërmjet të sistemit kompjuterik të automatizuar për administrimin e lëndëve gjyqësore, se vendimi gjyqësor është verifikuar dhe u është dërguar palëve (tek gjykatat e shkallës së parë), gjegjësisht drejtuar gjykatave më të ulëta (tek gjykatat më të larta), brenda 2 ditëve anonimizon vendimin (të prerë apo jo të prerë) dhe atë shpall në ueb faqen e gjykatës, konform Ligjit të Administrimit të Lëvizjes së Lëndëve brenda Gjykatave dhe Udhëzimin e adoptuar mbi mënyrën e shpalljes dhe kërimit të vendimeve gjyqësore në ueb faqen e gjykatës. Në rastet kur publiku është përjashtuar konform Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë, ligjit dhe marëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara, vendimet gjyqësore nuk shpallen në ueb faqen e gjykatës.⁹² Të gjitha vendimet gjyqësore, konform Ligjit të Administrimit të Lëvizjes së Lëndëve brenda Gjykatave, duhet të shpallen në portalin gjyqësor, megjithatë shtrohet dilema se cilat nga ato po shpallen, apo sa shpesh po bëhet kjo. Në pjesën e vendimeve të gjykatave, ekziston mundësia e kërimit të vendimeve gjyqësore. Monitorimi i portalit gjyqësor gjatë periudhës 1 korrik 2017 – 23 maj 2018, tregon se është i ulët numri i vendimeve të shpallura gjyqësore, dhe veç kësaj, vendimet gjyqësore nuk po shpallen rregullisht. Gjatë kësaj periudhe, Gjykata Administrative ka numrin më të lartë të vendimeve të shpallura, ndërsa numrin më të ulët të vendimeve të shpallura ka Gjykata Themelore në Negotinë. I ulët është numri i vendimeve të shpallura të Gjykatës Themelore Shkup 1 dhe të Gjykatës Themelore Shkup 2, duke ditur se bëhet fjalë për dy gjykatat më të mëdha në shtet, të cilat kanë numrin më të lartë të lëndëve të përgjithshme të punës. Më së shumti komunikata për opinionin publik shpallin Gjykatat Themelore Shkup I dhe Shkup II, Gjykata e Lartë Administrative, Gjykata e Apelit Shkup dhe Gjykata Supreme, që flet për punën transparente të këtyre gjykatave. Gjatë periudhës së monitorimit shtator 2017, përfundimisht me prillin 2018, komunikata për opinionin publik kanë shpallur edhe gjykatat tjera. Ajo që është karakteristike është se gjykatat e ndryshme japin

⁹² Neni 130, *Rregullat e Punës së Gjykatave*, Gazeta Zyrtare e RM, nr. 66 e datës 09.05.2013

informacione të ndryshme në komunikatat e tyre për opinionin publik. Komunikata për opinionin publik rregullisht po shpall edhe Këshilli Gjyqësor i RM.

Në monitorimin tonë kemi vërejtur se po bëhet anonimizimi i vendimeve. Po shpallen vendime të anonimizuara dhe të paanonimizuara pa informacion nëse janë të efektive apo jo. Veç kësaj, pjesëmarrësit e debatit publik të organizuar në kuadr të Projektit të BE Rrjeti 23 “Avancimi i transparencës në gjyqësorin e RM” që u mbajt më 25 prill 2017, thanë se në ueb faqet e gjykatave ishin shpallur vendime të anonimizuara dhe të paanonimizuara pa informacion nëse janë efektive apo jo. Shpallja e tillë në praktikë krijon konfuzion për publikun profesionist.⁹³

Me qëllim konstatimi i funksionalitetit të portalit, si dhe marrja e informacioneve se sa nga vendimet gjyqësore po shpallen në kuadër të afateve të përcaktuara me ligj, në nëntor 2017 u zbatua një sondazh me avokatë (detajet e tij janë dhënë më lartë).⁹⁴

P.2 Vlerësoni se sa shpesh gjyqtari shpall thënien e vendimeve gjyqësore në kuadër të afateve të përcaktuara me ligj?

Sipas 55% të të anketuarve, gjykatat rrallë ose asnjëherë nuk shpallin vendimet gjyqësore në kuadër të afateve ligjore.

P.3 Nëse dhe në çfarë përmasash po respektohen afatet për hartimin e vendimeve?

Madje 60% të avokatëve ishin përgjigjur se vendimet rrallë ose asnjëherë nuk hartohen në kuadër të afateve ligjore. 15% të të anketuarve konsiderojnë se shpesh ose çdoherë respektohen afatet.

P.4 Në rast të mosshpalljes së thënies së vendimeve në kuadër të afatit ligjor, cili është reagimi më i shpeshtë i palëve që përfaqësoni?

Madje 47% të avokatëve janë përgjigjur se palët e tyre shprehin dyshime në lidhje me arsyen e vonesës. Poashtu, 31.7% të avokatëve janë përgjigjur se palët kërkojnë nga ata që të intervenojnë për sjelljen më të shpejtë të vendimit.

P.5 Si është përvoja juaj me portalin sud.mk?

Sipas 30% të të anketuarve, portali nuk është funksional për kërkime dhe lajmërimë, megjithatë është më i mirë se portalet vetjake të gjykatave. Me ata nuk janë dakord 32.5% të të anketuarve, të cilët janë përgjigjur se portalet vetjake të gjykatave kishin qenë më të mira. Se portali është funksional për kërkime dhe lajmërimë, ishin përgjigjur 21.4% të të anketuarve. Megjithatë, nuk

⁹³Lubica Karamandi Popçevski, *Transparenca dhe çiltërsia: modernizimi i sistemit gjyqësor në RM*, Instituti i Politikave Evropiane, 2017, fq. 9

⁹⁴ Sondazhi është i qasshëm në këtë [link](#).

janë për t'i mospërfillur 15.6 % të të anketuarve, që janë përgjigjur se nuk janë të familjarizuar me portalit, ndërsa të tjerë janë përgjigjur se ai nuk po azhurnohet rregullisht, por edhe se duhet qenë i disponueshëm për kërkim nëpërmjet google.com.

Në lidhje me kërkimin e praktikës gjyqësore në portalit gjyqësor, 54.9% të të anketuarve janë përgjigjur se e kanë të vështirë ta gjejnë atë, 36.6% u përgjigjën se nganjëherë më lehtë depërtojnë në praktikën gjyqësore, ndërkohë që vetëm 8.5% konsiderojnë se praktika gjyqësore është e lehtë për ta kërkuar në portal.

Megjithatë, sipas avokatëve që iu përgjigjen këtij sondazhi, nevojitet analiza e detajuar e pikëpamjeve dhe qëndrimeve për shpalljen e vendimeve gjyqësore të gjyqtarëve, për të përcaktuar sfidat me të cilat po përballen, për t'i adresuar afatet e shpalljes dhe hartimit me shkrim të aktgjykimit. Kjo para së gjithash, lidhet me normën mujore të cilët duhet ta përmbush gjyqtari, lëndët në punë dhe si kjo ndikon në (mos)shpalljen e vendimeve. Analiza e këtillë nevojitet, para së gjithash, për të përcaktuar nëse nevojitet ndryshimi i ligjeve procedurale në pjesën e shpalljes dhe hartimit me shkrim të aktgjykimëve.

Në drejtim të avancimit të transparencës dhe efikasitetit të gjykatave, Qeveria e RM, në seancën e 55-të, të mbajtur në mars 2018, shqyrtoi Informacionin mbi propozim-Strategjinë për Teknologji Informatike dhe të Komunikimit në Jurisprudencë.⁹⁵

Në drejtimin e avancimit të transparencës e judikaturës është edhe përcaktimi në Strategjinë për Reforma në Sektorin e Judikaturës për organizimin e trajnimeve për personat për marrëdhënie me publikun, në kuptimin e fuqizimit të kapaciteteve për marrëdhënie me publikun.⁹⁶ AGJPP organizoi trajnime dhe këshillime për përforcimin e komunikimit të organeve të drejtësisë me publikun dhe mediat dhe për rëndësinë e mediave sociale. Shoqata e Gjyqtarëve të RM organizoi një punëtori me temë: “Transparenca gjyqësore dhe vlerësimi i gjyqtarëve në dritën e reformës

⁹⁵ Qeveria e RM, seanca 55 e Qeverisë së RM, Rendi i Ditës i qasshëm në <http://vlada.mk/node/14117>. Me zbatimin e zgjidhjeve dhe sistemeve TIK, konform standardeve evropiane dhe ndërkombëtare, qëllimi do të jetë rritja e qasshmërisë, mëkohshmërisë dhe shfrytëzimit të lehtë të shërbimeve të drejtësisë për të gjithë shfrytëzuesit, përmirësimi i cilësisë së të dhënave, mbrojtjes dhe sigurisë, si dhe bashkëpunimi me sistemet tjera të drejtësisë, institucionet e Bashkimit Evropian, vendet anëtare të tij dhe organizatat ndërkombëtare.

⁹⁶ Ministria e Drejtësisë, *Strategjia e Reformës në Sektorin e Drejtësisë për periudhën 2017 – 2022, me Planin e Veprimit*; Plani i Veprimit është i qasshëm në <https://goo.gl/g9J6Jr>

në gjyqësor”. Në punëtori u shqyrtua mundësia dhe përfitimet nga formimi i një Këshilli Gjyqësor-Mediatik, për të avancuar bashkëpunimin e gjykatave me publikun dhe mediat.⁹⁷

KONKLuzionet dhe Rekomandimet e Prioritetit 7:

K.1. Portali gjyqësor akoma nuk është mjaftë funksional. Në portal po shpallen vendime të anonimizuara dhe të paanonimizuara, pa informacionin nëse janë efektive apo jo.

R.1. Nevojitet përmirësimi i funksionalitetit të portalit gjyqësor sud.mk, si dhe shpallja e aktgjykimeve në kuadër të afatit të përcaktuar me ligj, respektimi i udhëzimit për anonimizimin e aktgjykimeve, si dhe theksimi nëse ato janë efektive apo jo.

K.2. Përgjigjet e avokatëve referojnë në atë se vendimet gjyqësore nuk po shpallen dhe nuk po hartohen në kuadër të afateve të përcaktuara me ligj.

R.2. Nevojitet që të gjitha vendimet gjyqësore të shpallen dhe hartohen në kuadër të afateve të përcaktuara me ligj.

R.3. Nevojitet ndjekja konzistente e implementimit të Strategjisë së Teknologjisë Informatike dhe të Komunikimit në Judikaturë edhe nga organizatat e shoqërisë civile.

R.4. Duhet të vazhdohet me praktikën dhe të organizohen më tepër trajnime për bashkëpunimin e organeve të drejtësisë me mediat dhe për komunikim me publikun. Shpallja e informacioneve më të rëndësishme që janë me vlerë për publikun, si dhe për avancimin e transparencës në gjyqësor.

PJESA 3:

PRIORITETET URGJENTE REFORMATORE, FOKUSI I TË CILAVE ËSHTË ZGJIDHJA E LËNDËVE “TË VJETRA” DHE ZBATIMI I VENDIMEVE TË GJEDNJ NË RM

Autorët: Zharko Aleksov dhe Angella Shumkoska

Prioriteti 8: Të përpilohet dosje për kohëzgjatjen e proceseve gjyqësore me fokus të veçantë në "lëndët e vjetra".

Hyrje

⁹⁷ Shoqata e Gjyqtarëve të RM, punëtorja me temë "Transparenca gjyqësore dhe vlerësimi i gjyqtarëve në dritën e reformës në gjyqësor", 16.04.2018, e qasshme në <https://goo.gl/Vrxtpc>

Lënda e kësaj pjese të analizës janë "lëndët e vjetra" në pajtim me rekomandimin e dhënë në Prioritetet e reformës urgjente nga raporti Priebe nga 2015. Përkatësisht, edhe pse sipas rekomandimit është e nevojshme të përgatitet dosje për kohëzgjatjen e plotë të proceseve gjyqësore me fokus të veçantë në "lëndët e vjetra" nga Këshilli Gjyqësor i RM, sipas raportit të dytë Priebe nga viti 2017, rekomandimi i tillë nuk është plotësuar.

Si lëndë të vjetra, në bazë të raportit të Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë në vitin 2016, kemi marrë parasysh lëndët me kohëzgjatje prej 3 deri në 7 vjet, nga 7 në 10 vjet dhe lëndët mbi 10 vjet. Analiza i referohet lëndëve me statusin e tyre në vitin 2016, 2017, përfshirë 2018 nga muaji mars dhe në të njëjtën me fokus të veçantë janë përfshirë praktika e gjykatave që kanë numrin më të madh të lëndëve të pazgjidhura: Gjykata Themelore Shkup 1 Shkup, Gjykata Themelore Shkup 2 Shkup dhe Gjykata Themelore Manastir, Gjykata Themelore e Gostivarit dhe Gjykata Themelore e Kumanovës, në bazë të të dhënave të marra në Raportin e Parë Monitorues "Reforma Gjyqësore - Nga Priebe 1 deri Priebe 2 dhe më pas"⁹⁸.

Gjatë përgatitjes së analizës ne përdorëm metodat sasiore për mbledhjen e të dhënave me kontrollim në të dhënat numerike që kishim marrë duke paraqitur kërkesa për qasje të lirë në informacione me karakter publik. Përdorëm metodën statistikore me përpilimin e të dhënave të mbledhura dhe në bazë të asaj kemi miratuar disa konkluzë.

U kryen intervista me avokatët dhe iu dërgua avokatëve një pyetësor anketues, pas çkame metodën e induksionit dhe deduksionit fituam një pasqyrë për problemin dhe përcaktuam konkluzë të përgjithshme⁹⁹.

Qëllimi kryesor i kësaj pjese të analizës është hulumtimi i bazuar në kontrollin e trendit të veprimeve të gjykatave dhe opinionit të palëve të interesuara për veprime të tilla në mënyrë që të rezultojnë rekomandime në lidhje me zbulimin e problemit, me çka do të ofrohen zgjidhje të mundshme për praktikën e mira për zgjidhjen e problemit me kohëzgjatjen e tepërt të procedurave dhe në këtë mënyrë forcimin e sigurisë ligjore të qytetarëve në RM.

Lëndët me kohëzgjatje prej 3 deri në 7 vjet, nga 7 deri në 10 vjet dhe lëndët mbi 10 vjet

Raportet e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë për vitet 2016 dhe 2017 tregojnë se janë ndërmarrë masa konkrete për reduktimin e numrit të lëndëve të vjetra të pazgjidhura në

⁹⁸Raporti i parë i monitorimit "Reforma në Gjyqësor - Nga Priebe 1 në Priebe 2 dhe më pas" është i qasshëm në lidhjen e mëposhtme: <http://ihr.org.mk/p.php?pid=274>

⁹⁹Pyetësori anketues u dërgua në më shumë se 180 avokatë. U morën 62 përgjigje nga pyetësorët në bazë të të cilave janë marrë dhe analizuar të dhënat.

gjqësor, më të vjetra se 3, 7 dhe 10 vjet dhe se gjyqtarët që merren me këto lëndë janë të detyruar të përgatisin plan dhe projektim për ta zgjidhur secilën lëndë.

Tabela 1 Gjendja e lëndëve të vjetra në gjyqësor, viti 2016 ¹⁰⁰

	Janar Viti 2016	Dhjetor viti 2016	Zvogëlimi i pjesëve të mbetura gjate vitit 2016
Më të vjetra se 3 vjet	11586	5065	6521
Më të vjetra se 7 vjet	388	219	169
Më të vjetra se 10 vjet	74	56	18

Tabela 1 Gjendja e lëndëve të vjetra në gjyqësor, viti 2017 ¹⁰¹

	Janar viti 2017	Dhjetor viti 2017	Zvogëlimi i pjesëve të mbetura gjatë vitit 2017
Më të vjetra se 3 vjet	10019	3865	6154
Më të vjetra se 7 vjet	342	229	113
Më të vjetra se 10 vjet	165	91	74


Mund të vërehet se në 2017, ndryshe nga viti 2016, ka rënie të lehtë në numrin e rasteve më të vjetra se 3 vjet dhe më të vjetra se 7 vjet, por fakti shqetësues është se në vitin 2017 edhe pse ka rënie në numrin e lëndëve më të vjetra se 10 vjet, numri i lëndëve në fund të vitit 2017 është 91.

Grafiku më poshtë tregon statusin e lëndëve në gjykatat që janë zbuluar me numrin më të madh të lëndëve të vjetra prej 3 deri në 7 vjet, në dhjetor 2017 krahasuar me statusin në mars 2018. Mund të vërehet se trendi i rritjes së numrit të lëndëve në periudhën nga 3 deri në 7 vjet është 37 lëndë të tjera në vetëm tre muaj.

Grafiku Nr.1 Lëndë të pazgjidhura nga 3 deri në 7 vjet, dhjetor 2017 dhe mars 2018.


¹⁰⁰Raporti vjetor mbi punën e Këshillit Gjyqësor të RM për vitin 2016, fq. 19

¹⁰¹Raporti vjetor mbi punën e Këshillit Gjyqësor të RM për vitin 2017, fq. 24



Për lëndët që janë ende në pritje dhe janë në kohëzgjatje prej 7 deri në 10 vjet, si dhe për lëndët mbi 10 vjet, mund të vërehet gjithashtu një prirje rritëse që ndiqet në lëndët e mëvonshme në të njëjtat gjykata në shtator 2017 , dhjetor 2017 dhe mars 2018.

Grafiku nr.2 Lëndë të pazgjidhura nga 3 deri në 7 vjet, shator 2017, dhjetor 2017 dhe mars 2018.




(сhtator 2017 dhjetor 2017 mars 2017

Gjykata themelore Shkup 1 Shkup Gjykata themelore Shkup 2 Shkup

Gjykata themelore Kumanovë Gjykata themelore Gostivar

Gjykata themelore Manastir)

Grafiku nr.3 Lëndë të pazgjidhura nga 3 deri në 7 vjet, shator 2017, dhjetor 2017 dhe mars 2018.



Me avokatët, së pari zhvilluan intervista, në të cilat u vendos theksi në atë që e konsiderojnë se është problemi dhe pastaj ata kanë mundësinë t'i përgjigjen pyetjeve të pyetësit lidhur me përvojën e avokatëve në lidhje me kohëzgjatjen e procedurave gjyqësore dhe administrative dhe procedurave të kontesteve administrative, si dhe faktorë që ndikojnë në zgjatjen e procedurave.

Avokatët u përgjigjën se kishte disa faktorë për vonimin e procedurave, por si më të rëndësishmet, ata i dalluan si vijon:

- dorëzimi i parregullt;
- periudhat e mëdha kohore midis seancave gjyqësore;
- vëllimi i madh i lëndëve në gjykata të caktuara;
- tendenca e gjykatave të shkallës së dytë për të shfuqizuar aktvendimet gjyqësore dhe për t'i kthyer lëndët për dëmshpërblim para gjykatës së shkallës së dytë;
- gjendja jo e plotë faktike e gjykatës së shkallës së parë dhe tejkalimi i afateve për nxjerrjen e aktvendimeve gjyqësore nga gjykatat e shkallës së dytë.

Një pjesë theksuan problemin me procedurat administrative dhe procedurat për kontestim administrativ, veçanërisht lëndët e denacionalizimit dhe shpronësimit. Si arsye të këtyre procedurave, vendimi jo meritor nga Gjykata Administrative në disa lëndë për të njëjtën lëndë dhe kthimin e saj në rigjykim.¹⁰²

¹⁰²Një kërkesë për qasje të lirë në informacionin publik Nr. I 0306-364 më datë 02.04.2018 është paraqitur në Gjykatën Administrative të Republikës së Maqedonisë për numrin e përgjithshëm të lëndëve në të cilat Gjykata

Në pyetësin mbi arsyet që kanë shkaktuar vonesa në procedurat gjyqësore dhe ku kanë pasur mundësi të përgjigjeve të shumëfishta, 71% e avokatëve konsiderojnë se vendimmarrja jo-meritore dhe kthimi i lëndëve për rigjykim nga gjykatat më të larta, kanë ndikimin më të madh në vonesën e procedurave dhe me këtë hynë në kategorinë e lëndëve të vjetra. 43.5% e avokatëve konsiderojnë se ndikimi dhe presioni ndaj gjyqtarëve ka një rol dhe 38.7% mendojnë se arsyeja është keqpërdorimi i veprimeve procedurale nga pjesëmarrësit në procedurë që çojnë në vonesa të procedurave. Në lidhje me ndryshimin e gjyqtarëve gjatë procedurës dhe llojit dhe fushëveprimit të rastit, 33.9% e avokatëve konsiderojnë se këta faktorë çojnë në zgjatje të procedurave.

Si përgjigje shtesë që deklaruan vetë avokatët janë nepotizmi dhe mungesa e pasojave ndaj mosfunksionimit.

Grafiku nr.4 Përvoja e avokatëve në lidhje me atë se cila fazë e proceseve gjyqësore çon në prolongim të procedurave dhe është me kohëzgjatje më të madhe

Nga të dhënat e marra mund të konkludohet se 45.1% e avokatëve konsiderojnë se procedurat e shkallës së dytë janë më të gjata (Gjykatat e Apelit) dhe kjo çon në prolongim të procedurave,



ndërsa 38.7% e avokatëve konsiderojnë se procedurat e shkallës së parë (Gjykatat Themelore) janë procedura më të gjata kohore 16.1% mendojnë se procedura e shkallës së tretë (Gjykata Supreme e RM) është procedura më e gjatë kohore.

(Procedurë e shkallës së parë (Gjykata Themelore)
 Procedurë e shkallës së dytë (Gjykata të Apelit)
 Procedura të shkallës së tretë (Gjykata supreme))

Administrative e RM ka vendosur në mënyrë meritorë në vitin 2015, 2016, 2017 dhe 2018, për të cilën deri më 28.05.2018 nuk kemi marrë përgjigje.

Gjykim brenda një afati të arsyeshëm

Gjykimi brenda një kohe të arsyeshme është parimi themelor i standardit juridik procedues dhe parimi i sundimit të ligjit, me qëllim të mbrojtjes së të drejtave me kohë dhe në mënyrë efektive. Neni 6 - E drejta e procedurës së drejtë gjyqësore nga KEDNJ thotë: Secili ka të drejtë në mënyrë të drejtë dhe publike në afat të arsyeshëm, në gjykatën e pavarur dhe të paanshme të themeluar me ligj të shqyrtohen dhe përcaktohen të drejtat dhe obligimet e tij qytetare ose baza për çfarëdo lloj akuza penale kundër tij. Për disa procedura është përcaktuar periudhë kohore si për shembull në procedurën për kontestet nga marrëdhëniet e punës, procedura para gjykatës së shkallës së parë duhet të kryhet në afat prej gjashtë muajve nga dita e paraqitjes së padisë si dhe në procedurën në kontestet për shkak të pengesave në qeverisje¹⁰³.

Pala e cila vlerëson se gjykata kompetente ia ka shkelur të drejtën për gjykim në afat të arsyeshëm mund të parashtrorë kërkesë për mbrojtjen e së drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm në Gjykatën e RM.

Tabela:3 Numri i kërkesave të parashtruara për të drejtën e gjykimit në afat të arsyeshëm dhe numri i lëndëve në të cilën është vërtetuar shkelja e së drejtës së gjykimit brenda një afati të arsyeshëm nga Gjykata Supreme e RM

Gjykata	qershor 2015 - shtator 2017		shtator - dhjetor viti 2017		janar - mars viti 2018	
	Kërkesat e parashtruara	Shkelja e përcaktuar	Kërkesat e parashtruara	Shkelja e përcaktuar	Kërkesat e parashtruara	Shkelja e përcaktuar
Gjykata Themelore Shkup 1 Shkup	105	38	15	8	8	3
Gjykata Themelore Shkup 2 Shkup	323	100	38	11	29	4
Gjykata Themelore Kumanovë	160	23	0	0	7	2
Gjykata Themelore Gostivar	48	9	9	2	6	0
Gjykata Themelore Manastir	31	3	2	0	2	0

Sipas të dhënave të fituara, për procedurat gjyqësore mund të konkludohet se në Gjykatën Themelore Shkup 2 Shkup dhe Shkup 1 Shkup ka numër më të madh të kërkesave të paraqitura

¹⁰³Nenet 405 dhe 411 të Ligjit për procedurë kontestimore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.79/2005, 110/2008, 83/2009, 116/2010 dhe 124/2015).

dhe është përcaktuar shkelje për gjykim brenda një kohe të arsyeshme nga Gjykata Supreme e RM, por e njëjta është në pritje duke marrë parasysh vëllimin e punës së këtyre gjykatave.

Në tabelat dhe grafiqet e lartpërmendura, megjithëse nuk është përfshirë Gjykata Administrative e RM për të njëjtën nga tetori deri në dhjetor 2017, Gjykata ka 38 lëndë të pazgjidhura për një periudhë 3-7 vjet dhe nuk ka lëndë të papërfunduara nga 7 deri në 10 vjet dhe mbi 10 vjet.¹⁰⁴ Megjithatë, për procedurat para Gjykatës Administrative të RM, ka numër më të madh të kërkesave të paraqitura dhe shkelje të përcaktuara për një gjykim brenda një afati të arsyeshëm nga Gjykata Supreme e RM.

Kjo është për shkak të faktit se lëndët në Gjykatën Administrative të RM janë regjistruar pas padisë së paraqitur kundër një akti administrativ të miratuar në shkallën e dytë dhe aktin administrativ të shkallës së parë kundër të cilit nuk ka mjet juridik, me të cilin formohet vetë padia, pra regjistrohet një lëndë e re me numër të veçantë, me çka nuk ekziston kontroll për tërë periudhën në të cilën është marrë vendim për një lëndë të caktuar, gjegjësisht gjatësinë e procedurës së mëparshme.

Tabela 4: Numri i kërkesave të parashtruara për të drejtën e gjyimit në afat të arsyeshëm dhe numri i lëndëve në të cilën është përcaktuar shkelja e të drejtës së gjyimit brenda një afati të arsyeshëm nga Gjykata Supreme e RM, për lëndë në Gjykatën Administrative në RM.

Qershor 2015 - shtator 2017		Shtator - dhjetor viti 2017		Janar - mars viti 2018	
Kërkesat e parashtruara	Shkelja e përcaktuar	Kërkesat e parashtruara	Shkelja e përcaktuar	Kërkesat e parashtruara	Shkelja e përcaktuar
345	109	54	21	48	19


Në lëndën ku Gjykata Supreme përcakton shkelje të së drejtës për gjykim brenda afati të arsyeshëm për të pandehurin është lënda e personit L.F.Më shumë se 17 vjet më parë, Gjykata Themelore Shkup 2 paraqiti Propozimin për dhënien e vendimit në bazë të një dokumenti autentik. E pandehura paraqiti ankesë në kohë në të cilën theksoi se nuk kishte borxh të papaguar ndaj paditësit dhe kërkesa nuk ka asnjë bazë. 14 vjet pas paraqitjes së ankesës, gjykata caktoi seancën e parë gjyqësore për seancën kryesore dhe pastajpasnjë viti miratoi aktvendim gjyqësor. Kështu, kohëzgjatja e përgjithshme e procedurës së shkallës së parë ishte 15 vjet dhe 6 muaj, që është një gjatësi objektivisht e paarsyeshme për rastet e këtij lloji, si dhe duke marrë parasysh

¹⁰⁴Një kërkesë për qasje të lirë në informacionin të karakterit publik nr. I 0306-365 më datë 02.04.2018 është paraqitur në Gjykatën Administrative të RM për numrin e përgjithshëm të lëndëve të pazgjidhura me të cilat vepron Gjykata Administrative e RM nga 3 deri në 7 vite dhe mbi 10 vite me status 31.03.2018, për të cilën deri më 28.05.2018 nuk kemi marrë përgjigje.

kompleksitetin dhe vëllimin e lëndës. Duhet të theksohet se për të gjithë këtë periudhë, për aplikantin, ose për borxhin e përmendur në kërkesën paditëse të paditësit, ishte në rrjedhë kamatë ndëshkuese. Gjykata Supreme përcaktoi shkelje të nenit 6 paragrafit 1 të KEDNJ dhe shkelje të Nenit 35 dhe 36 të Ligjit të Gjykatave dhe shqiptoi 10.000 denarë në emër të kompensimit të drejtë për shkelje, pas së cilës paditësi ka parashtruar ankesë për të njëjtën që të miratohet pjesërisht dhe ndryshoi Vendimin në pjesën e shqiptimit të kompensimit monetar parashtruesit të kërkesës për shkak të një shkelje të vendosur të aktgjykimit brenda afati të arsyeshëm, kështu që, përveç shumës së shqiptuar prej 10,000 denarë, një shumë prej 20,000 denarë ose një shumë totale prej 30,000 denarë duhet të paguhet brenda tre muajve nga data e hyrjes në fuqi të aktvendimit të Këshillit Buxhetor Gjyqësor¹⁰⁵

Lidhur me përfundimin se Gjykata Supreme e RM vendos me kohë brenda afatit ligjor, duke vepruar sipas Kërkesës për gjykim brenda një kohe të arsyeshme, 48% e avokatëve pajtohen pjesërisht, 31% e avokatëve nuk pajtohen dhe 21% e avokatëve pajtohen me këtë konstatim.

Grafiku nr.5 Vallë Gjykata Supreme e RM pas paraqitjes së kërkesës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, vendos me kohë brenda afatit ligjor të paraparë.



KONKLuzionet dhe Rekomandimet e Prioritetit 8:

¹⁰⁵Raport vjetor për efektivitetin e mbrojtjes ligjore të të drejtave të njeriut në Republikën e Maqedonisë, Shoqata Maqedonase e Avokatëve të Rinj - SHMAR Shkup fq. 39.

K.1 Është ende i pranishëm një numër i madh i lëndëve të vjetra të pazgjidhura në sistemin gjyqësor në RM. Sipas analizës, mund të shihet se lëndët e tilla janë në masë të madhe në Gjykatat e Apelit dhe gjykatat që kanë ngarkesë të madhe pune. Shifrat të tilla janë të pritura të ndjekin numrin e madh të lëndëve, por trajtimi, d.m.th, kohëzgjatja e madhe e procedurave në këto gjykata është në dëm të madh për popullin dhe kjo rrënon sigurinë juridike në RM. Ky problem theksohet në mënyrë të veçantë në procedurat në Gjykatat e Apeleve.

R.1. Edhe pse raportet e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë për vitet 2016 dhe 2017 theksojnë se janë marrë masa konkrete për zvogëlimin e numrit të lëndëve të pazgjidhura në gjyqësor, rezultatet janë të vogla dhe është e nevojshme të krijohet një sistem funksional, para së gjithash për monitorimin e këtyre lëndëve dhe pastaj për analiza të hollësishme në secilën lëndë për shkaqet e kohëzgjatjës tepërt të procedurës dhe marrjen e masave efektive për sanksionimin dhe heqjen e veprimeve të tilla. Përveç kësaj, është e rëndësishme rritja e ndërgjegjësimit të pjesëmarrësve në procedurë për kohëzgjatjen e procedurave dhe pasojat që janë të dëmshme për të gjitha subjektet.

K.2. Shqyrtohet problemi i zvarritjes së procedurave administrative dhe procedurave për kontestet administrative. Si arsyetim më i shpeshtë i zvarritjes së këtyre procedurave është vendimi jomeritor i Gjykatës Administrative në disa lëndë për të njëjtën lëndë dhe kthimin e saj në rigjykim.

R.2 Me vendim meritor nga ana e gjykatës do të parandalohet kohëzgjatja e tepërt e procedurave, veçanërisht në procedurat e denacionalizimit dhe shpronësimit, të cilat theksohet se janë procedurat më të gjata.

K.3. Mund të konkludohet se për procedurat në Gjykatën Themelore Shkup 1 Shkup dhe Shkup 2 Shkup ekziston një numër i madh i kërkesave të parashtruara dhe ka shkelje të së drejtës për gjykim në afat të arsyeshëm nga Gjykata Supreme e RM, por gjithashtu se numri i kërkesave të parashtruara në Gjykatën Supreme të RM është i vogël në krahasim me numrin e "lëndëve të vjetra".

R.3 Nevojitet përdorimi më aktiv i kompetencave të Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë për të vendosur mbi kërkesën e palëve dhe pjesëmarrësve të tjerë në procedurën për shkelje të së drejtës për gjykim brenda kohës së arsyeshme e cila është në përputhje me rregullat dhe parimet e përcaktuara nga Konventa Europiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Rëndësia e kërkesave është e madhe në aspektin e faktit se gjykata shqyrton miratimin e të gjitha palëve në procedurë, veprimet e gjykatës mbi lëndën dhe kompleksitetin e vetë lëndës..

Prioriteti 9: Të sigurohet ekzekutimi i shpejtë i vendimeve të GJEDNJ kundër RM

Hyrje

Sipas raportit të Priebe nga qershori i vitit 2015, një nga rekomandimet është "*ekzekutimi konkret dhe i shpejtë i vendimeve të GJEDNJ në përputhje me detyrimet që ka ndër marrë shteti*"¹⁰⁶, gjatë çka është vërejtur se vetëm një e dhjeta e rreth 100 aktgjykimeve kundër Republikës së Maqedonisë janë kryer në mënyrë përkatëse. Pikërisht ekzekutimi i aktgjykimeve është lidhja kryesore në sigurimin e standardeve themelore për gjykim të drejtë, i cili në anën tjetër është në marrëdhënie të ngushtë dhe të pathyeshme me efektivitetin në mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Për këtë arsye, analiza në këtë seksion nga njëra anë synon të japë pasqyrë më të qartë të rolit dhe punës së autoriteteve vendase kompetente për zbatimin e aktvendimeve dhe vendimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) dhe, nga ana tjetër, për t'i identifikuar dobësitë në sistemin e vendosur për zbatim të vendimeve të GJEDNJ përmes analizës së lëndëve konkrete dhe të japë rekomandime për tejkalimin e suksesshëm të problemeve të përcaktuara. Metodologjia e përdorur në përgatitjen e kësaj pjese të raportit përfshin: 1. Analiza e ligjeve, dokumenteve dhe planeve të veprimit në lidhje me punën e trupave përgjegjës për zbatimin e vendimeve të GJEDNJ; 2. Informacione mbi ekzekutimin e vendimeve të GJEDNJ në dispozicion përmes të dhënave zyrtare të GJEDNJ, Këshillit të Evropës dhe Komitetit të Ministrave, ministrive përkatëse në Republikën e Maqedonisë dhe organeve shtetërore; 3. Analiza të aktgjykimeve kundër Republikës së Maqedonisë të miratuara në periudhën prej korrikut 2015 deri në mars 2018 me theks të veçantë në disa lëndë të

¹⁰⁶Fq 12, ¹⁰⁶https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/news_corner/news/news-files/20150619_recommendations_of_the_senior_experts_group.pdf.

përzgjedhura¹⁰⁷; 4. Zbatimi i sondazhit përmes pyetësori të anketës për avokatë në lidhje me efektivitetin e ekzekutimit të aktvendimeve në RM.

Aktvendimetë plotfuqishme të GJEDNJ kundër Republikës së Maqedonisë

Republika e Maqedonisë ka ndërmarrë një numër më të madh të detyrimeve me ratifikimin e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ)¹⁰⁸. Një nga këto detyrime është detyrimi i ekzekutimit të aktvendimeve të GJEDNJ¹⁰⁹. Puna e GJEDNJ përfundon kur aktgjykimi është i plotfuqishëm, megjithatë që nga ai çast fillon roli i shtetit që të zbatohet çdo vendim i plotfuqishëm. Procesi i ekzekutimit të vendimeve të GJEDNJ rregullohet me Ligjin për përfaqësimin e Republikës së Maqedonisë në GJEDNJ¹¹⁰ dhe me Ligjin për ekzekutimin e vendimeve të GJEDNJ¹¹¹. Më poshtë është prezantuar lista e lëndëve në të cilat GJEDNJ konstatoi shkelje të të drejtave të garantuara me konventën për periudhën korrik 2015 - mars 2018.

Është konstatuar shkelja e të drejtave të garantuara me GJEDNJ¹¹²	
Periudha Korrik 2015 - Shtator 2017¹¹³	
Eftimov kundër RM (59974/08)	Andonovski kundër RM (24312/10)
Andonovski kundër RM (16225/08)	Mitkova kundër RM (48386/09)
Hajrullahu kundër RM (37537/07)	Asllani kundër RM (24058/13)
Poposki dhe Duma kundër RM (69916/10)	GerovskaPopçevska kundër RM (48783/07)
Jaksovski - Trifunovski kundër RM (56381/09)	Ivanovski kundër RM (29908/11)
Vasilevski kundër RM (22653/08)	Mitrov kundër RM (45959/09)
Petreska kundër RM (16912/08)	KitanoskaStanojkoviç dhe të tjerë kundër RM

¹⁰⁷Korniza kohore në rastin konkret i përcjell tre raportet periodike të monitorimit të prodhuara në kuadër të projektit.

¹⁰⁸Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut u ratifikua nga Republika e Maqedonisë më 10 prill 1997.

¹⁰⁹Neni 46 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (http://www.echr.coe.int/Documents/Convention_MKD.pdf).

¹¹⁰Ligji për përfaqësimin e Republikës së Maqedonisë në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 67/2009, 43/2014 dhe 64/2018).

¹¹¹Ligji për Ekzekutimin e Vendimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 67/2009 dhe 43/2014).

¹¹²Në tabelë nuk janë përfshirë aktgjykimet dhe vendimet që nuk kanë përcaktuar shkeljen e të drejtave nga KEDNJ.

¹¹³Të dhënat janë marrë nga përgjigjja e kërkesës për qasje të lirë në informacionin të karakterit publik nr. 20-198 / 3 nga Byroja për përfaqësim të RM para Byrosë së KEDNJ për përfaqësimin e RM në KEDNJ.

	(2319/14)
Selmani dhe të tjerë kundër RM (67259/14)	Krajanov kundër RM (2229/15)
Rasti Qendra për Zhvillimin e Psikologjisë Analitike kundër RM (29545/10)	Petroviq kundër RM (30721/15)
Periudha Shtator 2017 - Dhjetor 2017¹¹⁴	
Kryepeshkopata ortodokse e Ohrit kundër RM (3532/07)	Kërstanovski dhe të tjerë kundër RM (38024/08 dhe 54726/08).
Periudha janar 2018 - mars 2018¹¹⁵	
Petrovska kundër RM (73759/14)	Ramkovski kundër RM (33566/11)
Asani kundër RM (27962/10)	Selami dhe të tjerë kundër RM (78241/13)

Sistemi për zbatimin e vendimeve të GJEDNJ

Mbikëqyrja nga Komiteti i Ministrave

Zbatimi i aktgjykimeve kryhet nën mbikëqyrjen e Komitetit të Ministrave¹¹⁶, i cili realizohet nëpërmjet planeve të veprimit dhe raporteve në të cilat janë parashikuar masa individuale dhe të përgjithshme të cilat i ndërmerr shteti ose planifikon t'i ndërmarrë. Rregullat e Komitetit të ministrave parashikojnë sistem të mbikëqyrjes së lëndëve nën mbikëqyrje të përforcuar në të cilin bëjnë pjesë edhe lëndët të cilat kërkojnë masa urgjente individuale, pilot - studime, aktgjykimet të cilat sugjerojnë në ekzistimin e problemeve të mëdha strukturore dhe komplekse dhe lëndë ndërshtetërore. Në mënyrë plotësuese, është parashikuar edhe mbikëqyrje e standardizuar e lëndëve në të cilat Komiteti i ministrave nuk ka rol aktiv, por plotësohet me vendime formale me të cilat regjistrohet progresi në ekzekutimin e lëndëve. Ekzekutimi konsiderohet si i përfunduar dhe i kompletuar në momentin kur Komiteti i ministrave do të miratojë rezolucion final me të cilin përcaktohet se shteti i ka plotësuar të gjitha obligimet.

Lëndë nën mbikëqyrje të përforcuar nga Komiteti i Ministrave ¹¹⁷

¹¹⁴[https://search.coe.int/cm/Pages/result_details.aspx?ObjectId=09000016806fe3b2https://hudoc.echr.coe.int/eng#{"languageisocode":\["ENG"\],"respondent":\["MKD"\],"documentcollectionid":\["JUDGMENTS"\],"kpdata":\["2017-10-01T00:00:00.OZ","2017-12-31T00:00:00.OZ"\]}](https://search.coe.int/cm/Pages/result_details.aspx?ObjectId=09000016806fe3b2https://hudoc.echr.coe.int/eng#{).

¹¹⁵[https://hudoc.echr.coe.int/eng#{"%22languageisocode%22":\["%22ENG%22"\],"%22respondent%22":\["%22MKD%22"\],"%22documentcollectionid%22":\["%22JUDGMENTS%22"\],"%22kpdata%22":\["%222018-01-01T00:00:00.OZ%22,%222018-03-31T00:00:00.OZ%22"\]}](https://hudoc.echr.coe.int/eng#{).

¹¹⁶HYPERLINK

"http://www.mk.undp.org/content/the_former_yugoslav_republic_of_macedonia/en/home/operations/projects/environment_and_energy/restoration-of-the-prespa-lake-ecosystem.html"

¹¹⁷[http://hudoc.exec.coe.int/eng#{"%22EXECDocumentTypeCollection%22":\["%22CEC%22"\],"%22EXECLanguage%22":\["%22ENG%22"\],"%22EXECState%22":\["%22MKD%22"\],"%22EXECSupervision%22":\["%22ENHA%22"\]}](http://hudoc.exec.coe.int/eng#{).

Gjatë periudhës nga korriku i vitit 2015 deri në shtator 2017, lëndë nën mbikëqyrje të përforcuar nga Komiteti i Ministrave ishin: ElMasri kundër RM (39630/09) Hajrullahu kundër RM (37537/07) Ivanovski kundër RM (29908/11) dhe Karajanov kundër RM (2229/15).

Gjatë periudhës nga tetori 2017 deri në dhjetor 2017, me dorëzimin e raportit të veprimit për lëndën Ivanovski kundër RM, si lëndë udhëheqëse dhe Karajanov kundër RM si lëndë përsëritëse, prej të cilëve të dy lëndët ishin nën mbikëqyrje të përforcuar, u ndryshua statusi i tyre. Për lëndën Ivanovski është dorëzuar rezolutë përfundimtare nga Komiteti i Ministrave dhe është mbyllur, ndërsa lënda Karajanov është lëndë e cila ka kaluar nga mbikëqyrja e përforcuar në mbikëqyrje standarde.

Gjatë periudhës nga janari deri në mars 2018, lëndë të cilët ende kanë status nën mbikëqyrje të përforcuar nga Komiteti i Ministrave janë: ElMasri kundër RM dhe Hajrullahu kundër RM.

Komiteti i ministrave në muajin dhjetor 2017 mbajti takim gjatë të cilit u miratuan vendime për lëndën ElMasri kundër RM (39630/09)). Vendimi gjyqësor është përfundimtar nga muaji dhjetor 2012, ndërsa qeveritarët nuk kishin dorëzuar asnjë informacion si përgjigje për Komitetin nga muaji mars 2017. Në vendimet thuhet se, qeveritarët duhet t'i kërkojnë falje publike shtetasit dhe ta informojnë Komitetin për progresin në zbatimin e masave të përgjithshme për zbatimin e vendimit, gjatë çka këto informata duhet të dorëzohen përfshirë muajin mars 2018. Njëkohësisht, në këtë takim Sekretariatit iu kërkua të hartojë draft rezolutë kohore për takimin e ardhshëm të Komitetit i cili duhet të mbahet në muajin qershor 2018, rezolutë e cila do të mbahet nëse nuk kryhen vendimet e lartpërmendura nga RM-ja.

Më 28 mars 2018, Ministri i Punëve të Jashtme Nikolla Dimitrov, nëpërmjet shkresës zyrtare kërkoi falje në emër të RM për rastin ElMasri kundër RM (38630/09) pas gjashtë vjet të kaluara nga vendimi gjyqësor i GJEDNJ. Në shkresën, shprehet "*falje e sinqertë dhe keqardhje e madhe*" kundër sjelljes jo përkatëse të qeveritarëve maqedonas¹¹⁸. Në takimin i cili duhet të mbahet në qershor 2018 nga Komiteti i ministrave, do të përcaktohet nëse lënda do të mbyllet, ose do të imponohen masa plotësuese të cilat shteti do të duhet t'i ndërmarrë në lidhje me këtë lëndë.

Lëndë nën mbikëqyrje standarde nga Komiteti i Ministrave

¹¹⁸<https://novatv.mk/dimitrov-vo-ime-na-makedonija-se-izvini-za-sluchajot-el-masri/>.

Lëndë nën mbikëqyrje standarde nga Komiteti i Ministrave¹¹⁹, me status mars 2018 janë:TasevaPetrovska kundër RM (73759/14),Kristanoski dhe të tjerë kundër RM (38024/08),Zendellska kundër RM- së (60417/14), Petroviç kundër RM (30721/15), Qendra për Zhvillimin e Psikologjisë Analitike kundër RM (29545/10),Karajanov kundër RM (2229/15), Selmani dhe të tjerë kundër RM (67259/19), KitanovskaStanojkoviç kundër RM (2229/15),Lazaroski kundër RM (4922/04), Arizanova kundër RM (22035/04), Nasgeska kundër RM (923152/05), Gorgiev kundër RM (26984/05), Arsovski kundër RM (30206/06), Atanasov kundër RM (41188/06), Vasillkoski kundër RM (28169/08),Stojanovski dhe të tjerë kundër RM (14174/09), DimitarMilladinov kundër RM (46398/09), Mitkova kundër RM (48386/09),Jaksovski dhe Trifunovski kundër RM (56381/09), Ilievska kundër RM (20136/11), Mitrinovski kundër RM (6899/12),Kitanovski kundër (15191/12), Andonovski kundër RM (24312/10), Dushko Ivanovski kundër RM (10718/05), BorisStojanovski kundër RM (41916/04), Asllani kundër RM (24058/13), Mitovi kundër RM (53565/13), Demerxhieva dhe të tjerë kundër RM (19315/06), Atanasov kundër RM (22745/06), Ballazoski kundër RM (45117/08), Iljazi kundër RM (56539/08),Eftimov kundër RM (59974/08), Trampevski kundër RM (4570/07), GerovskaPopçevska kundër RM (48783/07),Papadakis kundër RM (50254/07), Popovski dhe Duma kundër RM (69916/10), SashoGeorgiev kundër RM (49382/06), Andonoski kundër RM (16225/08),Velinov kundër RM (16880/08).

Rezoluta finale të Komitetit të Ministrave

Mbikëqyrja mbi realizimin nga Komiteti i Ministrave kryhet me miratimin e rezolutës finale, kur një shtet i ka ndërmarrë të gjitha masat për mënjanimin e shkeljes. Më poshtë është pasqyra e rezolutave finale të cilat janë miratuar nga Komiteti i Ministrave gjatë periudhës korrik 2015 - mars 2018:

Rezoluta finale të miratuara nga Komiteti i Ministrave¹²⁰	
Periudha korrik 2015 – shtator 2017	
Ballajxhiev	Sazdovski dhe të tjerë
Gjorgjiev dhe Hristov	Krstevski dhe të tjerë

¹¹⁹[http://hudoc.exec.coe.int/eng#{%22EXECDocumentTypeCollection%22:\[%22CEC%22\],%22EXECLanguage%22:\[%22ENG%22\],%22EXECState%22:\[%22MKD%22\],%22EXECSupervision%22:\[%22STAND%22\],%22EXECIsClosed%22:\[%22False%22\]}](http://hudoc.exec.coe.int/eng#{%22EXECDocumentTypeCollection%22:[%22CEC%22],%22EXECLanguage%22:[%22ENG%22],%22EXECState%22:[%22MKD%22],%22EXECSupervision%22:[%22STAND%22],%22EXECIsClosed%22:[%22False%22]})

¹²⁰[http://hudoc.exec.coe.int/eng#{%22EXECDocumentTypeCollection%22:\[%22res%22\],%22EXECPublishedDate%22:\[%222015-07-01T00:00:00.0Z%22,%222018-03-31T00:00:00.0Z%22\],%22EXECLanguage%22:\[%22ENG%22\],%22EXECState%22:\[%22MKD%22\]}](http://hudoc.exec.coe.int/eng#{%22EXECDocumentTypeCollection%22:[%22res%22],%22EXECPublishedDate%22:[%222015-07-01T00:00:00.0Z%22,%222018-03-31T00:00:00.0Z%22],%22EXECLanguage%22:[%22ENG%22],%22EXECState%22:[%22MKD%22]}).

Atanasovski dhe të tjerë	Deleva dhe të tjerë
Fetaovski	TrajçeStojanovski
Spasovski	Vasilevski
Ilik dhe të tjerë	Mitrov
Atanasoviq dhe të tjerë	Petrevska
Agrarikaoop Shkup dhe të tjerë	Fetaovski
Lazarevski dhe të tjerë	Asani dhe të tjerë
Trifunovski	LeshninaVeletrgovia SHPK
Periudha tetor 2017 – dhjetor 2017	
Ivanovski kundër RM (29908/11)	
Periudha janar 2018 – mars 2018	
Naumovski kundër RM (25248/05)	Mitrevski kundër RM (11621/09)
Jashar (69908/01), Xheladinov dhe të tjerë (13252/02), Sulejmanov (69875/01) dheTrajkoski (13191/02) kundër RM.	Petkoski dhe të tjerë kundër RM (27736/03)

Korniza institucionale për zbatimin e vendimeve gjyqësore

Në Republikën e Maqedonisë janë parashikuar dy trupa të cilat e ndjekin procesin e zbatimit të vendimeve të GJEDNJ, si vijon:Byroja për Përfaqësimin e Republikës së Maqedonisë në GJEDNJ¹²¹ dhe Komisioni Ndër sektorial për zbatimin e vendimeve të GJEDNJ¹²².

- Byroja për Përfaqësimin e RM në GJEDNJ

Byroja për Përfaqësimin e organit shtetëror i cili i kryen punët në lidhje me përfaqësimin e RM në GJEDNJ dhe punë të tjera profesionale në kompetencë të Ministrisë së Drejtësisë.Byroja për Përfaqësimin e RM në GJEDNJ paraqet mbështetje administrative të Komisionit Ndër sektorial. Në lidhje me zbatimin e vendimeve të GJEDNJ, Byroja e ndjek zbatimin e akt vendimeve gjyqësore të miratuara nga GJEDNJ, e ndjek zbatimin e obligimeve të gjykatave vendase dhe organeve shtetërore të cilat rezultojnë nga vendimet e GJEDNJ, harton rekomandime për veprimet e mundshme të organeve kompetente për shkak të zbatimit të vendimeve, paraqet informata në Komiteti i Ministrave për zbatimin e vendimeve, merr pjesë në punën e takimeve të Komitetit të Ministrave kur shqyrtohen masat e ndërmarra për zbatimin e aktgjykimeve të GJEDNJ dhe është në komunikimin të vazhdueshëm dhe bashkëpunim me institucione

¹²¹Byroja është organ i administratës shtetërore në përbërje të Ministrisë së Drejtësisë, i cili i kryen punës në lidhje me përfaqësimin dhe veprimin e Republikës së Maqedonisë në Gjykatë dhe kryen punë të tjera profesionale me kompetencë të Ministrisë.

¹²²Për ndjekjen e zbatimit të vendimeve të gjykatës formohet Komision Ndër sektorial, me të cilin udhëheq Ministri i Drejtësisë, ndërsa me aktvendim e formon Qeveria e Republikës së Maqedonisë.

kompetente në drejtim të ndërmarrjes së masave cilësore dhe në kohë. Byroja për Përfaqësim paraqet plane veprimi dhe raporte te Komiteti i Ministrave. Planet e veprimeve respektivisht raportet duhet të dorëzohen në Byroja për përfaqësimin e RM në GJEDNJ në afat prej 6 muaj pas vendimit përfundimtar. Nëse nuk paraqitet plan veprim në afatin e parashikuar, Sekretariati i Komitetit të Ministrave paraqet përkujtues me të cilin shtetit i jep afat nga tre muaj të reja (plotësuese) nga pranimi, me qëllim të dorëzohet plan veprim, respektivisht raport. Në kuadër të procesit të ndjekjes së punës së organeve për zbatimin e vendimeve gjyqësore të Strasburgut, Byroja për Përfaqësimin e RM në GJEDNJ vazhdoi të investojë përpjekje në drejtim të zbatimit të vendimeve të miratuara në Strasburg, që në fakt ka të bëjë me përpilimin e plan veprimeve të detajuara dhe raporteve që i përmbajnë masat individuale dhe të përgjithshme për implementimin e vendimeve gjyqësore. Megjithatë, në një pjesë të lëndëve, afatet për dorëzimin e plan veprimeve, respektivisht raporteve, tejkalohen nga Byroja për Përfaqësimin e RM në GJEDNJ. Si rrethana vështirësuese mund të theksohen mbajtja jo e rregullt e mbledhjeve të Komisionit Ndër sektorial për zbatimin e aktgjykimeve të GJEDNJ si dhe vëllimin e zmadhuar të punës përkundër kapaciteteve të pamjaftueshme të Byrosë për Përfaqësim. Një nga problemet më të mëdha të zakonshme, sigurisht është edhe raportimi jo konsistent, nga organet kompetente të cilat e kanë bërë shkeljen konkretisht në raste kur Byroja grumbullon informacione, kërkon sqarime dhe mendime nga gjykata vendase dhe organe shtetërore në lidhje me lëndë për të cilat vepron. Sistemi i këtillë jo efikas i komunikimit dhe ndarjes së informatave drejtpërdrejtë ndikon mbi të gjithë procesin e zbatimit në kohë të obligimeve ligjore në lidhje me përpilimin e plan veprimeve / raporteve për dorëzimin e të cilave ka afate të rrepta të cilat shkelen në vazhdimësi.

- **Komisioni Ndërsektorial për zbatimin e aktgjykimeve të GJEDNJ**

Komisioni Ndër sektorial¹²³ kryen analizë të aktgjykimeve të GJEDNJ të miratuara kundër Republikës së Maqedonisë, për përcaktimin e shkaqeve të cilat kanë rezultuar me shkelje, rekomandon masa individuale dhe të përgjithshme të organeve shtetërore kompetente për mënjanimin e shkeljeve të përcaktuara nga GJEDNJ dhe për mënjanimin e pasojave nga e njëjta, jep propozime për përmirësimin e rregullativës ligjore për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, e ndjek zbatimin e vendimeve të GJEDNJ, siguron dhe këmben informata dhe pasoja në fushën e

¹²³Komisioni Ndër sektorial për punën e vet përpilon raport vjetor dhe të njëjtin nëpërmjet Ministrisë së Drejtësisë e dorëzon në Qeveri dhe Komisioni i Përhershëm Anketues për Liritë dhe të Drejtat e Qytetarit pranë Kuvendit të Republikës së Maqedonisë dhe te Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, më së voni deri më 31 mars vitin e ardhshëm

zbatimin të vendimeve të GJEDNJ, e ndjek sistemin ekzistues për zbatimin e vendimeve dhe propozon masa për përmirësimin e tyre. Në pajtim me dispozitat e Ligjit për zbatimin e vendimeve të GJEDNJ, Komisioni Ndër sektorial takohet sipas nevojës, ndërsa të paktën një herë në tre muaj¹²⁴.

Numri i përgjithshëm i mbledhjeve të mbajtura të Komisionit Ndërsektorial për zbatimin e vendimeve të GJEDNJ nga 2015 deri në mars 2018 është 7¹²⁵.

viti 2015	viti 2016	viti 2017	përfshirë marsin e vitit 2018
• 4 mbledhje	• 1 mbledhje	• 1 mbledhje	• 1 mbledhje

Në pajtim me të dhënat mund të konstatohet se pas rekomandimeve të pranuar të Pribes nga viti 2015, Komisioni Ndër sektorial jo vetëm që nuk e ka zmadhuar intensitetin e punës, por edhe e ul numrin e mbledhjeve të mbajtura në vitin 2016 dhe 2017, edhe pse në pajtim me dispozitat ligjore, nevojitet të takohen të paktën një herë në tre muaj. Në procesin e zbatimit të vendimeve të GJEDNJ, do të ketë progres nëse Komisioni Ndër sektorial mban takime të rregullta, duke pasur parasysh faktin se në vitin 2016 dhe 2017 ka mbajtur nga një mbledhje në vit që është numër dukshëm më i vogël në pajtim me obligimet ligjore dhe kompetencat të cilat rezultojnë nga të njëjtit. Rëndësia dhe efekti nga mbajtja e rregullt e mbledhjeve mund të shihet në lidhje me mbledhjet e mbajtura për vitin 2017 dhe rekomandimet e dhëna nga e njëjta, ku disa organe kompetente i kanë zbatuar në mënyrë përkatëse rekomandimet. Për këtë qëllim, nevojitet komunikim i vazhdueshëm dhe në kohë ndërmjet institucioneve, Byrosë për Përfaqësim dhe Komisionit Ndër sektorial, me qëllim mënjanimin e shkeljeve të të drejtave të garantuara me GJEDNJ dhe parandalimin e përsëritjes së rasteve.

Masat të cilat pritet të ndërmerren nga shteti në procesin e zbatimit, janë dy lloje: masa individuale dhe të përgjithshme. Obligimi për ndërmarrjen e masave individuale ka dy aspekte: e para, obligimi ti paguhet aplikuesit shumë e caktuar me para, respektivisht kompensim për dëmin për shkeljen e konstatuar të Konventës, dhe aspekti i dytë është në lidhje me faktin se pasojat nga

¹²⁴Neni 12 i Ligjit për zbatimin e vendimeve të KEDNJ (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 67/2009 dhe 43/2014),

¹²⁵<http://biroescp.gov.mk/%D1%81%D0%BE%D1%81%D1%82%D0%B0%D0%BD%D0%BE%D1%86%D0%B8-%D0%B8-%D0%BF%D1%80%D0%B5%D0%BF%D0%BE%D1%80%D0%B0%D0%BA%D0%B8/>

shkelja jo çdo herë riparohen në mënyrë përkatëse me pagesën e dëmshpërblimit adekuat në shumë të përcaktuar nga GJEDNJ dhe përcaktimin e shkeljes. Në kuadër të zbatimit të projektit, është përcaktuar se zbatimi i aktgjykimeve nga GJEDNJ kryesisht është në lidhje me dëmshpërblimin me para të përcaktuar me vendimin gjyqësor e shumë pak në riparimin e procedurave të ardhshme të njëjta në kundërshtim me Konventën. Pas marrjes së vendimeve nga GJEDNJ, në veçanti ato lëndë që konsiderohen si lëndë të klonuara, mund të konkludohet se ka nevojë për punë intensive për plotësimin e masave të parashikuara në plan veprimet / raportet. Edhe pse Byroja për Përfaqësimin e RM në GJEDNJ dhe Komisioni Ndër sektorial janë kompetente për ndjekjen e zbatimit të vendimeve të GJEDNJ dhe dhënien e rekomandimeve, organet të cilat e kanë kryer shkeljen duhet ti kryejnë dhe zbatojnë vendimet gjyqësore të GJEDNJ si dhe ti mënjanojnë pasojat nga shkelja janë me qëllim të parandalohen shkelje të ardhshme të KEDNJ dhe të paraqiten raste të reja të klonuara. Së këndejmi efikasiteti i të gjithë sistemit të zbatimit nuk varet vetëm nga një organ por nga puna e përbashkët dhe e koordinuar të gjitha palëve.

Studimi i rasteve

- Kitanovski kundër RM (lënda udhëheqëse) dhe lëndët Andonovski kundër RM, Asllani kundër RM dhe Ilievska kundër RM (lëndë përsëritëse)¹²⁶

Në lëndën Kitanovski kundër RM (15191/12), vendim gjyqësor cili është i plotfuqishëm më 22.04.2015, GJEDNJ ka konstatuar shkeljen e nenit 2 (e drejta për jetë) dhe neni 3 (ndalim për torturë) të KEDNJ. Në këtë rast bëhet fjalë për përdorim të pa arsyetuar të fuqisë potencialisht vdekjeprurëse, trajtimit degradues dhe shërbimit jo efektiv të hetimit nga qeveritarët.

Lënda Kitanovski kundër RM është lëndë udhëheqëse, gjatë çka në afat prej 1 vjet janë miratuar edhe 3 vendime të tjera gjyqësore nga GJEDNJ, të cilat janë përsëritëse për këtë lëndë. Lëndë përsëritëse janë Andonovski kundër RM (24312/10)¹²⁷, Asllani kundër R—së (24058/13)¹²⁸ dhe Ilievska kundër RM (20136/11) ¹²⁹.Në këto lëndë, si lëndë përsëritëse është zbuluar shkelja e nenit 3 (ndalimi për mundim – torturë) nga KEDNJ për shkak të hetimit jo efektiv dhe brutalitetit nga nëpunësit policor.

¹²⁶[http://hudoc.exec.coe.int/eng#{"fulltext":\["Kitanovski"\],"EXECLanguage":\["ENG"\],"EXECState":\["MKD"\],"EXCIIdentifier":\["004-6582"\]}](http://hudoc.exec.coe.int/eng#{).


¹²⁷Aktgjykimi bëhet i plotfuqishëm më 23.10. 2015

¹²⁸Aktgjykimibëhet i plotfuqishëmmë 23.10. 2015

¹²⁹Aktgjykimibëhet i plotfuqishëmmë07.08. 2015

Për lëndën Kitanovski, Komisioni Ndërkombëtar ka dhënë rekomandim për zbatimin e këtij vendimi gjyqësor në mbledhjen e 9-të të mbajtur më 29 qershor 2015 dhe janë në lidhje me zbatimin e hetimit zyrtar efektiv nga prokurori publik.¹³⁰Në mbledhjen e 11-të, të mbajtur më 09 nëntor 2015, Komisioni ndër sektorial ka dhënë rekomandim për zbatimin e aktgjykimeve për lëndët Andonovski kundër RM dhe Ilievska kundër RM.¹³¹Në mbledhjen e 13-të, të mbajtur më 28 mars 2017, Komisioni ndër sektorial ka dhënë rekomandim për zbatimin e aktgjykimeve për lëndët Andonovski kundër RM dhe Asllani kundër RM.¹³²Në mbledhjen e 14-të, të mbajtur më 28 mars 2018, Komisioni ndër sektorial ka dhënë rekomandime për zbatimin e aktvendimit gjyqësor për lëndën Kitanovski kundër RM¹³³.

Raport i veprimit për të gjitha katër lëndët është dorëzuar më 06.03.2017. Nga momenti i plotfuqishmërisë së vendimit gjyqësor kundër RM si lëndë udhëheqëse, deri në momentin e dorëzimit të raportit të veprimit është nevojitur periudhë prej 22 muaj, edhe pse nga plotfuqishmëria e vendimit gjyqësor duhet plan veprimi/ raporti të dorëzohet në afat prej 6 muaj.



Për lëndën Kitanovski kundër RM, Gjykata Themelore Shkup 1Shkup më datë 18.06.2015 ka dorëzuar shkresë për marrjen e informatave për këtë lëndë, ndërsa Prokuroria Publike Themelore më 09.02.2018 dhe Prokuroria Publike e RM më 13.02.2018 kanë dorëzuar shkresë për të fituar informata në lidhje me këtë lëndë.

Në lidhje me zbatimin e këtyre aktgjykimeve është arritur progres në lidhje me vendosjen e mekanizmit të jashtëm të pavarur për mbikëqyrjen e punës së policisë, duke e pasur parasysh

¹³⁰<http://biroescp.gov.mk/wp-content/uploads/2016/12/9.pdf>

¹³¹<http://biroescp.gov.mk/wp-content/uploads/2016/12/11.pdf>

¹³²<http://biroescp.gov.mk/wp-content/uploads/2016/12/%D0%97%D0%B0%D0%BF%D0%B8%D1%81%D0%BD%D0%B8%D0%BA-%D0%BE%D0%B4-13%D1%82%D0%B0-%D1%81%D0%B5%D0%B4%D0%BD%D0%B8%D1%86%D0%B0-%D0%BD%D0%B0-%D0%9C%D0%9A.pdf>

¹³³<http://biroescp.gov.mk/wp-content/uploads/2016/12/14-%D1%82%D0%B0-%D0%9C%D0%B5%D1%93%D1%83%D1%80%D0%B5%D1%81%D0%BE%D1%80%D1%81%D0%BA%D0%B0-%D0%BA%D0%BE%D0%BC%D0%B8%D1%81%D0%B8%D1%98%D0%B0-28-%D0%9C%D0%B0%D1%80%D1%82-2018-%E2%80%93-%D0%97%D0%B0%D0%BF%D0%B8%D1%81%D0%BD%D0%B8%D0%BA-%D1%81%D0%BE-%D0%B7%D0%B0%D0%BA%D0%BB%D1%83%D1%87%D0%BE%D1%86%D0%B8.pdf>

faktin se pakoja për ndryshime ligjore për vendosjen e këtij mekanizmi është miratuar nga Kuvendi i RM. Byroja për Përfaqësim është në fazë të përpilimit të informatave të grumbulluara për masat e ndërmarra nga institucione kompetente me qëllim përpilimin e raport veprimit të rishikuar në lidhje me Kitanovski grupin e lëndëve.

-Mitrinovski kundër RM (lëndë udhëheqëse) dhe lëndët Jakshovski dhe Trifunovski kundër RM, GerovskaPopçevska kundër RM dhe Popovski dhe Duma kundër RM (lëndë përsëritëse)¹³⁴

Në lëndën Mitrinovski kundër RM (6899/12), aktvendim i cili është i plotfuqishëm më 30.04.2015 nga GJEDNJ është konstatuar shkelje e nenit 6 paragrafi 1 (e drejta për procedure të barabartë) të KEDNJ. Në këtë rast bëhet fjalë për shkeljen e të drejtës për procedurë të drejtë nga aspekti i pamundësimit të tribunalit të pavarur dhe të pa anshëm gjatë vendimmarrjes për shkarkimin e gjyqtarve, në Këshillin gjyqësor të marrë pjesë edhe anëtar i Këshillit i cili e ka iniciuar procedurën dhe ka vepruar si një lloj prokurori në procedurën për shkarkim. Në rrethana të këtilla GJEDNJ, ka konsideruar se sistemi në të cilin anëtari i këshillit i cili ka iniciuar procedurën për shkarkim dhe pastaj ka marrë pjesë aktive në vendimin të shkarkohet ankuesi, jep dyshim objektiv për pa anshmërinë e tij gjatë vendimmarrjes për atë sa është i bazuar rati i ankuesit.

Lënda Mitinovski kundër RM është lëndë udhëheqëse, gjatë çka në afat prej 1 vjet janë miratuar edhe 3 vendime të tjera gjyqësore, të cilat janë përsëritëse për këtë lëndë.

Në afat prej 1 vit nga plotfuqishmëria e këtij aktvendimi, janë miratuar edhe 3 aktgjykime të tjera gjyqësore të cilat janë përsëritëse për këtë lëndë. Lëndë përsëritëse janë: GerovskaPopçevska kundër RM (48783/07), Jakshovski dhe Trifunovski kundër RM (56381/09), Popovski dhe Duma kundër RM (69916/10), të gjitha të plotfuqishme më 07.04.2016. Gjithashtu edhe në këto tre raste, ekziston mungesë e pa paanshmërisë gjatë vendimmarrjes për atë a ka bazë rasti, nga Këshilli gjyqësor.


Për lëndën Mitrinovski, Komisioni ndër sektorial ka dhënë rekomandim për zbatimin e aktgjykime për lëndët në mbledhjen e 11-të të mbajtur më 09 nëntor 2015.¹³⁵ Komisioni ndër sektorial ka dhënë rekomandime për zbatimin e këtyre aktgjykime në mbledhjen e 13 –të të

¹³⁴<http://hudoc.exec.coe.int/eng#%7B%22tabview%22:%5B%22document%22%5D,%22EXEClIdentifier%22:%5B%22004-6578%22%5D%7D>.

¹³⁵<http://biroescp.gov.mk/wp-content/uploads/2016/12/11.pdf>.

mbajtur më 25.10.2017¹³⁶. Në mbledhjen e 14-të, të mbajtur më 28 mars 2018, Komisioni ka dhënë rekomandime për zbatimin e aktgjykimeve për të gjitha lëndët.¹³⁷

Më 28 prill, 2016, është dorëzuar raporti i veprimit në Komitetin e Ministrave¹³⁸.



Nga momenti i plotfuqishmërisë së vendimit gjyqësor Mirinovski kundër RM si lëndë udhëheqëse, deri në momentin e dorëzimit të raportit të veprimit është dashur periudhë prej 12 muaj, edhe pse nga plotfuqishmëria e vendimit gjyqësor duhet plan veprimi/ raporti të dorëzohet në afat prej 6 muaj.¹³⁹

Selmani dhe të tjerë kundër RM (lëndë udhëheqëse) ¹⁴⁰

Në lëndën Selmani kundër RM (67259/14), aktvendim i cili është i plotfuqishëm më 09.05.2017 nga GJEDNJ është konstatuar shkelje e nenit 6 paragrafi 10 (e drejta për procedure të barabartë) dhe neni 10 (liria e shprehjes) të KEDNJ.

Në këtë rast është konstatuar shkelje e procedurës gjyqësore të drejtë për shkak të mos mbajtjes së diskutimit me gojë në Gjykatën Kushtetuese të RM dhe liria e të shprehurit për shkak të largimit të gazetarëve nga galeria e kuvendit prej nga ata kanë raportuar për rrjedhën e seancës së Kuvendit gjatë çka është bërë shkelje e të drejtës për lirinë e shprehjes.

¹³⁶<http://biroescp.gov.mk/wp-content/uploads/2016/12/%D0%97%D0%B0%D0%BF%D0%B8%D1%81%D0%BD%D0%B8%D0%BA-%D0%BE%D0%B4-13%D1%82%D0%B0-%D1%81%D0%B5%D0%B4%D0%BD%D0%B8%D1%86%D0%B0-%D0%BD%D0%B0-%D0%9C%D0%9A.pdf> .

¹³⁷<http://biroescp.gov.mk/wp-content/uploads/2016/12/14-%D1%82%D0%B0-%D0%9C%D0%B5%D1%93%D1%83%D1%80%D0%B5%D1%81%D0%BE%D1%80%D1%81%D0%BA%D0%B0-%D0%BA%D0%BE%D0%BC%D0%B8%D1%81%D0%B8%D1%98%D0%B0-28-%D0%9C%D0%B0%D1%80%D1%82-2018-%E2%80%93%D0%97%D0%B0%D0%BF%D0%B8%D1%81%D0%BD%D0%B8%D0%BA-%D1%81%D0%BE-%D0%B7%D0%B0%D0%BA%D0%BB%D1%83%D1%87%D0%BE%D1%86%D0%B8.pdf> .

¹³⁸[http://hudoc.exec.coe.int/eng#%7B%22fulltext%22:%5B%226899%2F12%22%2C%22EXECDocumentTypeCollection%22:%5B%22CEC%22%2C%22acp%22%2C%22acr%22%2C%22EXEIdentifier%22:%5B%22DH-DD\(2016\)563E%22%5D%7D](http://hudoc.exec.coe.int/eng#%7B%22fulltext%22:%5B%226899%2F12%22%2C%22EXECDocumentTypeCollection%22:%5B%22CEC%22%2C%22acp%22%2C%22acr%22%2C%22EXEIdentifier%22:%5B%22DH-DD(2016)563E%22%5D%7D) .

¹³⁹Te Këshilli Gjyqësor i RM u paraqit kërkesë për qasje të lirë te informatat me karakter publik nr. I - 0306-363 më 02.04.2018, nëse KGJRM ka vepruar në pajtim me rekomandimet e pranuar të dhëna në mbledhjen e 13- të të Komisionit Ndër sektorial për të cilin deri më 28.05.2018 nuk kemi pranuar përgjigje

¹⁴⁰<http://hudoc.exec.coe.int/eng#%7B%22fulltext%22:%5B%2267259%2F14%22%2C%22EXECDocumentTypeCollection%22:%5B%22CEC%22%2C%22EXEIdentifier%22:%5B%22004-47275%22%5D%7D> .


Për këtë lëndë, Komisioni ndër sektorial ka dhënë rekomandime për zbatimin e aktgjykime në mbledhjen e 13-të të mbajtur më 25 nëntor 2017¹⁴¹.

Gjykata Kushtetuese ka përpiluar analizë për shkaqet për të cilat GJEDNJ, ka konstatuar shkeljen e nenit 6 dhe nenit 10 të GJEDNJ. Gjithashtu në Komisioni Ndër sektorial ka dorëzuar propozim - masa për zbatimin e aktvendimit të GJEDNJ. Në propozim – masat Gjykata Kushtetuese ka theksuar se në të ardhmen do të tentojë në rastet kur shkelja e lirive dhe të drejtave të njeriut është rezultat i veprimeve të organit publik, pas çka kërkuesi i drejtohet Gjykatës Kushtetuese, të vendosë në bazë të diskutimit gojor të mbajtur, me prezencën e palëve. Nëse Gjykata Kushtetuese vendos se nuk ka debat publik, në aktvendimin duhet të jepet arsyetim për çfarë shkaqe ka marrë vendim të këtillë. Në lidhje me shkeljen e të drejtës së lirisë së shprehjes, Gjykata kushtetuese do të ketë trajnime të vazhdueshme, me qëllim rritjen e kapaciteteve të të njëjtit dhe parandalimin e rasteve të ngjashme.

Më 06 shkurt 2018¹⁴², është dorëzuar raportit të veprimit, ndërsa më 3 maj 2018 është dorëzuar raportit i veprimit i rishikuar në Komisioni i Ministrave¹⁴³.

Perceptimet e avokatëve për zbatimin e aktgjykimeve të GJEDNJ

Në kuadër të projektit, ekipi projektues zbatoi hulumtim për avokatët¹⁴⁴ dhe analiza të perceptimeve të tyre në lidhje me zbatimin e aktgjykimeve të GJEDNJ. Nga të dhënat e fituara nga pyetësi anketues për avokatë në lidhje me pyetjen “A mendoni se aktgjykimet e Gjykatës



Evropiane për të Drejtat e Njeriut, zbatohen në mënyrë efektive në Republikën e Maqedonisë?”, pjesa më e madhe e avokatëve respektivisht 58.1% nuk e dinë nëse aktgjykimet e GJEDNJ,

¹⁴¹<http://biroescp.gov.mk/wp-content/uploads/2016/12/%D0%97%D0%B0%D0%BF%D0%B8%D1%81%D0%BD%D0%B8%D0%BA-%D0%BE%D0%B4-13%D1%82%D0%B0-%D1%81%D0%B5%D0%B4%D0%BD%D0%B8%D1%86%D0%B0-%D0%BD%D0%B0-%D0%9C%D0%9A.pdf>.

¹⁴²[http://hudoc.exec.coe.int/eng#%7B%22fulltext%22:%5B%2267259/14%22%2C%22EXECDocumentTypeCollection%22:%5B%22CEC%22%2C%22acp%22%2C%22acr%22%2C%22EXECIdentifier%22:%5B%22DH-N%26%20IDD\(2018\)133E%22%5D%7D](http://hudoc.exec.coe.int/eng#%7B%22fulltext%22:%5B%2267259/14%22%2C%22EXECDocumentTypeCollection%22:%5B%22CEC%22%2C%22acp%22%2C%22acr%22%2C%22EXECIdentifier%22:%5B%22DH-N%26%20IDD(2018)133E%22%5D%7D).

¹⁴³[http://hudoc.exec.coe.int/eng#%7B%22fulltext%22:%5B%2267259/14%22%2C%22EXECDocumentTypeCollection%22:%5B%22CEC%22%2C%22acp%22%2C%22acr%22%2C%22EXECIdentifier%22:%5B%22DH-DD\(2018\)454E%22%5D%7D](http://hudoc.exec.coe.int/eng#%7B%22fulltext%22:%5B%2267259/14%22%2C%22EXECDocumentTypeCollection%22:%5B%22CEC%22%2C%22acp%22%2C%22acr%22%2C%22EXECIdentifier%22:%5B%22DH-DD(2018)454E%22%5D%7D).

¹⁴⁴Pyetësi anketues u dorëzua te 180 avokatëU siguruan 62 përgjigje të pyetësorëve në bazë të të cilave janë fituar edhe të dhëna analitike.

zbatohen në mënyrë efektive, ndërsa 32.3% konsiderojnë se aktgjykimet nuk zbatohen në mënyrë efektive dhe vetëm 9,7% konsiderojnë se zbatohen në mënyrë efektive nga shteti. Kjo aludon në mungesë serioze të njohjes së procesit të zbatimit të aktgjyqimeve të GJEDNJ nga avokatët si përfaqësues të palëve në procedurat në gjykatën në Strasburg. I konsiderueshëm është edhe numri i avokatëve të cilët mendojnë se aktgjykimet nuk zbatohen në mënyrë efektive në RM.

(prevod na grafikonot (Po, Jo Nuk e di))

KONKLuzionet dhe Rekomandimet e Prioritetit 9:

K.1 Komisioni ndër sektorial për zbatimin e vendimeve të GJEDNJ gjatë vitit 2016 dhe 2017 e ka zvogëluar numrin e mbledhjeve të mbajtura, respektivisht nga një seancë gjatë një viti, edhe pse në pajtim me dispozitat ligjore duhet të mbajë të paktën 4 seanca në vit.

R.1. Nevojitet mbajtja e rregullt e seancave të Komisionit Ndër sektorial për zbatimin e vendimeve të GJEDNJ në pajtim me dispozitat ligjore.

K.2 Efikasiteti i të gjithë sistemit të zbatimit të vendimeve të GJEDNJ, nuk varet vetëm nga një organ por nga puna e përbashkët dhe e koordinuar e të gjitha palëve të interesuara. Byroja për përfaqësimin e RM në GJEDNJ dhe Komisioni ndër sektorial e ndjekin procesin e zbatimit të vendimeve të GJEDNJ, mirëpo institucionet kompetente të cilat i kanë bërë shkeljet e të drejtave të garantuara me GJEDNJ, duhet de facto ti zbatojnë dhe realizojnë aktgjykimet e GJEDNJ, me qëllim të mos shkaktohen raste të klonuara në GJEDNJ.

R.2. Nevojitet ndjekje afatgjate, e vazhdueshme dhe gjithëpërfshirëse e punës së organeve kompetente me qëllim përcaktimin e specifikave konkrete në lidhje me përmirësimin e efikasitetit në zbatimin e vendimeve të GJEDNJ.

R.3. Vendosja e sistemit efikas të komunikimit efikas të vazhdueshëm dhe në kohë dhe ndarja e informatave në mënyrë të rregullt ndërmjet institucioneve, Byrosë për Përfaqësim dhe Komisioni Ndër sektorial.

R.4. Realizimi i trajnimeve të rregullta të institucioneve të interesuara në lidhje me mënjanimin e shkeljeve të të drejtave të garantuara me KEDNJ, parandalimin e shkaktimit të rasteve të reja të klonuara dhe zbatimin e vendimeve të KEDNJ.